

Qeverisja demokratike e shkollave

Elisabeth Bäckman
dhe
Bernard Trafford

Botim i Këshillit të Evropës

Mendimet e dhëna në këtë punim janë mendime të autorit(ëve) dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Të gjitha të drejtat mbrohen. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo mënyre elektronike (CD, Internet, etj.) ose mekanike, duke përfshirë fotokopjimin, incizimin ose cilëndo formë të sistemit të memorimit ose kthimit në gjendjen e mëparshme të informacioneve pa lejen paraprake me shkrim nga *Public Information and Publications Division, Directorate of Communication* (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Kopertina: Graphic Design Workshop, Këshilli i Evropës
Faqosja: Ogham/Mourreau

Botim i Këshillit të Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
<http://book.coe.int>

ISBN-13: 978-92-871-6088-1
© Këshilli i Evropës, janar 2007.
Shtypur: Këshilli i Evropës.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje

2. Çka është qeverisja demokratike e shkollës?

3. Cilat janë përparësitë e qeverisjes demokratike?

4. Fushat kryesore për qeverisje demokratike të shkollave: shqyrtimi i parë

5. Si është situata ime? Vlerat dhe sjelljet

6. Hap pas hapi: rruga drejt qeverisjes demokratike

Fusha kryesore 1: Qeverisja, udhëheqja, administrimi dhe përgjegjësia publike

Fusha kryesore 2: Edukimi me përqendrim në vlera

Fusha kryesore 3: Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja:
Konkurrenca dhe vetëvendosja e shkollës

Fusha kryesore 4. Disiplina e nxënësve

7. Pyetjet më të shpeshta për qeverisjen demokratike të shkollës

8. Shembuj të praktikës së mirë nga gjithë Evropa

9. Qeverisja demokratike: modelet dhe karakteristikat e përbashkëta

10. Përfundimi

Shtojca I. Tabela e planifikimit

Shtojca II.

Burimet

1. Hyrje

Ky doracak është pjesë e serisë ose kompletit të materialeve të dizajnuar dhe të përpiluar nga Këshilli i Evropës për të ndihmuar shkollat dhe institucionet tjera edukativo-arsimore në përkrahjen dhe zhvillimin e Edukimit për Qytetarinë Demokratike (EQD – shih Shtojcën II.) Edukimi për qytetarinë demokratike është shumë i rëndësishëm për Këshillin nëse dëshiron që 46 shtete anëtare vërtetë të përparojnë në rrugën e demokracisë: EQD-ja ka rëndësi kyçe të sigurojë që gjeneratat e ardhshme të qytetarëve të rinj të jenë të përgatitur dhe të aftësuar të luajnë rolin e tyre demokratik – në komunitetin e tyre, në shoqërinë e tyre më të gjerë dhe në kuadër të Evropës në tërësi. Për këtë arsye EQD-ja përmendet shpesh në këtë tekst dhe në të gjitha publikimet që janë pjesë e kompletit të materialeve të shkruara për EQD-në.

Cili është qëllimi i këtij doracaku?

Ky doracak shërben për qeverisje demokratike të *shkollave*, por mund të zbatohet në të gjitha llojet e institucioneve edukative dhe në vendet tjera ku bëhet edukimi i rinjve. Fjala *shkollë* përdoret për hir të thjeshtësisë, e jo për të përjashtuar llojet e institucioneve tjera edukative. Për të njëjtën arsye, të gjithë ata që mësojnë në ato institucione i quajmë *nxënës*, duke mos harruar se me këtë emër përfshihet pjesë e popullatës nga fëmijët më të vegjël (e që kurrë nuk janë aq të rinj që të jetojnë dhe mësojnë demokraci dhe qytetari demokratike) deri te adoleshentët e rinj.

Ky libër/doracak është përpiluar ashtu që lexuesve t'u ndihmojë të vlerësojnë se sa kontribuon shkolla e tyre në EQD-në e nxënësit, dhe në këtë mënyrë edhe në përgatitjen e tyre për të marrë rolin e qytetarëve aktiv në demokraci, duke vështuar se si funksionon çdo ditë shkolla – dhe se si sillen njerëzit. Pra, nuk është fjala për atë se në shkollë mësohet për qytetarinë, për teorinë dhe për parimet e demokracisë, për edukimin demokratik, ose madje për EQD-në. Qëllimi i këtij libëri /doracaku është që të tejkalojë barrierën ndërmjet teorisë (p.sh. pyetja “Se si i përgatisim të rinjtë të bëhen qytetarë aktiv, pjesëtarë demokratikisht të orientuar të shoqërisë?”) dhe praktikës (p.sh. përgjigjja “Ashtu që t’ju sigurojmë eksperiencë demokratike, dhe atë në çdo segment dhe në çdo nivel të jetës në shkollë”). Prandaj, ky doracak fillon me disa përkufizime, përshkruan mënyrën e formësimit të rrugëtimit drejt demokracisë, ndihmon lexuesit të çmojnë se sa larg ka shkuar shkolla e tyre në rrugëtimin e tillë dhe jep udhëzime praktike dhe ide se si duhet filluar rrugëtimin e tillë, ose si duhet përparuar më tutje duke bërë vlerësimin përkatës për progresin e arritur.

Kujt i dedikohet ky doracak?

Asnjë formë e demokracisë nuk është e përkryer, ashtu siç nuk është asnjë shkollë e përkryer, dhe së këndejmi edhe asnjë shkollë nuk është krejtësisht demokratike! Një pjesë e madhe e këtij doracaku u dedikohet udhëheqësve të shkollave, duke menduar këtu në profesionist të niveleve të larta, të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi që, në masë të madhe vendosin se në çfarë mënyre do të funksionojë shkolla. Autorët e pjesës kryesore në asnjë mënyrë nuk duhet përjashtuar! Ata të dy shërbejnë si drejtorë dhe janë të ndërgjegjshëm se nuk janë të vetmit në shkollë që kanë detyrat dhe përgjegjësitë e përmendura paraprakisht. Megjithatë, njeriu i parë në shkollë, i cili me gjasë do ta lexojë këtë doracak (para se t’ua përcjellë, shpresojmë!, të tjerëve) është drejtori, dhe pa punën e drejtorit dhe mbështetjes aktive të tij, gjasat janë të vogla që demokracia të lëshojë rrënjë dhe të rritet: prandaj në doracak përdoren nocionet

“drejtor“ dhe “udhëheqës“. Shpresojmë që, lexuesit do të na falin për përdorimin qëllimisht jo të fiksuar të terminologjisë.

Por në demokraci ka edhe palë tjera të përfshira. Këtë doracak mund ta përdorin të gjithë ata që janë të interesuar për suksesin e shkollës. Nxënësit – fëmijët dhe të rinjtë (nga pikëvështrimi i këtij doracaku) nga katër (ose më pak) deri 20 (ose mbi 20) vjet, pavarësisht prej asaj se a janë të përfshirë në shkollim të detyrueshëm, universitet, trajnim teknik ose profesional në kolegji ose në vend pune – janë ata që tregojnë interesim të lartë për edukimin i cili u ofrohet dhe për mënyrën në të cilën zhvillohet arsimimi i tillë. Nuk mund të themi bindshëm se pjesëmarrja demokratike nuk është diçka që përvetësohet vetëm nga fëmijët në një moshë të caktuar (me gjasë asaj të shkollimit sekondar): por pikërisht e kundërta, ajo më mirë mësohet në fillim të shkollimit, sepse fëmijët, në moshë më të re, më lehtë përvetësojnë dhe jetojnë në pajtim me vlerat dhe praktikën demokratike.

Prindërit dhe komuniteti më i gjerë janë të interesuar për atë çka mësohet dhe për rezultatet, përkatësisht kompetencat e fituara. Mësimdhënësit, trajnuesit dhe punëtorët tjerë në shkolla ose në cilindo vend tjetër, kanë të drejtë dhe përgjegjësi të kenë opinionin e tyre për çështjet në lidhje me edukimin që mbahet në institucionin përkatës. Për këtë arsye udhëheqësit e shkollave duhet të vendosin dhe të kultivojnë raporte të gjera të partneritetit. Ky doracak ka diçka për të gjithë partnerët dhe palët e interesuara në procesin e edukimit të të rinjve.

Pse?

Pse udhëheqësit e edukimit dhe palët e interesuara do të duhej të punonin sipas këtij doracaku dhe të vlerësonin ose planifikonin rrugën e tyre drejt një qasje më demokratike në edukim? Dy kapitujt në vazhdim do t’ju ndihmojnë të përgjigjeni në këtë pyetje. Thënë shkurt, është në interes të tyre ta bëjnë këtë. Një shkollë e strukturuar dhe që punon në bazë të parimeve demokratike, nuk do të nxisë vetëm EQD-në dhe të përgatisë nxënësit e saj të marrin pjesë në shoqërinë e tyre dhe të jenë të angazhuar demokratikisht: ajo në atë mënyrë do të bëhet institucion i qëlluar, kreativ dhe i suksesshëm. Vlera që shtohet në këtë mënyrë është e lartë: treguesit nga hulumtimet në lidhje me këtë janë gjithnjë në rritje. Prandaj, ky doracak nuk përshkruan vetëm misionin që është i drejtë në pikëpamje morale: nisja drejt rrugës së demokracisë është hap pragmatik, që shkollimin e bën më tërheqës dhe më produktiv.

Si duhet përdor ky doracak?

Shpresojmë se ky doracak në një farë mënyre do të merr formën e një bisede profesionale me ju, lexues. Gjatë gjithë tekstit i bëjmë thirrje lexuesit që disa masa që mund të identifikohen në mënyrën e udhëheqjes së shkollës me shtrirje të ndryshme të praktikës demokratike t’i krahasojnë me gjendjen në shkollën e tyre. Ky është hapi i parë në këtë proces. Filloni me atë se ku ndodheni ju dhe shkolla juaj në këtë moment dhe përfundoni me planifikimin e hapave që duhet ndërmarrë, në mënyrë që atë ta përparoni në aspektin demokratik. Disa këshilla dhe nxitje shpresojmë se në rrugën e tillë do t’ju ndihmojnë. Do t’i paraqesim situatat ose indikatorët që i konsiderojmë të përbashkët dhe do t’ju japim shkas që të krahasoni pikëpamjen tonë me përvojën tuaj. Shpresojmë se kjo është mënyrë e dobishme e punës së përbashkët të kolegëve që punojnë punë të njëjtë.

Me metodën e këtillë, përmes dy kapitujve të shkurtër, së pari do të sqarojmë se çka nënkuptojmë me *qeverisje demokratike të shkollës* dhe cilat janë përparësitë që qeverisja e tillë ua sjellë institucioneve.

Pas kësaj kalojmë në pjesën kryesore të doracakut. Në kapitullin e katërt bëhet fjalë për katër fusha kryesore në qeverisjen e shkollës. Shpresojmë se në atë rast do të dëshironi të bëni analizë të njëjtë për pyetje tjera të rëndësishme për ju, duke përdor tabelën e njëjtë të planifikimit nga Shtojca I., por, ju lutemi, jo para se ta lexoni deri në fund këtë doracak!

Vlerësimi se si funksionon shkolla për sa u përket fushave kryesore tregon se në çfarë mase ajo kontribuon në zbatimin ose moszbatimin e EQD-së. Veprimin e tillë e masim me identifikimin e katër fazave të zhvillimit demokratik të cilat mund të jenë të dallueshme në shkollë, nga faza e parë, ku nuk ka asnjë gjurmë të veprimit demokratik (ekziston i vjetri – autoritar), deri në formën e avancuar të jetës demokratike (faza e katërt).

Kapitulli i pestë i shtjellon këto ide, duke shqyrtuar vlerat të cilat e nënkuptojnë mënyrën e tillë të funksionimit dhe format e sjelljes që dalin nga këto vlera. Kapitulli i gjashtë shpresojmë se ofron ide dhe strategji të mjaftueshme për hapat që duhet ndërmarrë ndërmjet fazave të veçanta, të shtjelluara në kapitujt paraprak.

Kapitulli i shtatë merret me çështjet që i hasim shpesh e që i referohen zhvillimit të praktikës demokratike në shkolla: çështjet e tilla shpesh janë rezultat i natyrës dhe i shqetësimeve të përhapura për braktisjen e pushtetit, dhe shpresojmë se në këtë kapitull brengat e tilla do t'i largojmë ose zbusim.

Kapitulli i ardhshëm sjell shumë shembuj të praktikës së mirë nga gjithë Evropa. Kapitulli i nëntë jep zgjidhje alternative për shqetësimet dhe brengat, shqyrton disa karakteristika dhe modele të përbashkëta që ka mundësi të hasen në një shkollë e cila ka bërë hapa të konsiderueshëm në rrugën drejt demokracisë: këta shembuj të praktikës së mirë mund t'i japin lexuesit ide për strategjitë, të cilat mund t'i vënë në provë në shkollat e tyre.

Shtojca e I-rë është një tabelë e zbrazët e cila do tu mundësojë të bëni analizën tuaj, duke përvetësuar qasjen e përshkruar në doracak. Dhe në fund, Shtojca e II-të, e përgatitur nga Delphine Liégeois, këshilltare në Këshillin e Evropës, jep një pasqyrë për të kaluarën e EQD-së për politikën e edukimit në Evropë dhe për punën e Këshillit të Evropës.

Shpresojmë se ky doracak do të jetë interesant dhe tërheqës, dhe mbi të gjitha do të jetë i dobishëm dhe i lehtë për tu përdorur.

P.s. Mendoj që kjo pjesë duhet të shtohet në fillim ose në fund të librit, jo këtu.

Për autorët

Elisabeth Bäckman është drejtore e gjimnazit Tullinge Gymnasium, një shkollë e mesme publike e përzier në jug të Stockholmit me 660 nxënës të moshës nga 16 deri 19 vjet. Mund ta kontaktoni në email adresën: elisabeth.backman@edu.botkyrka.se.

Bernard Trafford është drejtore e gjimnazit klasik Wolverhampton (Grammar School), një shkollë e mesme private e përzier në Anglinë qendrore (220 km nga Londra) me 670 nxënës të moshës nga 10 deri 18 vjet. Mund ta kontaktoni në email adresën info@bernardtrafford.com.

2. Çka është qeverisja demokratike e shkollës?

Drejtorët e shkollave duhet të kenë parasysh shumë faktorë të rëndësishëm në punën e tyre operative dhe strategjike: legjislacionin, kurrikulat, autoritetet lokale, prindërit, nxënësit, mjetet materiale, mjedisin socio-ekonomik, konkurrencën, etj. Shumë prej këtyre faktorëve ndryshojnë vazhdimisht dhe janë jashtë kontrollit të drejtorit të shkollës. Administrimi i mirë nuk është i mjaftueshëm. Drejtori i shkollës sot punon “në një sistem pak a shumë të decentralizuar, i cili bazohet në bashkëveprim të ndërlikuar të shumë partnerëve autonom”.¹ Shprehjen “qeverisje e shkollës” e hasim në gjithë doracakun si përkufizim më i gjerë i udhëheqjes, duke përfshirë aspektet ligjore dhe ideologjike. “Demokratike” do të thotë se qeverisja e shkollës bazohet në vlerat e të drejtave të njeriut, autorizimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve, personelit dhe palëve tjera të interesuara në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë.

Halász-i bën dallimin ndërmjet “qeverisjes” dhe “administrimit” në shkollë: këtu është me rëndësi të theksohet ndërlidhja e ngushtë e këtyre dy termave me kuptime shumë të ndryshme. Derisa nocioni “qeverisje” përdoret për të theksuar natyrën e hapur të shkollave dhe sistemit edukativ, nocioni “administrim” përdoret për të theksuar në radhë të parë dimensionet teknike dhe ligjore (instrumentale) të qeverisjes. Qeverisim ato gjëra dhe krijesa, sjellja e të cilave nuk mund të parashihet plotësisht (p.sh. për shkak të ekzistimit të njësive autonome të afta që të mbrojnë interesat e tyre dhe të negociojnë për zgjidhje alternative). Administrojmë me gjërat dhe krijesat, sjellja e të cilave lehtë mund të parashihet. Kur ne qeverisim, ne negociojmë, bindim, vendosim kushte, bëjmë presion, etj, sepse nuk kemi kontroll të plotë mbi ata me të cilët qeverisim. Kur administrojmë, tentojmë të japim udhëzime, sepse konsiderojmë se kemi të drejtë të fuqishme dhe legjitime që ta bëjmë këtë. Kur bëjmë fjalë për institucionet edukative, preferojmë të përdorim nocionin “qeverisje”. Kur bëjmë fjalë për shkollat si njësi organizative, më shpesh përdorim nocionin “administrim”. Por, pasi që shkollat bëhen institucione gjithnjë e më të hapura, të rrënjosura thellë në mjedise specifike lokale socio-ekonomike, dhe që karakterizohen me një grup të interesave të ndryshme dhe të ndërlikuara, në këtë nivel preferojmë të përdorim termin „qeverisje“.

Pasi që disa faktorë vështirë kontrollohen vetëm duke u bazuar në pushtetin ekzekutiv, qasja e hapur dhe demokratike në shkollën moderne është mënyrë e vetme për udhëheqje të qëndrueshme dhe të suksesshme. Por, qeverisja demokratike e shkollës nuk është thjeshtë mjet për mbijetesën e drejtorit të shkollës; ekzistojnë arsye tjera, shumë më të rëndësishme.

Arsyet etike

Në teori ekziston pajtim i përgjithshëm për vlerat demokratike: “Të gjithë njerëzit janë të lindur të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të drejtave të tyre.”² “Fëmija që është i aftë të formojë pikëpamjet personale, ka të drejtë që ato t’i shprehi, si mendim, bindje dhe besim të lirë.”³ Praktikisht çdo shtet, madje edhe çdo shkollë duhet të hartojë politika të kësaj natyre. Por, nëse vërtetë dëshirojmë të vëmë në jetë vlerat demokratike në shoqëri, ato duhet praktikuar në jetën e përditshme. Kjo ka rëndësi të veçantë për udhëheqësit e të gjitha organizatave, e posaçërisht shkollave.

¹ Halász, Gabor: Qeverisja e shkollave në sistemin edukativ në erën e diversitetit (Governing schools and education systems in the era of diversity): Ligjëratë e përgatitur për sesionin e 21 të Konferencës së përhershme të ministrave të arsimit të Evropës për „arsimin ndërkulturor“. Budapest, 2003.

² Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, 1948.

³ Konventa për të drejtat e fëmijës, nenet 12 - 14., KB 1989.

Arsyet politike

Përpjekjet e mirëfillta për shtet demokracik, duhet të jenë evidente dhe të praktikohen që nga mosha e hershme. Në vendet me demokraci të vjetër ekziston rrezik i madh që të rinjtë ta konsiderojnë demokracinë si të natyrshme, dhe në këtë mënyrë të humbin interesimin për pjesëmarrje. Aty ku historia e demokracisë është e shkurtër, dhe themelet e sajë të lëkundshme, çdo pengesë në zbatimin e sjelljes së këtyllë mund të rezultojë me heqjen e të drejtave. Por, nëse nga përvoja praktike keni mësuar të tejkaloni së paku disa prej problemeve të zakonshme gjatë vendosjes demokratike, besimi juaj në demokraci me gjasë do të rritet, dhe do të jeni të gatshëm të merrni pjesë aktive në jetën politike në nivel lokal, dhe ndoshta edhe në nivelin shtetëror.

Shoqëria që ndryshon shpejtë

Është e pamundur ta ndalim dhe ta kontrollojmë vërshimin e informacioneve. Fëmijët tonë nuk mund t'i mbrojmë nga kjo. Nga ana tjetër, sot rinia është gjenerata më e informuar. Prandaj, si mund t'i mësojmë këta të rinj që të zgjedhin dhe gjykojnë, nëse nuk jemi aty të vendosim cili informacion është i mirë, e cili jo? Në vend të tentimeve të pasuksesshme të censurimit dhe kufizimit, duhet t'i mësojmë të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur.

Sot po ndodhë zhvendosja e vlerave nga ato grupe drejt atyre individuale, dhe ekziston tendenca që të ndihemi më tepër si pranues se sa si qytetarë në shoqëri me mirëqenie sociale. Kur prindërit nuk janë të kënaqur në një farë mënyre me shkollën, të cilën e ndjek fëmija, nuk ndërmarrin veprime politike, nuk vendosin kontakt me drejtorin e shkollës, as nuk aktivizohen në Këshillin e Prindërve. Në vend të kësaj, shumë më shpesh, për pasojë, kemi ndjenjën e ftohjes nga shkolla, tërheqjen nga angazhimi i vërtetë në edukimin e fëmijës, ose madje edhe pajtimin e heshtur të prindërve për mosvijim e shkollës nga ana fëmijës. Në komunitetet, ose në shoqëritë ku kjo është e mundur, prindërit mund të transferojnë fëmijën e tyre në shkollë tjetër. Të gjitha këto ushtrojnë ndikim negativ në edukimin e fëmijës, në shkollë ose në të dyja këto. Prandaj, për të shtuar interesimin për qytetari aktive, fëmijëve tonë, gjatë kohës kur ata formohen si personalitete, duhet treguar se ia vlen pjesëmarrja në vendimet e përbashkëta – dhe, përveç kësaj, kjo ofron edhe kënaqësi.

Shoqëria njerëzore po ndryshon shpejtë dhe në vazhdimësi. Këtu duhet përmendur disa gjëra me të cilat do të ballafaqohemi në fillim të shekullit 21. Sipërmarrjet dhe njerëzit shpërngulen prej një skaji në skajin tjetër të botës, duke ndryshuar në këtë mënyrë strukturën ekonomike, demografike dhe kulturore. Risetë teknike ofrojnë mundësi, por edhe rreziqe të reja. Bashkësia shtetërore ose ajo lokale i ekspozohet por edhe është në ndërveprim me forcat globale, të cilat janë jashtë kontrollit demokratik. Nga ana tjetër, duhet pranuar të gjitha efektet pozitive që ka globalizimi në jetën tonë të përditshme, duhet trajtuar diversitetin dhe ndryshimet si mundësi, dhe fëmijëve tanë duhet dhënë edukim të drejtë në një botë të këtyllë.

3. Cilat janë përfitimet nga qeverisja demokratike?

Qeverisja demokratike e shkollës është e mirë për shkollën tuaj sepse....

1. ... përmirëson disiplinën

Vërejtja e parë e përfshirjes të palëve të interesuara në vendimmarrje, siç janë nxënësit, rëndom i referohet disiplinës. Nëse nxënësit nuk u binden madje edhe rregullave të thjeshta

dhe të caktuara me ndëshkime të qarta, nëse nuk respektohen ato rregulla, si mund të presim që ata të sjellin vendime të pjekura dhe të përgjegjshme? Por, përvoja dhe hulumtimet kanë treguar se nxënësve të cilëve u kushtohet më shumë kujdes, bëhen më të përgjegjshëm. Rregullat janë të domosdoshme, por udhëheqja që bazohet në besim/bindje është shumë më e qëndrueshme se sa udhëheqja me kërcënime. Kjo funksionon edhe më mirë nëse nuk vëzhgohet.(????)(ndoshta mbikëqyret.

2. ... përmirëson të nxënit

Të nxënit është diçka individuale. Mësimdhënësi mund të ketë një ide të caktuar për atë se si duhet mësuar, por stili i të nxënit ndryshon prej një personi në tjetrin. Në një mjedis demokratik, nxënësve u jepet liri më e madhe në zgjedhjen e mënyrës së të nxënit, por gjithashtu, të paktën në një farë mase, edhe se çka duhet të mësojnë. Problemet e suksesit të dobët dhe mungesës së motivimit shpesh zvogëlohen nëse nxënësit i mundësohet liri më e madhe në zgjedhjen se çka dhe si do ta mësojë, dhe, nëse është e mundur, edhe për mënyrën e vlerësimit.

Gustav Trolen jep mësim nga historia në gjimnazin në Tullinge, një shkollë e mesme e lartë në Suedi. Gjatë mbajtjes së kursit ka tri vlerësime. Për çdo vlerësim, nxënësi mund të zgjedhë shkrimin e një punimi, përgjigje në pyetje në testin tradicional, ose dhënien e provimit me gojë. Ka vetëm një kufizim: tre provimet nuk mund të jenë të tipit të njëjtë. Duhet dalluar së paku njëri nga të tjerët. Kjo liri e zgjedhjes ndoshta edhe nuk duket aq e përkryer, por, për shkak të kësaj, nxënësit janë me vetëbesim më të lartë dhe kjo u ndihmon atyre që të zvogëlojnë nervozizmin

3. ... zvogëlon konfliktet

Kur një grup i njerëzve kalon shumë kohë së bashku, gjatë një periudhe relativisht të gjatë, gjithmonë ekziston rreziku për konflikt. Dallimet dhe mungesa e mirëkuptimit gjatë shoqërimit në shkollë shumë lehtë mund të rrisë jotolerancën, diskriminimin, frikësimin e më të vegjëlve, madje edhe dhunën. Në mjediset autoritare, në të cilat statusi dhe pozita shoqërore janë më të rëndësishëm se sa p.sh. të drejtat individuale, njerëzit, për të mbijetuar, ndiejnë nevojën e bashkimit për tu mbrojtur ose për të realizuar favorizimet individuale. Aty është mjedis i përshtatshëm për diskriminim dhe për frikësim të më të vegjëlve. Nëse keni sukses të fusni ndjenjën e respektimit reciprok, do t'ia dilni që oborrin e shkollës ta shndërroni në një vend tërheqës dhe të sigurt.

4. ... e bënë shkollën më konkurruese

Decentralizimi i qeverisjes së shkollës dhe konkurrenca ndërmjet shkollave janë vërtetë fenomene të reja në shumë vende të Evropës. Veçanërisht, në mjediset urbane konkurrenca mund të jetë e ashpër/fortë.

Qytetarët bashkëkohor evropian janë të informuar mirë dhe të arsimuar, prandaj dhe të drejtat qytetare i konsiderojnë si të natyrshme. Presin që shoqëria të respektojë dëshirat dhe nevojat e tyre që kanë të bëjnë me fëmijët e tyre, si dhe nevojat dhe dëshirat e vetë fëmijëve të tyre. Fëmijët nuk edukohen që vetëm t'i dëgjojnë autoritetet/mësuesit/ pa diskutim. Shkollat duhet që t'u përshtaten pikëpamjeve të tilla. Nëse prindërit kanë përshtypje se fëmijët e tyre nuk trajtohen me respekt përkatës, ka gjasa të fitojnë një kundër disponim ndaj shkollës – dhe, kur kanë mundësi, edhe ta ndërrojnë atë.

5. ... siguron demokraci të qëndrueshme në të ardhmen

Fëmijët nuk veprojnë si u themi ne; ata veprojnë sikurse ne. Është e padobishme të flitet për demokraci në shkollat tona nëse ne vetë nuk e praktikojmë atë. Nuk është e mjaftueshme që nxënësit të mund të vendosin vetëm për gjëra të rëndomta, p.sh., për ngjyrën e mureve të klasës kur është e nevojshme të ringjyrosen ato. Atyre duhet dhënë mundësi influence, dhe në atë mënyrë duhet mësuar /për përgjegjësitë për pjesëmarrje të vërtetë në çështjet të cilat janë qenësore për mësime dhe për jetën e tyre të përditshme në shkollë, siç do të përmendim p.sh. disa: metodat e mësimit, parimet ose politikat e shkollës, planifikimin e sezonit apo semestrit shkollor, çështjet e buxhetit dhe të punësimit të punëtorëve të rinj. Është e qartë se kjo nuk arrihet brenda natës dhe nuk ekzistojnë metoda standarde të përshtatshme për të gjithë, por, jemi të bindur se kjo është mënyra më e mirë që të realizohet edukimi për qytetari demokratike në Evropë.

Në kapitujt në vazhdim përshkruhen më hollësisht përfitimet nga qeverisja demokratike e shkollave dhe mënyrat si mund t'i realizoni përfitimet e tilla – si dhe disa karakteristika tjera, siç është mjedisi tërheqës i punës në shkollë - pa frikë se kjo do të shpie në kaos dhe në parregullsi.

4. Fushat kryesore për qeverisje demokratike të shkollës: shqyrtimi i parë

Si e vlerëson drejtori gjendjen e shkollës së tij se si qëndron ajo në pikëpamje të qeverisjes demokratike? Mënyra se si është udhëhequr, administruar dhe drejtuar shkolla, dhe në çfarë mase e promovon edukimin për qytetari demokratike (EQD)? A është e mundur të vlerësohet se sa ka përparuar shkolla në rrugën e realizimit të demokracisë? Ose edhe sa rrugë i ka mbetur?

Një prej mënyrave me të cilën mund të bëhet matja e këtillë është që të merret në shqyrtim një aspekt i shkollës dhe të shihet se si funksionon në atë fushë në raport me tre principet e Këshillit të Evropës për EQD-në (shih shtojcën II). Principet e tilla janë:

- Të drejtat dhe përgjegjësitë
- Pjesëmarrja aktive
- Respektimi i diversitetit

Është e qartë se disa fusha të aktivitetit dhe mënyra se si merret shkolla me ta, kanë më tepër rëndësi se sa të tjerat në pikëpamje të vlerësimit se në çfarë mase është demokratike qeverisja e shkollës; ose sa larg ka shkuar me demokraci, ose qeverisja e shkollës është krejtësisht autoritare. Kemi identifikuar katër Fusha të këtilla:

- Qeverisja, udhëheqja dhe përgjegjësia publike
- Edukimi me përqendrim në vlera
- Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja: konkurrenca dhe vetëvendosja
- Disiplina e nxënësve



Këshilli i klasës në Gjimnazin klasik në Wolverhampton, Mbretëri e Bashkuar

Shkollat natyrisht se mund të gjejnë fusha të tjera të rëndësishme së njëjtë ose më të madhe se këto: këto katër fusha janë zgjedhur sepse janë shembuj që japin një trajtim mjaft të gjerë. Mënyra e zgjedhur se si qeveriset, udhëhiqet, mban vetveten dhe se sa konsiderohet përgjegjëse për shkollën, është pashmangshëm tregues kyç për atë se në çfarë mase funksionimi i saj është demokratik. Në mënyrë të ngjashme, nëse pranojmë se edukimi është (ose duhet të jetë) i drejtuar në vlera, atëherë vlerat e tilla duhet rrënjësuar thellë në vlerat e demokracisë, nëse shkolla promovon sinjerisht EQD-në: prej këtu rrjedh Fusha e rëndësishme 2.

Fusha e tretë e rëndësishme mund të duket si përzierje interesante e temave ose motivimeve, por ndërmjet tyre ka bashkëveprim: të gjitha janë të ndërlidhura. “Bashkëpunimi dhe komunikimi” i referohen mënyrës se si funksionon shkolla përbrenda dhe si reagon në atë kuadër ndaj komunitetit që i shërben, ose edhe ndaj nxënësve për të cilët ekziston si dhe për prindërit e tyre që janë gjithashtu palë të interesuara. “Bashkëpunimi dhe komunikimi” gjithashtu janë shumë të ndërlidhur me atë se në çfarë mase shkolla është partner aktiv dhe i gatshëm për bashkëpunim me organizatat tjera: p.sh., a i drejtohet komunitetit lokal të biznesit vetëm kur janë në pyetje të hollat, ose a kërkon shkolla të krijojë marrëdhënie të sinqerta reciproke dydrejtimshe me ta me përfitim për të dy palët? “Konkurrenca dhe vetëvendosja” janë bashkuar në kuadër të të njëjtës Fushë sepse synimi për përmirësim të shkollës në tërë Evropën (që në shumë shtete bashkohen me konkurrencën ndërmjet shkollave të krijuar nga sistemi shtetëror qeverisës), nëse nuk administrohet me kujdes, mund të ndikojë fuqishëm kundër bashkëpunimit dhe komunikimit demokratik. Gjykimi i tillë në këtë fushë mund të përfshijë vlerësimin se deri në çfarë mase shkolla është e aftë të mbajë në ekuilibër dhe të administrojë tendosjet ndërmjet bashkëpunimit dhe konkurrencës. Në demokraci, shpesh detyrohemi të bëjmë marrëveshje në mes kësi kontradiktash, por kurrsesi t’i fshehim ose të lejojmë që kontradiktat të zhvillohen në konflikt midis njerëzve.

Si Fushë të katërt të rëndësishme kemi zgjedhur “disiplinën e nxënësve” sepse ajo (që është më saktë jodisiplinë) është arsye për brengosje në shumë shkolla, në të vërtetë në sistemin e përgjithshëm shkollor në Evropë. Është ide e gabuar, se demokracia në shkollë është e papajtueshme me disiplinën e mirë. Kjo është çështje në vete, gjersa tri fushat e tjera përshijnë tema të ndryshme: thjeshtë të shfrytëzohet si një shembull me rastin e identifikimit të Fushave tuaja të rëndësishme dhe shqyrtimin e tyre me metodën tabelare.

Do të ishte thjeshtëzim të pretendohet se shkollat janë plotësisht demokratike kundruall cilës do fushe të rëndësishme – pa përmendur fushat tjera që do t'i identifikojnë vetë shkollat – ose plotësisht jomiqësore ndaj qeverisjes demokratike. Demokracia shpesh cilësohet si rrugëtim, dhe çdo shkollë duke tentuar të vendosë pozitën e saj në këtë rrugëtim, pashmangshëm do të gjejë që në disa fusha ka kaluar rrugë të gjatë e në disa tjera posa ka filluar. Kjo është mjaft e natyrshme dhe nuk do duhej të jetë arsye për dëshpërim! Përkundrazi, duhet të jemi të inkurajuar me suksesin dhe të jemi të vendosur për të trajtuar fushat në të cilat akoma nuk kemi shkuar mjaft larg.

Shqyrtimi i këtyre katër fushave të rëndësishme, duke pas parasysh tri principet për EQD-në, është bërë në formë tabelare. Me vlerësimin e katër fushave tona të rëndësishme kundrejt tre principeve për EQD-në, kemi synuar të identifikojmë katër fazat në rrugën drejt demokracisë dhe të paraqesim karakteristikat evidente të secilës prej tyre, duke i ilustruar ato me komente që si zakonisht mund të dëgjohen në shkollë, në një situatë të këtillë.

Hapi i parë në secilin rast përshkruan shkollën e cila akoma nuk e ka filluar fare rrugëtimin drejt demokracisë, dhe e cila, në vend të kësaj, ka përkrahur vlerat e vjetra autoritare.

Është e qartë se faza e katërt përshkruan shkollën në të cilën vlerat dhe praktikat demokratike kanë depërtuar në çdo aspekt të jetës në shkollë. A e bën shkollën e tillë të fazës së katërt një “shkollë të mirë”? Besojmë se po. Ekziston pajtim, gati i plotë, për atë se qëllimi i shkollës në demokraci është t'u mundësojë fëmijëve të zhvillojnë maksimalisht potencialin e tyre në pikëpamje: të të nxënit; të zhvillimit të shkathtësive jetësore; të aftësive ose të kompetencave të tyre që plotësisht luajnë rolin përkatës në shoqërinë demokratike. Sado të larta të jenë të arriturat teorike (nga lëndët mësimore), nëse shkolla nuk ka sukses të nxënësit në dy kontekstet tjera, ajo nuk mund të konsiderohet shkollë e mirë.

Është ndoshta e rëndësishme që fushat përbërëse të tabelave të mëposhtme bashkohen duke avancuar drejt fazës së katërt. Gjatë analizës së bërë kemi konstatuar se sa më larg që ka shkuar shkolla në rrugën drejt demokracisë, gjithnjë e më konsistent bëhet stili dhe mënyrat e veprimit të saj në fushat e funksionimit – kështu që në tabelat tona fushat bashkohen. Ndoshta nuk do të duhej befasuar nga kjo.

Përshkruesit ose përcaktorët e shfrytëzuar në tabela janë mjaft të kufizuar ose me mungesë. Pasi që një herë të keni punuar përmes tabelave dhe t'i ndërlidhni ato me përvojën tuaj në shkollë, do të keni nevojë që të kaloni në kapitullin e ardhshëm, i cili analizon shumë më gjithanshëm vlerat dhe sjelljet të cilat e mbështesin dhe e karakterizojnë çdo Fazë, në çdo njëerën prej katër Fushave të rëndësishme në raport me tre Principet.

Fusha 1. Qeverisja, udhëheqja, administrimi dhe përgjegjësia publike

		Të drejtuar dhe përgjegjësitë		Respektimi i divestitetit	
Interpretimi i fushave kryesore nga EQD-ja: përshkruesit e përgjithshëm	(a) Udhëheqja i përgjigjet qeverisë (lokalte ose qendrore) ose këshillit të shkollës – “autoriteti më të lartë” – por merr parasysh dhe favorizon funksionin kryesor në lidhje me palët e interesuara	(b) Udhëheqja e ndan pushtetin me palët e interesuara.	(c) Administrata dhe çështjet e përditshme ose rutinore marrin parasysh të drejtat e atyre që janë të dëmtuar nga vendimet: ekzekutimi i vendimeve respekton dimensionin etik dhe dinjitetin njerëzor.	Pjesëmarrja aktive	Udhëheqja njeh dhe promovon diversitetin.
Faza 1. Karakteristikat Komenti karakteristik	Udhëheqja e konsideron veten përgjegjëse vetëm ndaj autoriteteve më të larta (burokrat ose person autoritar). “Unë jam përgjegjës.”	Autoritar, pa u këshilluar. “Unë di më së miri!”	Përgjegjësi të deleguara si punë që duhet kryer pa liri veprimi. “Tazhdo me punën tënde.”	Udhëheqja vetë merr përgjegjësimë – marrje e guximshme mbi vete e barrës së përgjegjësisë. “Unë jam përgjegjës për ju.”	Udhëheqja e pranon por nuk e vlerëson diversitetin. “Kushdë?? që je jashitë kësaj shkolle, këtu je vetëm nxënë.”
Faza 2. Karakteristikat Komenti karakteristik	Udhëheqja ka disa njohuri për palët e interesuara dhe për efektet e mundshme negative të palët e interesuara. “Unë e marrë përgjegjësinë, madje edhe kur është vështirë.”	Udhëheqja i njofton të tjerët para se të zbatojë vendimin. “Politikë e dhyerje të hapura – kokëfortë!”	Lejohet njëfarë lirie veprimi, por rreptë e kontrolluar. Qëllim është puna e mirë ose në rregull e institucionit. “Bëre atë në mënyrën tënde - por së pari konsultohu me mua.”	Përgjegjësi retorike pa aksion – bartje e guximshme e barrës, e shoqëruar me martirizim. “Pse ju nuk e merrni përgjegjësinë?”	Udhëheqja në masë të caktuar është e vetëdijshme për gjini dhe diversitet por nuk ndërmerr asgjë që t'i çmojë ato. “Kisha pritur që atë ta bëjë një vajtë, por jo një djallë i rritur si ti.”
Faza 3. Karakteristikat Komenti karakteristik	Udhëheqja i trajton nevojat e palëve të interesuara me rëndësi të njëjtë si ato të autoriteteve më të larta dhe bën aleancë me grupe të ndryshme trysnie ose të lobimit. “Unë e shfrytëzoj autonominë time dhe siguroj shokë për t'iu përgjigjur kërkesave të palëve të interesuara.”	Konsultime të rasit/foformale, ku informatat mblidhen dhe shpërndahen në mënyrë të rastësishme. “Politikë e dhyerje të hapura – mendjehapur!”	Atyre që kanë përgjegjësi ju jepet liri e plotë e veprimit, por vetëm në fusha shumë periferike: qëllim parësor është akoma ushtrimi i mirë i veprimitarisë themelore. “Unë do t'iu lejoj ta kryeni punën.”	Udhëheqja është duke punuar sqmërisht në drejtim të përgjegjësisë së përbashkët – e cila me sa duket ndahet me të tjerët vetëm në fushat “e lehta” (festivalet, aktivitetet jashtëmësimore etj.) “Pëlqejmë të ndajmë përgjegjësitë për të mirën e përbashkët.”	Ndërgjegjësimi për diversitet; veprimi në rastet më të lehta (p.sh. publikimet shkollore) demonstroi diversitetin; ekzistojnë rregullat jodiskriminuese; pranohet diversiteti në religjion; politika e pranimi bazohet në gjithëpërfshirje; kujdesi për nevoja speciale dhe mundësi të barabarta nxitet pavarësisht nga e kaluara apo gjinia. Por, mësimdhënia dhe kurrikulat pak e marrin parasysh diversitetin.

<p>Faza 4. Karakteristikat</p>	<p>Udhëheqja punon për të ndërtuar konsensus/siguri/besim ndërmjet niveleve të ndryshme, njëh formalisht interesat e palëve të interesuara dhe shfrytëzon eksperiencën e saj për të ndikuar në vendimet politike.</p>	<p>Konsultimi zyrtar dhe jozyrtar rezulton me rrjedhje të sistemuara dhe të strukturuar të informacioneve.</p>	<p>Vendimet merren në nivelin përkatës ("subsidiariteti") me liri të plotë veprimi. Por, interesat, të drejtat dhe detyrat e nxënëseve/palëve të interesuara kanë përparësi ndaj "funksionimit të rregullt". Rrjedhja e informacionit është e mirë dhe ka shprehje për konsultim të plotë dhe të strukturuar. Nëse kërkohet ndryshim i sistemuara për implementim, kjo u raportohet niveleve më të larta dhe ndryshimi i tillë negociohet/zbatohet.</p>	<p>Ndaria e përgjegjëseve edhe për fushat e vështira (buxheti, kurrikulat, planifikimi strategjik, trajnimi i mësimdhënësve në shkollë, vetë-përmirësimi, vlerësimi, mësimdhënia, etj.).</p>	<p><i>"Jemi krenarë që shkolla jonë është gjithëpërfshirëse. Le të vazhdojmë me mësimet."</i></p> <p><i>"Diversiteti është një nga përparësitë e shkollës tonë."</i></p>
<p>Komenti karakteristik</p>	<p><i>"Çka mund të bëj unë për ta shfrytëzuar më së miri situatën (e imponuar)?"</i></p>	<p><i>"Të gjithë mbajmë përgjegjësi për vendimmarrje."</i></p>	<p><i>"Së bashku mund t'ia dalim"</i></p>	<p><i>"Kjo është shkolla jonë."</i> <i>"Aty jemi së bashku."</i></p>	<p><i>"Diversiteti është një nga përparësitë e shkollës tonë."</i></p>

Fusha themelore 2		Edukimi i përqendruar në vlera			
		Pjesëmarrja aktive		Respektimi i diversitetit	
Të drejta dhe përgjegjësitë		(a) Nxënësit kanë	(b) Merren parasysh stilet	(a) Kurrikula është i	(b) Librat shkollorë
Parimet e EQD/EDNJ-së janë përcaktuar në kurrikula		disa të drejta në vendosjen për atë se çka duhet mësuar.	të ndryshme të të mësuarit.	përshtatshëm për të gjithë nxënësit.	duhet të jenë të paanshëm.
Kurrikulat shkollore nuk shprehin vlerat e EQD/EDNJ-së		Për përmbajtjen e detajuar duhet të vendosin autoritetet	Metodat e mësimdhënies janë të zgjedhura nga mësimdhënësit.	Kurrikulat kanë për qëllim bindjen/nënshkrimin.	Librat shkollorë mbështeten në grupin/pikëvështrimin dominant si normë, ndërsa vlerat e pakicës si shmangie.
“Detyra jonë është t’i mësojmë fëmijët të lexojnë dhe të shkruajnë. Pjesa tjetër u mbetet prindërve.”		“Zgjedhjen e temave më mirë e bëjmë specialistët.”	“Mësimdhënësit punojnë shumë më mirë kur përgatisin metodat e tyre mësimore.”	“Ajo që i duhet vendit (shkollës) tonë është rendi, e jo kaosi.”	“Kur jeni në Romë ju duhet mësuar të veproni si romakët.”
Vlerat e EQD/EDNJ-së përmenden në kurrikulë, por jo në formë urdhërore ose imperative.		Nxënëse u jepet mundësia të shprehin mendimin e tyre.	Nxënëse u jepen disa opsione se si të punojnë, por për to vendos mësimdhënësi.	Pranohen nevojat e veçanta. Prejardhjet e ndryshme kulturore shihen si e metë e cila mund të evitohet. Merren disa masa që të respektohet diversiteti.	Librat shkollorë anshëm ose paragykues mund të shfrytëzohen, por pjesët e përpërshtatshme të tyre nuk merren parasysh.
“Kjo pjesë e kurrikulës është e mirë. Është sikurse poezi.”		“Është më lehtë të mbahet rendi kur nxënëse u lejohet të shprehin mendimin e tyre.”	“Gjithmonë u lejojmë nxënëseve të zgjedhin rendim e zgjidhjes së detyrave.”	“Në shkollën time nuk kam vërejt ndonjë formë diskriminimi.”	“Nuk mund të sigurojmë libra të reja vetëm për shkak se librat e anshëm do të mund të shqetësonin një ose dy nxënës. Duhet të vendos prioritetet tjera.”
Vlerat e EQD/EDNJ-së janë dhënë në paragrafin e parë të kurrikulës si bazë e edukimit të përgjithshëm. Politikat e shkollave lokale theksojnë rëndësinë e respektimit të të drejtave njerëzore.		Mësimdhënësit inkurajohen të përfshijnë nxënësit në procesin mësimor. Mësimdhënësit dhe nxënësit planifikojnë së bashku. Ka hapësirë për zgjidhje individuale.	Mësimdhënësit inkurajohen të përfshijnë nxënësit në procesin mësimor. Mësimdhënësit dhe nxënësit planifikojnë së bashku. Ka hapësirë për zgjidhje individuale.	Kurrikula është i përshtatshëm për të gjithë nxënësit.	Librat e anshëm shkollorë nuk janë të lejueshëm.
“Besojmë shumë në respektimin e çdonjërit të përfshirë në këtë shkollë.”		“Ndihma për nxënësit që të zgjedhin temat e tyre është mënyra më e mirë për motivimin e tyre.”	“Nxënësit arrijnë rezultate shumë më të mira kur shfrytëzojnë metodat e tyre.”	“Kur nxënësit tonë largohen nga kjo shkollë multikulturore, ata do të kenë kualifikimet unike, shumë të dobishme në të ardhmen.”	Janë identifikuar dhe lartësuar të arriturat dhe karakteristikat unike kulturore të minoriteteve. Çështjet gjimore përcillen në mënyrë aktive.
Komenti karakteristik		“Besojmë shumë në respektimin e çdonjërit të përfshirë në këtë shkollë.”	“Besojmë shumë në respektimin e çdonjërit të përfshirë në këtë shkollë.”	“Do ta kontaktoj redaktorin menjëherë sot. Dëshirojmë të na kthehen të hollat tona.”	“Pse djemtë mendojnë se sporti i tyre është më i rëndësishëm?”
Interpretimi i fushave kryesore nga EQD-ja: përshkruesit e përgjithshëm					
Faza 1. Karakteristikat					
Komenti karakteristik					
Faza 2. Karakteristikat					
Komenti karakteristik					
Faza 3. Karakteristikat					
Komenti karakteristik					

<p>Faza 4. Karakteristikat</p>	<p>Vlerat e EQD/EDNJ-së nuk janë dhënë vetëm në kurrikulat në formë të shkruar, por janë elemente themelore dhe të qenësishme të funksionimit të jetës shkollore. Etosi ose tipari dominues i shkollës bazohet në spikatjen e barazisë dhe respektimit e të drejtave të njeriut: Udhëheqësit e shkollave “me veprim personal” u tregojnë të tjerëve për demokracinë dhe respektimin e tillë. “Nëse dikush trajtohet pa respektin e duhur në shkollën time, ndërpres çfarëdo pune që jam duke kryer dhe menjëherë intervenoj.”</p>	<p>Nxënësit njihen si njohës të mirë në mënyrën e tyre të mësimt.</p>	<p>Udhëheqësit e shkollave me vepra dhe fjalë tregojnë respektim dhe qëndrim të sinqertë ndaj diversitetit.</p>	<p>Ku nuk ekzistojmë tekste të paanshëm, shkolla përpilon materialet e saj???</p>	<p>Të mësuarit se si të merrresh me diversitetin konsiderohet si një kompetencë e vlefshme shtesë – për të gjithë nxënësit dhe mësimpldhënësit.</p>
<p>Komenti karakteristik</p>		<p>“Nxënësit janë njohës të mirë në mënyrën e tyre të mësimt – prej tyre gjithashtu mund të mësojmë shumë edhe ne mësimpldhënësit.”</p>	<p>“Si mund të mësojmë prej njëri tjetrit dhe të rritemi së bashku?”</p>	<p>“Bërija vetë është më mirë se sa librat e pavlerë.” “Demokracia ka mundësi të prodhojë materiale të saj.”</p>	<p>“Tash kemi filluar të kuptojmë se çka nënkuptojmë me përfshirje dhe diversitet.”</p>

Fusha themelore 3. Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja: konkurrenca dhe vetëvendosja e shkollës	
Principi i EQD-së	Të drejtat dhe përgjegjësitë
	<p>(a) Shkolla aktivisht synon vetëpërmirësim dhe (aty ku konkurrenca është politike nacionale) epërsi konkurruese – por gjithmonë me qëllim të fitimit të rezultateve më të mira të nxënësve dhe partnerëve/palëve të interesuara, jo për pozitë, pasuri ose pushtet.</p> <p>(b) Shkolla ka rol aktiv për kontributin e saj në mbarrëvajtjen e komunitetit të saj lokal: hapet për organizatat e jashtme që trajtojnë problemet, gjithmonë duke i vënë në vend të parë të drejtat dhe nevojat e nxënësve.</p> <p>(c) Prindërit dhe familja janë aktivë të nxënësve dhe shkollës dhe ekziston pranimiti i plotë i të drejtave dhe përgjegjësi nga të gjithë palët për sa i takon edukimit të fëmijëve.</p> <p>(a) Prindërit dhe familja janë partnerë aktivë të nxënësve dhe shkollës në edukimin e fëmijëve të tyre: Ekziston rrjedhje e dyanshme dhe e vazhdueshme e informacioneve ndërmjet shtëpisë dhe shkollës, ndërmjet shkollës dhe organizatave tjera.</p> <p>(b) Shkolla është aktivisht e përfshirë në jetën e komunitetit të saj: organizatat (e OJQ-ve ose të biznesit) janë të mirëseardhura si partnerë me rastin e përpilimit të kurrikulave dhe aktiviteteve mësimore - gjithmonë duke i vënë në rend të parë nevojat e nxënësve.</p> <p>(c) Në synimin e tyre për vetëpërmirësim (madje edhe në një ambient të konkurrencës) shkolla ndërton strategji të saj me ç'rast gjithmonë e ndan praktikën e mirë profesionale me institucionet tjera.</p>
Interpretimi i fushave kryesore nga EQD-ja: përshtatësia e përgjithshme	<p>(a) Shkolla duhet të dëshmohet se është më e mira në krahasim me të gjitha shkollat tjera, dhe së këndejmi, nxënësit duhet t'i dëshmojnë shkollës. "Kjo është shkolla më e mirë në zonë/rajon: ju duhet të dëshmoni se jeni në lartësinë e duhur të detyrës."</p> <p>(b) Synimi për vetëpërmirësim dhe rritje të standardëve nuk duhet të përjashtojë grupe të caktuara, të cilat do të mund të konsiderohen se pengojnë përparimin.</p>
Faza 1. Karakteristikat	<p>(a) Shkolla përqipet të sigurojë se ekziston komunikim i plotë në përfshirjen e grupeve që vështirë përfshihen në jetën publike ose të grupeve minoritare.</p> <p>(b) Synimi për Respektimi i diversitetit</p>
Faza 2. Karakteristikat	<p>(a) Shkolla është pasive kur janë në pyetje grupet publikoje</p> <p>(b) Synimi për Respektimi i diversitetit</p>
Faza 1. Karakteristikat	<p>(a) Shkolla është aktivisht e përfshirë në jetën e komunitetit të saj: organizatat (e OJQ-ve ose të biznesit) janë të mirëseardhura si partnerë me rastin e përpilimit të kurrikulave dhe aktiviteteve mësimore - gjithmonë duke i vënë në rend të parë nevojat e nxënësve.</p> <p>(b) Shkolla është aktivisht e përfshirë në jetën e komunitetit të saj: organizatat (e OJQ-ve ose të biznesit) janë të mirëseardhura si partnerë me rastin e përpilimit të kurrikulave dhe aktiviteteve mësimore - gjithmonë duke i vënë në rend të parë nevojat e nxënësve.</p> <p>(c) Në synimin e tyre për vetëpërmirësim (madje edhe në një ambient të konkurrencës) shkolla ndërton strategji të saj me ç'rast gjithmonë e ndan praktikën e mirë profesionale me institucionet tjera.</p>
Komentit karakteristik	<p>(a) Shkolla është pasive kur janë në pyetje grupet publikoje</p> <p>(b) Synimi për Respektimi i diversitetit</p>
Faza 2. Karakteristikat	<p>(a) Shkolla është pasive kur janë në pyetje grupet publikoje</p> <p>(b) Synimi për Respektimi i diversitetit</p>

<p>ngritur statusin e saj.</p>	<p>pjesë e bashkësisë së gjerë - por ajo ka pak ose aspak angazhim me bashkësimin.</p>	<p>nxënësvetë saj dhe në masë të caktuar edhe për shkak të prindërve të tyre, por në asnjë mënyrë nuk i konsideron partnerë.</p> <p><i>"Ua bëjmë shumë të qartë se çka presim prej nxënësvetë dhe prej prindërve të tyre."</i></p>	<p>interesuara - jo si pjesëmarrës por si subjekte të shollës së gjithëdijshme.</p>	<p>institucionet partnere - por tregon dyshim ndaj tyre dhe kërkon vetëm përkrahje materiale.</p>	<p>praktikën e mirë me qëllim të kërkimit të statusit - jo për të ndarë eksperimente me të tjerët.</p> <p><i>"Fitimi i publicitetit për risitë dhe të arriturat tona i kontribuon reputacionit tonë."</i></p>	<p>që vështirë përfshihen në jetën publike ose grupet minoritare: ajo konsideron se është përgjegjësi e tyre që të përfshihen në këtë e dëshirojmë.</p> <p><i>"Nuk mund t'i detyrojmë që të përfshihen; ato thjeshtë nuk përfshihen."</i></p>	<p>"nxënësit jostandard", duke i trajtuar ata si probleme (të mundshme) që duhet frenuar.</p> <p><i>"Ata janë të mirë derisa i përmbushin pritjet tona"</i>.</p>
<p>Faza 3. Karakteristikat</p>	<p>Bëhet trysni tek mësimdhënësit dhe tek standardeve të larta, pjesërisht për shkak të nxënësvetë, por edhe për shkak të konkurrencës.</p> <p><i>"Na nevojitet suksesi juaj - për shkak të juve dhe të shkollës."</i></p>	<p>Ekzistojnë kontakte të rregullta me prindërit dhe familjet e nxënësvetë; shkolla i mirëpret dhe i fton që të shprehin mendimin e tyre.</p> <p><i>"Dëshirojmë të dëgjojmë se çka keni për të na thënë."</i></p>	<p>Ekzistojnë informacione nga shkolla, dhe prindërit janë të mirëpritur të shprehin opinionin e tyre.</p> <p>Shkolla vendos lidhur me organizatat të cilat janë vizitorë të mirëseardhur, sidomos si ekspertë për t'i udhëzuar ose këshilluar nxënësit.</p> <p><i>"Mirëpresim vizitat e rregullta që i bëhen shkollës nga prindërit dhe shumë vizitorë tjerë"</i></p>	<p>Shkolla me gatishmëri i ndan shembujt e mirë nga praktika me shkollat tjera dhe me profesionistët.</p> <p><i>"Jemi gjithmonë të lumtur kur mund të ndajmë me ju përvojat tona të dobishme."</i></p>	<p>Shkolla bën përpjekje të konsiderueshme dhe ka sukses për t'i joshur dhe për t'i angazhuar që të përveçtojnë kulturën e shkollës grupet që vështirë përfshihen në jetën publike ose grupet minoritare.</p> <p><i>"Jemi krenar për mënyrën me të cilën nxisim dhe mbështesim diversitetin."</i></p>	<p>Shkolla bën përpjekje të konsiderueshme dhe ka sukses për t'i joshur dhe për t'i angazhuar që të përveçtojnë kulturën e shkollës grupet që vështirë përfshihen në jetën publike ose grupet minoritare.</p>	
<p>Faza 4. Karakteristikat</p>	<p>Cilësia e shkëlqyer është për nxënësit, edhe pse realisht shikuar nga kjo përfitojnë shkolla edhe bashkësia.</p> <p><i>"Dëshirojmë që ju të shquheni për shkak tuajin; por as neve kjo nuk na dëmton!"</i></p>	<p>Të gjitha palët e interesuara dhe vetë bashkësia konsiderohet se i kontribuojnë dhe përfitojnë nga shkolla.</p>	<p>Shkolla, të gjitha palët e interesuara dhe partnerët, i konsideron si kontribues të çmueshëm por edhe si përfitues potencial: më tepër se një partneritet, ky është një angazhim i vërtetë demokratik.</p> <p><i>"Të gjithë punojmë së bashku për të mirën e të gjithëve."</i></p>	<p>Shkolla, të gjitha palët e interesuara dhe partnerët, i konsideron si kontribues të çmueshëm por edhe si përfitues potencial: më tepër se një partneritet, ky është një angazhim i vërtetë demokratik.</p>	<p>Shkolla, të gjitha palët e interesuara dhe partnerët, i konsideron si kontribues të çmueshëm por edhe si përfitues potencial: më tepër se një partneritet, ky është një angazhim i vërtetë demokratik.</p>	<p>Shkolla, të gjitha palët e interesuara dhe partnerët, i konsideron si kontribues të çmueshëm por edhe si përfitues potencial: më tepër se një partneritet, ky është një angazhim i vërtetë demokratik.</p>	
<p>Komenti</p>							

karakteristik

--	--	--	--	--

Fusha themelore 4, Disiplina e nxënësit		Respektimi i diversitetit
Principi i EQD/EDNJ-së	Pjesëmarrja aktive	
Interpretimi i fushave kryesore nga EQD-ja: përshkruesit e përgjithshëm	Nxënësit pajtohen dhe negociojnë rregullat dhe marrin përgjegjësi për implementimin dhe respektimin e tyre përmes strukturave qeverisëse (p.sh. sistemi i kujdestarit për disiplinë) por edhe si “qytetarë të mirë”.	Nevojat e ndryshme dhe pritjet e nxënësve të grupeve minoritare janë të njohura dhe janë pjesë e debatuar dhe e negociuar e strukturës disiplinore e cila i përfshim të gjithë dhe zbatohet nga të gjithë.
Faza 1. Karakteristikat <i>Komenti karakteristik</i>	Udhëheqja e shkollës i vendos dhe i zbaton rregullat – madje edhe në rastin kur nxënësit nuk i pëlqejnë ose u reziston rregullave të tilla. “Ne do t’u tregojmë çka do të bëni dhe atë do ta bëni, përndryshe!”	Rregullat janë rregulla dhe nuk ka lehtësira për kulturë, mjedise shoqërore dhe nevoja të ndryshme. “Ju mbetet juve që të përshatani.”
Faza 2. Karakteristikat <i>Komenti karakteristik</i>	Udhëheqja e shkollës i vendos dhe i zbaton rregullat, por kërkon ndonjë reagim edhe nga nxënësit – dhe shpesh është e zhgënjyer. “Do t’u dëgjojmë se çka thoni: por ju e dini se shkolla di më së miri. Ju duhet të veproni.”	Shkolla ka disa informacione për diversitetin e nxënësve dhe mund të vendos disa rregulla duke pas parasysh dallimet (p.sh. veshja ose disa rite fetare). “E dimë se jeni të ndryshëm: do të bëjmë disa lëshime, por ju duhet të përshatani – ose përndryshe...!”
Faza 3. Karakteristikat <i>Komenti karakteristik</i>	Edhe pse ekziston një kufi deri ku janë të mundshme lëshimet, shumë rregulla diskutohen dhe negociohen me përfaqësuesit e nxënësve. „Për këtë mund të bisedojmë, por ekziston kufiri i poshtëm i asaj që pritet, ose përndryshe ka gjasa që ju të na zhgënjoni.”	Minoritetet janë përfshirë në konsultimin në të cilin kanë qasje. „Ju sigurojmë se minoritetet janë të përfshira në negociatat për rregullat.”
Faza 4. Karakteristikat <i>Komenti karakteristik</i>	Kodi i tërësishëm i mirësjelljes dhe rregullat e shkollës përpilohen në bazë të konsultimeve dhe negociatave me përfaqësuesit e nxënësve, duke pas parasysh se të gjitha minoritetet në tërësi janë të përfaqësuar: dhe nxënësit marrin rolin e “qytetarit të mirë” dhe/ose personit me pushtet (kujdestarit për disiplinë, vëzhgues) që implementojnë dhe kujdesen që rregullat të zbatohen. “Të gjithë do të përfshihen në tryezën e planifikimit, negocimit dhe të zbatimit të kodit të mirësjelljes, i cili të gjithëve u siguron rend, siguri dhe respektim reciprok.”	

5. Ku ndodhem unë? Vlerat dhe sjelljet

Pa marrë parasysh se cilat vlera dhe principe mund të jenë parashtruar në legjislacion ose dokumentet e politikave, ajo që llogaritet është sjellja e udhëheqësit. Kur vizitoni për herë të parë shkollën, shpesh mund të gjeni mjaft lehtë indikatorë (tregues) të shkallës së qeverisjes demokratike: intonacioni i mesazheve në tabelën e shpalljeve; mënyra se si sillen ndaj jush nxënësit ose personeli që i takoni rastësisht; gjendja e mureve dhe orendive, marrëdhëniet shoqërore në oborrin e shkollës dhe jashtë klasave; dhe shumë detaje tjera. Se në çfarë shkalle i ndajnë përgjegjësitë për shkollën drejtorët e shkollave, nxënësit dhe personeli vërehet nga sjellja e tyre në të gjitha nivelet.

Në këtë kapitull janë dhënë shembuj se si vlerat, e posaçërisht vlerat e EQD-së, ndikojnë në qeverisje dhe në jetën e përditshme të shkollës. Do të vështrojmë fushat kryesore të shqyrtuara në kapitullin paraprak.

5.1 Qeverisja, udhëheqja, administrimi dhe përgjegjësia publike

Faza 1.

Udhëheqja e konsideron veten përgjegjëse vetëm ndaj organeve më të larta të pushtetit (burokrat ose njeri i fortë).	Autoritar (i dorës së fortë) pa konsultime.	Përgjegjësitë të cilat delegohen si punë që duhet bërë pa liri të vërtetë veprimi.	Udhëheqja e merr vetë përgjegjësinë – marrje e guximshme e barrës së përgjegjësive.	Udhëheqja e pranon diversitetin, por nuk e vlerëson atë.
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------

Legjislacioni shtetëror, këshillat e shkollës, sindikatat, nxënësit, prindërit, bashkësia lokale – të gjithë i bëjnë udhëheqjes së shkollës kërkesa, që shpesh janë në kundërshtim ndërmjet veti. Cilës do t'i jep përparësi udhëheqja e shkollë nëse kërkesat janë në kundërshtim ndërmjet veti?

Udhëheqja e shkollës në rend të parë është përgjegjëse kryesisht ndaj autoriteteve me të larta. Në shkollë, udhëheqësi konsiderohet si përfaqësues i këshillit të shkollës dhe/ose i shtetit dhe respektohet në bazë të pozitës dhe gradës.

Në këtë fazë ndarja e përgjegjësive nuk vihet në pyetje. Madje nuk konsiderohet e nevojshme të konsultohen nxënësit ose personeli para marrjes së vendimeve, sidomos nëse rregullat ligjore janë të qarta dhe lehtë të interpretueshme. Nëse udhëheqja e shkollës e shfrytëzon një sugjerim të atij që është vartës i asaj udhëheqjeje, atë do ta paraqesë si sugjerim të tij.

Disa çështje rutinore mund të delegohen në nivele të tjera, me kusht që të ndiqen instruksione të detajuara. Kontrolli është i rëndësishëm.

Përgjegjësia dhe udhëheqja nuk mund të ndahen me të tjerët. Udhëheqja e merr përgjegjësinë e plotë për të gjitha veprimet dhe vendimet në shkollë. Është e gatshme gjithashtu që të pranojë përgjegjësinë dhe mospësuksin eventual. Shkolla gjithmonë përfaqësohet nga drejtori i saj.

Diversiteti është njëri prej problemeve të shkollës moderne. Është me rëndësi që të sillemi me njerëzit dhe me problemet pa dallim, në pajtim me normat dhe rregullat ekzistuese.

Komente karakteristike:

“Unë jam shef!”

“Unë di më së miri.”

“Ndoshta do të ishte më lehtë që puna të bëhej në mënyrën që propozoni, por këtu rregullat janë shumë të qarta.”

“E konsideroj vetveten si personifikim të çdo gjëje që paraqet kjo shkollë.”

Faza 2.

Udhëheqja është në masë të caktuar e ndërgjegjshme për palët e interesuara dhe efektet e mundshme negative tek këto palë.	Udhëheqja i lajmëron të tjerët para se të zbatojë vendimin.	Lejohet një shkallë e caktuar e lirisë së veprimit, edhe pse rigorozisht e kontrolluar. Qëllimi është funksionimi i mirë i institucionit.	Përgjegjësi retorike pa veprim – bartje e guximshme e barrës, e shoqëruar me martirizim.	Udhëheqja është e ndërgjegjshme në masë të caktuar për diversitetin, por nuk ndërmer asgjë për ta vlerësuar atë.
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Udhëheqje autoritare, sikurse në rastin e fazës 1, gjithnjë e më pak është prezent në Evropën moderne. Në fazën 2, akoma është i rëndësishëm lojaliteti ndaj niveleve më të larta të pushtetit, por hetohen një lloj tendence që të zbutet efekti i rregullave të përgjithshme tek individët e cenueshëm, edhe pse asnjë herë nuk do të mund të dëgjoni se drejtori i shkollës jep ndonjë koment negativ në cilëndo direktivë të re nga nivelet më të larta të pushtetit. Drejtori është i ndërgjegjshëm për marrëdhëniet e mira me palët e interesuara dhe informimin e konsideron si mënyrë të komunikimit. Por, komunikimi është kryesisht i njëkahshëm dhe ka për qëllim ngjalljen e ndjenjës së miratimit të vendimeve të drejtorit ose të instancave tjera.

Në këtë fazë drejtori konsideron se është me mjaft rrezik të ndahet përgjegjësia sepse palët e interesuara shpesh tregojnë shumë shenja të sjelljes së papërgjegjshme! Kritikkat konsiderohen më tepër si ndërhyrje në rregullat rutinore që funksionojë mirë, e jo si pikënisje për përmirësim, kështu që është më e parrezikshme të bëhet një angazhim për të rritur lojalitetin e njerëzve ndaj sistemit.

Për këtë arsye është me rëndësi të jepet përshtypja e tolerancës. Në të njëjtën kohë, diversiteti konsiderohet si shmangie nga norma: qëllimi i marrjes me të është një shkallë e lartë e nënshtimit.

Komente karakteristike:

“Për këtë kemi vendosur. A ka pyetje tjetër?”

“Nuk e kuptoj pse nuk ju pëlqen kjo procedurë e re. Atë e përshkruam detajisht në mbledhjen tonë të fundit me personelin.”

“Si duket nuk pajtohem. Ndoshta nuk isha sa duhet i qartë.”

Faza 3.

Këtu janë ndërmarrë disa masa të rëndësishme për të futur qeverisjen demokratike:

Udhëheqja konsideron se nevojat e palëve të interesuara sipas rëndësisë janë të krahasueshme me	Atyre me përgjegjësi u jepet liri e plotë veprimi, por vetëm në fusha shumë periferike: edhe më tutje	Udhëheqja sinqerisht punon drejtë përgjegjësisë së përbashkët – e cila me gjasë është e përbashkët vetëm në	Ndërgjegjësimi për diversitet; veprimi në rastet më të lehta (p.sh. publikimet shkollore) tregon diversitet; ekzistojnë rregulla për mosdiskriminim; pranohet diversiteti fetar; politika e përfshirjes bazohet në përfshirje; ekziston kujdesi për
-------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

nevojat e niveleve më të larta të pushtetit dhe bënë aleancë me grupe të ndryshme presioni ose të lobimit.	qëllimi kryesor është funksionimi i mirë i aktivitetit primar.	fushat “e lehta” (festivale, aktivitete jashtëmësimore etj.)	nevoja të veçanta; dhe promovohet mundësitë e barabarta pavarësisht nga prejardhja kulturore. Por, në mësim dhe në kurtikula pak i kushtohet kujdes diversitetit.
------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Angazhimi juaj duhet të jetë para së gjithash dhe kryesisht në vlerat themelore, siç janë të drejta e njeriut. Udhëheqja kryesisht nuk përqendrohet në rregulla, por në qëllime. Vendime të rëndësishme merren vetëm pas konsultimit me ata të cilët influencohen nga këto vendime. Sa të jetë e mundur vendimet bazohen në konsensus. Udhëheqja e shkollës dhe personeli me fjalë dhe vepra tregojnë se marrin parasysh mendimin e nxënësve. Rëndësia e ndikimit real për palët e interesuara, kur bëhet fjalë për çështjet kyçe, është evidente në të gjitha dokumentet e politikave. Fjalë kyçe është besimi. Normat dhe rregullat e zakonshme pasqyrohen në raport me përgjegjësitë, e jo me ndalimet.

Drejtorët e shkollave konsiderojnë se është qenësore që të binden nxënësit me vlerat thelbësore të demokracisë. Një prej mënyrave që kjo të arrihet është që nxënësve t’u jepet pushtet për vendosje, së paku në fusha të lehta. Drejtori i shkollës edhe më tutje kujdeset që të mos u jepet pushtet i tepruar nxënësve dhe personelit.

Respektimi i diversitetit konsiderohet si i natyrshëm. Diversiteti pranohet dhe ndërmerren masa të ndryshme për mirëkuptim dhe për balancim më të mirë.

Komente karakteristike:

“Para rregullimit të oborrit të shkollës duhet të kërkojmë mendimin e fëmijëve. Ata për këtë janë të kualifikuar.”

“Përfaqësuesit e Këshillit të Shkollës paraqesin propozimin e rregullave të reja në mbledhjen e ardhshme të personelit. Ata vërtetë janë të etur të dëgjojnë mendimin tonë.”

Që shkolla të arrijë deri në fazën 3, nuk është aq e rrezikshme ose e vështirë, me kusht që mbështetja juaj për të drejtën e çdonjërit që të jetë pjesëmarrës të bazohet në një besim të sinqertë dhe të thellë në vlerat demokratike, dhe fëmijët konsiderohen si subjekte që meritojnë respekt, e jo si kuti e zbrazët që duhet mbushur me aftësi të dobishme (ose madje si objekte të adhurueshëm që i kemi dhe mund t’i përshtatim sipas dëshirës sonë, e jo të tyre: qasje e tillë e mbrojtjes së skajshme është njëra prej mënyrave joshëse për ta minuar autorizimin e fëmijëve që të veprojnë, pasi që buron nga dashamirësia dhe kujdesi i qartë).

Faza 4.

Udhëheqja punon për të ndërtuar konsensus/siguri/besim ndërmjet niveleve të ndryshme, njeh formalisht interesat e palëve të interesuara dhe shfrytëzon eksperiencën e saj për të ndikuar në vendimet politike	Konsultimet formale dhe joformale rezultojnë me rrjedhje sistematike dhe të strukturuar të informacionit.	Ndarja e përgjegjësisë edhe për fushat e vështira (buxheti, kurrikulat, planifikimi strategjik, trajnimi i mësimdhënësve në shkollë, vetë-përmirësimi, vlerësimi, mësimdhënia, etj.)	Udhëheqja siguron që diversiteti të konsiderohet dhe të shfrytëzohet si një pasuri/vlerë e shtuar e qeverisjes së shkollës. Diversiteti u jep nxënësve kompetencë shtesë dhe e bën shkollën më atraktive/të mirë (status më i lartë). Ndërmerren aksione pozitive për të lejuar
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

			qasje dhe pjesëmarrje të plotë të grupeve të cënueshme.
--	--	--	---------------------------------------------------------

Kur e çoni shkollën deri në fazën 3, shpejt do të kuptoni se disa ndryshime që i keni bërë janë shumë kozmetike, edhe përkundër përmbushjes së lartë të detyrave nga personeli dhe nxënësit, dhe shkatërrimi/vandalizmi është zvogëluar. Ajo që duhet bërë tash është të punoni sistematikisht në ndërtimin e vlerave në lidhje me respektimin reciprok, të drejtat dhe përgjegjësitë dhe, mbi të gjitha, në ngritjen e besimit.

Një faktor i cili është ndoshta skajshmërisht i nevojshëm për të arritur qëllimin e shkollës demokratike është besimi. Sistemet tona edukative akoma karakterizohen me mosbesim:

- mosbesim në aftësinë e nxënësve të ndërtojnë vetpërgjegjësi për mësimnxënie;
- mosbesim në aftësinë e mësimitdhënësve për të arritur rezultate të mira në situatë të mësimnxënies së hapur e cila karakterizohet me liri dhe autonomi kurrikulare më të madhe;
- mosbesim në aftësinë e shkollës që të krijojë një mjedis demokratik me një autonomi më të mirë dhe
- mosbesim në të gjitha institucionet e mësimnxënies të pasistemuara përmes urdhërësive dhe rregullave për kurrikula.

Reformimi dhe sajimi i sërishëm i shkollës për funksionin e saj si një mjedis i nxënies mund të synohet suksesshëm vetëm nëse vendoset besimi si princip në sistemin e edukimit, dhe besimi i tillë bëhet sinjal i dukshëm nga politikbërësit drejt shkollave dhe ushtruesve të veprimtarisë së edukimit.

Me gjasë, është gjithashtu i nevojshëm shumë optimizëm dhe shikim pozitiv në ardhmërinë tonë. Puna juaj duhet të jetë proces i vazhdueshëm, me një perspektivë afatgjatë. Perspektiva gjithashtu zgjerohet edhe në kuptimin tjetër: si udhëheqës i shkollës, ju e konsideroni veten si një faktor i rëndësishëm në shoqëri, jo vetëm në shkollën tuaj.

Në fazën 4. shkolla konsiderohet si prodhues i rëndësishëm i vlerave demokratike. Ajo është shkollë e hapur, me komunikim të rregullt me autoritetet më të larta për t'u dhënë atyre bazë të mirë për vendimet e ardhshme. Ndryshimet më të rëndësishme në shkollë, në cilëndo fushë, rrallë kryhen kundër vullnetit të shumicës. Kompromisi, periudha e provës dhe rishqyrtimi janë procedura normale. Normat dhe rregullat i vendosin ata të cilëve u dedikohen. Përgjegjësia e udhëheqjes është që të kontribuojë me njohuri profesionale, dhe si të gjithë të tjerët, me mendimet dhe përvojën personale. Autorizimet për udhëheqje bazohen në njohuritë/kompetencat profesionale dhe personale, e jo në pozitë/gradë.

Me shumë rëndësi është të çmohen kompetencat e organizatës, brenda saj dhe nga palët e interesuara e komuniteti.

Është me rëndësi të çmohen të gjitha kompetencat që janë në dispozicion në organizatë dhe në mesin e palëve të interesuara në shoqërinë që na rrethon.

Konsiderohet si një meritë shtesë e nxënësve dhe e personelit marrja pjesë aktive në administrimin e shkollës. Përfaqësuesve të nxënësve në këshillat e shkollës ose në bordin e shkollës u jepen trajnime të veçanta për njohjen e procedurave. **Ata fitojnë gjithashtu edhe një shumë të caktuar parash. (ata mund të marrin ndonjë stimulim për punët që bëjnë në këto borde).**

Udhëheqja vlerëson dhe mbështet diversitetin për arsye ideologjike dhe strategjike. Atmosfera ndërnacionale në shkollë, nxënësve u jep njohuri/kompetenca të cilat nuk mund të kihen në mjedis të izoluar dhe homogjene.

Komente karakteristike:

“Shkolla duhet të jetë vend ku përjetoni të gjitha anët e mira të demokracisë. Dëshirojmë të krijojmë qytetarë aktiv që veprojnë në mënyrë konstruktive në vend se vetëm të ankohen.”

“Nxënësit janë njohës më të mirë kur është në pyetje nxënia.”

“Të rinjtë nuk dallohen shumë nga të rriturit, por janë më të ri, dhe së këndejmi mund t'i shikojnë gjërat nga një këndvështrim tjetër.”

5.2 Edukimi me përqendrim në vlera

Qëllim i përgjithshëm i shkollave tona nuk është vetëm përcjellja e dijes nga një gjeneratë në gjeneratën e ardhshme; shumë kurrikula kombëtare pasqyrojnë një varg vlerash të rëndësishme për shoqërinë përkatëse.

Ligji për edukim i Suedisë është një shembull tipik: sistemi shkollor kombëtar duhet “t’u sigurojë nxënësve dije dhe, në bashkëpunim me familjen, të mbështesë zhvillimin e harmonishëm të tyre në qenie të përgjegjshme njerëzore dhe anëtarë të bashkësisë.” Pra, sa janë evidente principet e demokracisë dhe vlerat e të drejtave të njeriut në jetën tonë të përditshme në shkollë? Sjellja e drejtorëve të shkollës dhe e personelit nxjerrin në shesh vlerat dominonte më tepër se sa dokumentet zyrtare për udhëheqje.

Faza 1.

Kurrikulat shkollore nuk shprehin vlerat e EQD/EDNJ-së	Për përmbajtjen e detajuar duhet të vendosin autoritetet	Metodat e mësimdhënies janë të zgjedhura nga mësimdhënësit.	Kurrikulat kanë për qëllim bindjen/nënshtrimin.	Librat shkollor mbështeten në grupin/pikëvështrimin dominant si normë, ndërsa vlerat e pakicës si shmangie.	Vajzat nuk inkurajohen që të përcaktohen për lëndët tradicionale të “meshkujve”.
--------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------

Në Fazën 1, transferimi i dijes dhe shkathtësive, si leximi dhe shkrimi, janë detyra kryesore të shkollës. “Dija” është në masë të madhe enciklopedike. Rendi dhe qëndrueshmëria shihen si vlera të rëndësishme brenda dhe jashtë shkollës, dhe preferohet një shoqëri homogjene. Një mënyrë e mirë për bartjen e këtyre vlerave dhe kësaj dije është respektimi rigoroz i një orari me pak hapësirë për aktivitete jashtëmësimore apo për lëndë të reja. Shihen vetëm disa shmangie nga kurrikulat kombëtare. Fenomenet bashkëkohore me interes për të rinjtë konsiderohen të parëndësishme ose me status mësimor të ulët, ashtu sikurse edhe dija për mjedisin dhe historinë lokale. Librat shkollorë duhet të reflektojnë shoqërinë ashtu si është. Nuk është çështje e shkollës mbështetja për të ndryshuar vlerat e zakonshme. Fjalët si “normale” apo “natyrore” përdoren për përshkrimin e sjelljes dominonte ose për grupet që janë shumicë.

Shkolla përqendrohet më shumë në mësimdhënie se sa në mësimnxënie. Nxënësit nuk konsiderohen të aftë për të zgjedhur metodat e tyre të mësimnxënies, dhe mësimdhënësi e planifikon semestrin pa konsultim me nxënësit. Sa më homogjen që janë nxënësit tonë, aq më lehtë është.

Komente karakteristike:

*“Fëmijët nuk **rriten**(edukohen!) si duhet. Ata nuk tregojnë respekt.”*

“Shumë pak filma dhe programe televizive mund të quhen aktivitete kulturore.”

“Nuk ka nevojë që ato gjëra të paraqiten në mësimet tona.”
“Ne duhet ta ruajmë trashëgiminë tonë kulturore.”

Faza 2.

Vlerat e EQD/EDNJ-së përmenden në kurrikulë por jo në formë urdhërore ose imperative.	Nxënësve u jepet mundësia të shprehin mendimin e tyre.	Nxënësve u jepen disa opsione se si të punojnë, por për to vendos mësimdhënësi.	Pranohen nevojat e veçanta. Prejardhjet e ndryshme kulturore shihet si pengesë e cila mund të tejkalohet. Merren disa masa që të respektohet diversiteti.	Librat e anshëm ose paragjykes shkollor mund të shfrytëzohen, por pjesë të papërshtatshme të tyre nuk merren parasysh.	Bëhen deklarata për pranimin me kënaqësi të aplikacioneve të grupeve minoritare, por nuk ndërmerret veprim konfirmues për të nxitur përfshirjen e tyre.
---------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Në Fazën 2, mund të shihni ndryshim të qëndrimit, një hapje ndaj vlerave demokratike dhe të drejtave të nxënësit, siç janë parashtruar në dokumente zyrtare. Kur opinionet e nxënësve merren parasysh, kjo bëhet kryesisht për të mirën e planeve të mësimdhënësit. Nxënësit mund paraqesin shembuj nga jeta e përditshme që janë të zbatueshëm për atë që mësohet në shkollë. Fushat e interesimit të nxënësve shfrytëzohen, por vetëm atëherë kur favorizojnë mësimdhënësin dhe kur janë plotësim i planit të caktuar apo mënyrë për të rritur motivimin.

Zgjedhja e mënyrës së mësimdhënies së mësimdhënësit duhet të respektohet. Mësimdhënësit kanë njohuri profesionale, kurse nxënësit jo. Kur nxënësve u jepet liri e zgjedhjes, qëllimi kryesor është që ata të punojnë me kënaqësi në çfarëdo teme që ka caktuar mësimdhënësi.

Është e rëndësishme që sa më shumë të ekuilibrohen ndryshimet kulturore apo ndryshimet tjera. Qëllimi i masave të ndërmarra është adaptimi ndaj shumicës, e jo përfshirja. Vlerat e shumicës janë akoma normë. Vëmendje u kushtohet pengesave fizike dhe disa paaftësive në mësim. Diversiteti kulturor/social/etnik injorohet sa më shumë që është e mundur.

Është i rëndësishëm stabiliteti i cili më lehtë mbahet në një shoqëri homogjene. Kategoritë e reja të nxënësve dhe të personelit mund ta çrregullojnë atë, kështu që edhe nëse pranohen aplikacionet nga grupet minoritare nuk bëhen përpjekje aktive për të zgjeruar bazën e rekrutimit.

Komente karakteristike:

“Para se të kërkojnë të drejtat e tyre, nxënësit duhet të tregojnë se mund t’i marrin dhe t’i shfrytëzojnë përgjegjësitë.”

“Demokracia mësohet në leksionet e shkencave sociale dhe të historisë.”

“Unë jam ekspert.”

“Janë me interes nxënësit nga kulturat tjera.”

“Le të marrim pikëpamjen e gjinisë femërore për këtë.”

Faza 3.

Faze 3 shënon një ndryshim të vërtetë. Këtu sjellja është në harmoni/përputhshmëri shumë më të madhe me vlerat e përcaktuara në dokumentet e politikave.

Vlerat e EQD/EDNJ-së janë dhënë në paragrafin e parë të kurrikulës si bazë e edukimit të përgjithshëm. Politikat e shkollave lokale theksojnë rëndësinë e respektimit të të	Mësimdhënësit inkurajohen të përfshijnë nxënësit në procesin mësimor. Mësimdhënësit dhe nxënësit planifikojnë së	Kurrikuli është i përshtatshëm për të gjithë nxënësit.	Librat e anshëm shkollor nuk janë të lejueshëm.	Janë identifikuar dhe lartësuar të arriturat dhe karakteristikat unike kulturore të minoriteteve.
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------	-------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------

drejtave njerëzore.	bashku. Ka hapësirë për zgjidhje individuale.			
---------------------	-----------------------------------------------	--	--	--

Për njerëzit që punojnë në shkollat nga Faza 3, vlerat e të drejtave të njeriut janë udhërrëfyes për punën e përditshme. Demokracia nuk studiohet si temë e veçuar, por praktikohet në situata të ndryshme. Mendimi kritik dhe analitik janë zotësi/aftësi të rëndësishme dhe mund të mësohen brenda shumë temave.

Mësimdhënësit dhe udhëheqësit e shkollave nuk janë skllëvër të kurrikulës. Kur planifikohen kurset dhe leksionet, merren parasysh nevojat dhe interesat e nxënësve. Rregullat janë të hapura dhe jo shumë të detajuara. Të drejtat gjithmonë lidhen me përgjegjësitë. Një shkollë me nivel të lartë demokracie dhe autorizimesh për personelin dhe nxënësit nuk është shkollë pa rregulla!

Udhëheqësit dhe personeli e respektojnë diversitetin dhe atë e përdorin për të rritur aftësitë shoqërore të nxënësve dhe për të zgjeruar këndvështrimin e tyre. Në vend të përdorimit të fjalëve “normale” apo “natyrale” për të përshkruar kulturën dominante dhe për të karakterizuar minoritetet si “të pazakonshëm”, mësimdhënësit kujdesen që të përshkruajnë diversitetet ekzistuese me fjalë të njëjta.

Komente karakteristike:

“Ne jemi të nderuar që prindërit na e kanë besuar edukimin e fëmijëve të tyre.”

“Ne jemi këtu për nxënësit tonë.”

“Globalizimi sapo ka filluar. Nxënësit tanë do të jenë të përgatitur më mirë se shumica e nxënësve tjerë për të jetuar në shoqërinë e së ardhmes.”

Faza 4.

Vlerat e EQD/EDNJ-së nuk janë dhënë vetëm në kurrikulat e shtypur, por janë elemente themelore dhe të qenësishme të funksionimit të jetës shkollore. Etosi ose tipari dominues i shkollës bazohet në spikatjen e barazisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut: Udhëheqësit e shkollave “me veprim personal” u tregojnë të tjerëve për demokracinë dhe respektimin e tillë.	Nxënësit njihen si ekspert në mënyrën e tyre të mësimt.	Udhëheqësit e shkollave me vepra dhe fjalë tregojnë respektim dhe qëndrim të sinqertë ndaj diversitetit.	Ku nuk ekzistojnë tekste të paanshëm, shkolla përpilon materialet e saj.	Të mësuarit se si të merresh me diversitetin konsiderohet si një kompetence e vlefshme shtesë – për të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit.
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Në këtë fazë nuk ka nevojë që vlerat të specifikohen më shumë. Edukimi për qytetari demokratike dhe për vlera të të drejtave të njeriut përhapen në jetën e shkollës.

Çdo shenjë për tendencë të mosrespektimit apo të joetikës trajtohet seriozisht. Mënyrat e mësimdhënies vlerësohen sistematikisht nga nxënësit. Nxënësit gjithashtu vlerësojnë punën e tyre. Shkolla investon në kohë dhe resurse për të mësuar nga dhe për diversitetin. Perspektiva e përgjithshme për të ardhmen është optimiste.

Komente karakteristike:

“Unë s’mund të mos mahnitem se sa të ndërgjegjshëm dhe të pjekur janë nxënësit tonë. Çfarë ndryshimi nga koha kur unë kam shkuar në shkollë!”

“Kur nxënësit tonë largohen nga shkolla, ata e dinë çka është më mirë për ta dhe për të tjerët rreth tyre. Ata janë kritik dhe nuk manipulohen lehtë.”

“Ne po përmirësohem, por kemi ende për të mësuar.”

5.3 Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja: konkurrenca dhe vetëvendosja e shkollës

Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja janë vlera të rëndësishme⁴, nëse shkolla vërtetë dëshiron të pretendojë se edukon nxënësit për qytetarinë demokratike. Që të funksionojë demokracia, komunikimi duhet të jetë i mirë. Në një demokraci, qytetarët aktiv, sipas definicionit, duhet që të jenë të përfshirë dhe të mësojnë shkathtësitë e bashkëpunimit, negocimit dhe të kompromisit. Me të drejtat vijne edhe përgjegjësitë. Një nga ato përgjegjësi është pjesëmarrja aktive, dhe zbatimi i tolerancës si pjesë e vlerësimit të diversitetit: së këndejmi përsëri dëshmohet raporti në mes të tre principeve të Këshillit të Evropës për EQD-në.

Natyrisht do të prisim t'i gjejmë këto vlera të pranishme, në formë të dukshme dhe të prekshme, në mënyrën se si funksionon shkolla. Mu sikurse qytetarët aktiv që janë të përfshirë në komunitetin në të cilin gjenden – mund të pritët që edhe nxënësit të jenë të përfshirë aktivisht në komunitetin e shkollës demokratike – shkolla që pretendon të jetë demokratike mund të pritët të jetë e përfshirë në komunitetin e saj më të gjerë.

Por ekzistojnë forca që veprojnë kundër një përfshirje të tillë demokratike. Sigurisht se është e drejtë që shkollave t'u jepet mundësi të konsiderueshme për vetëvendosje. Diskutimi i mëhershëm i Fushës themelore 1 shqyrtoi hapësirën në të cilën qeverisja e shkollës duhet të veprojë në të mirë të saj, të nxënësve dhe të palëve tjera të interesuara për të, duke zvogëluar herë pas herë presionet e jashtme nga qeveria apo nga shoqëria. Prandaj, mund të ketë një moment kur shkolla duhet të mbrojë veten nga presionet e komunitetit që ajo i konsideron të jenë kundër interesave të saj. Ky ndoshta mund të jetë edhe tension i natyrshëm që është i kudondodhshëm në një demokraci, dhe rrjedhimisht është i pavënëre. Megjithatë, në shumë vende të Evropës momentalisht ka presion të konsiderueshëm në shkolla për të funksionuar brenda një tregu të edukimit. Forcat e tregut dhe konkurrenca në mes të shkollave shihen si vegla të fuqishme në përmirësimin e shkollave dhe rritjen e standardeve.

Faza 1.

Shkolla duhet të dëshmohet se është më e mira në krahasim me të gjitha shkollat tjera, dhe së këndejmi nxënësit duhet t'i dëshmohen shkollës.	Udhëheqja përqendrohet vetëm në interesat e shkollës dhe në punën e mirë të saj që, para së gjithash, duhet ruajtur.	Shkolla dekurajon përfshirjen ose konsultimin e prindërve: institucioni është profesional.	Shkolla i informon prindërit për agjendën e saj.	Të jashtëmit (“outsiders”) dekurajohen të marrin pjesë në shkollë.	Institucionet tjera konsiderohen si konkurrenca: praktika e mirë ruhet brenda shkollës.	Nxitja e barazisë gjinore nuk konsiderohet si funksion ose rol i shkollës: vajzat janë ato që duhet të bëjnë përpjekje për këtë. Grupet minoritare ose ato në gjendje të keqe trajtohen si të jenë të tillë që me gjasë ulin standardet - dhe së këndejmi konsiderohen si rrezik.
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Që trysnia të jetë konkurruese dhe me rezultate të tejkalojë shkollat e saj fqinje mund të çojë shkollën në njëfarë izolimi dhe proteksionizmi, që nuk kanë vend në një demokraci të shëndoshë. Nën trysinë e tillë, për arritjen e standardeve të larta të nxënësve, mund të shikohet jo aq si një qëllim që është i rëndësishëm për nxënësit si një objektiv vital për mbijetesën e institucionit: në rrethana të tilla, shkolla do të preferojë pranimin e fëmijëve të besueshëm, të parashikueshëm dhe të zellshëm si nxënës të saj, dhe do të fillojë t'i shikojë fëmijët nga mjediset me situatë të

⁴ Shih Shtojcën II. për vlerat e EQD-së dhe kompetencat kyçe sipas Audigier-it.

pafavorshme dhe nga minoritetet tjera si dështak potencial, që rrezikojnë të dëmtojnë rezultatet e suksesshme të shkollës në provimet publike.

Trysnia e njëjtë mund të dekurajojë shkollën që të pranojë luajtjen e rolit të saj në ndarjen e praktikës së mirë dhe eksperiencën profesionale me shkollat tjera. Nëse strategjitë e saj për mësimdhënie dhe mësimnxënie tregohen të suksesshme, do të ekzistojë një motivacion i madh që t'i mbajë ato sekrete: mësimdhënësit e shkollave tjera konsiderohen konkurrent e jo kolegë. Në kushte të tilla, marrëdhëniet me organet ose individët, bizneset ose OJQ-të jashtë shkollës ka më tepër gjasa që të vendosen me qëllim që të realizohet ndonjë përfitim material për shkollën, në vend që të ndiqet vendosja e partneritetit të vërtetë ose bashkëpunimit demokratik.

Pastaj, për një numër arsyesh, dëshira e madhe e shkollës për vetëvendosje mund të shkaktojë ngecjen në vend të përparimit të saj në rrugën e demokracisë.

Në fazën 1. për sa i takon shkollës do të keni diç nga mentaliteti i rrethimit. Interesat e shkollës janë qëllimi më i lartë, ndërsa ndikimet e jashtme (përfshirë prindërit) ka gjasa që vetëm të bëjnë dëm: në rastin më të mirë, ata nuk kanë dijeni për nevojat dhe qëllimet e vërteta të shkollës, ndërsa, në rastin më të keq, mund të bëhen konkurrent që do të përfitonin në njëfarë mënyre duke parë dobësimin e shkollës.

Vetë nxënësit duhet sjellë ndërmend se shkolla është më e mira se të gjitha të tjerat, dhe ata duhet dëshmuar se e meritojnë këtë shkollë. Diversiteti nuk konsiderohet si problem. Nuk është detyrë e shkollës t'u zgjasë dorën grupeve me situatë të pafavorshme dhe minoriteteve: për më tepër, fëmijët e tillë do të mund të kishin efekt negativ në rezultatet mësimore të shkollës, duke dëmtuar kështu statusin e saj.

Komente karakteristike:

“Interesat e shkollës janë në rend të parë.”

“Nxënësit duhet të tregohen se janë në lartësinë e duhur ndaj kërkesave të shkollës: nuk mund të humbim kohë dhe energji në ata që këtë nuk e bëjnë.”

“Nuk na nevojitet përfshirja e të tjerëve: shkolla di më së miri.”

Faza 2.

Shkolla dëshiron që nxënësit e saj të jenë më të mirë se të gjithë të tjerët për të ngritur statusin e saj.	Pranohet se shkolla në masë të caktuar është pjesë e bashkësisë së gjerë - por ajo ka pak ose aspak angazhim me bashkësinë.	Shkolla e di se ekziston për shkak të nxënësve të saj dhe në masë të caktuar edhe për shkak të prindërve të tyre, por në asnjë mënyrë nuk i konsideron partnerë.	Nxënësit dhe prindërit njihen si palë të interesuara – jo si pjesëmarrës por si subjekte të shkollës së gjithëdijshme.	Shkolla do të angazhohet në raport me institucionet partnere – por tregon dyshim ndaj tyre dhe kërkon vetëm përkrahje materiale.	Shkolla është e gatshme të publikojë praktikën e mirë me qëllim të kërkimit të statusit – jo për të ndarë ekspertizë me të tjerët.	Shkolla është pasive kur janë në pyetje grupet që vështirë përfshihen në jetën publike ose grupet minoritare: konsideron se është përgjegjësi e tyre që të përfshihen nëse këtë e dëshirojnë.
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Në fazën 2. me gjasë jeni i preokupuar që të konsideroheni se luani rolin tuaj në komunitet. Prandaj, është kënaqësi që grupe të komunitetit mund të shfrytëzojnë disa nga pajisjet/objektet e shkollës. Komunikimi me prindërit dhe me familje është i rëndësishëm: shkolla dëshiron t'i informojë ata për atë se çka pret prej tyre, por nuk

kërkon reagimin e tyre. Nëse për nga natyra jeni sipërmarrës mund të vendosni kontakte me biznese: ideja e sponsorimit të biznesit, e cila sjellë ca para, është ide atraktive, për sa kohë që biznesi nuk vendos kërkesa për shpërblim.

Krenoheni me disa ide të shkëlqyeshme të mësimdhënies që i keni futur në praktikën shkollore: publiciteti i fituar nga kjo e përmirëson statusin e shkollës. Por, ju nuk dëshironi të shkoni në shumë detaje: nuk ka kuptim që të tregohet gjithçka, sepse shkolla afër jush ka arritur gati të njëjtat rezultate sikurse ju në provimet e vitit të kaluar.

Jemi të kënaqur kur aplikojnë nxënës nga grupet minoritare për t'u regjistruar në shkollën tonë. Por duhet tërhequr vërejtjen se sa me zell duhet punuar për t'u përshtatur.

Komente karakteristike:

“Gjithmonë i sigurojmë prindërit që të dinë saktësisht se çfarë janë pritjet.”

“Shkolla është për ju: mos e zhgënjeni.”

“Përshtetësi sponsorimin e biznesit.”

“Përshtetësi nxënësit e zellshëm nga grupet minoritare.”

Faza 3.

Bëhet trysni tek mësimdhënësit dhe te nxënësit për arritjen e standardeve të larta, pjesërisht për shkak të nxënësve, por edhe për shkak të konkurrencës.	Shkolla është e përfshirë dhe i mbështetë aktivitetet e bashkësisë, por nuk e përfshin bashkësinë në funksionimin e saj të brendshëm.	Ekzistojnë kontakte të rregullta me prindërit dhe familjet e nxënësve; shkolla i mirëpret dhe i fton për të shpreh mendimin e tyre.	Ekziston rrjedhje intensive e informacioneve nga shkolla, dhe prindërit janë të mirëpritur të shprehin opinionin e tyre. Shkolla vendos lidhur me organizatat të cilat janë vizitorë të mirëseardhur, sidomos si ekspert për t'i udhëzuar ose këshilluar nxënësit.	Shkolla me gatishmëri i ndan shembujt e mirë nga praktika me shkollat tjera dhe me profesionistët.	Shkolla bën përpjekje të konsiderueshme dhe ka sukses për t'i joshur dhe për t'i angazhuar që të përvetësojnë kulturën e shkollës grupet që vështirë përfshihen në jetën publike ose ato minoritare.
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Në këtë fazë do të krenoheni për shkollën e shtrirjes së shkollës suaj në komunitet. Është kënaqësi të shihen aq shumë nxënës të përfshirë në forma të ndryshme të shërbimit të komunitetit: Këto festa për njerëzit e moshuar ishin të mrekullueshme!

Jeni entuziast t'u jepni rastin prindërve që të thonë se çka mendojnë për edukimin që u ofrohet fëmijëve të tyre – edhe pse, fatkeqësisht, shumica e ideve të tyre vërtetë nuk janë me vend. Megjithatë, mirë është të bisedohet.

Një epërsi tjetër i referohet thirrjes së prindërve, bizneseve lokale dhe udhëheqësve të komunitetit që të vijnë dhe të ndajnë përvojën dhe njohuritë e tyre me nxënësit. Është mirë gjithashtu të mbahen mbledhje të rregullta me personelin nga shkollat lokale dhe të ndahen përvojat e dobishme. Përveç kësaj, shkolla përpiqet aktivisht që të pranojë aplikacione prej nxënësve nga grupet e minoritetit dhe grupeve që vështirë përfshihen në jetën publike, dhe t'u ndihmojë atyre që t'i përshtaten kulturës së shkollës.

Komente karakteristike:

“Në shkollë pranojmë me kënaqësi shumë vizitorë. Prindërit janë gjithmonë të mirëseardhur.”

“Inkurajojmë fuqishëm diversitetin.”

“Presim që nxënësit të arrijnë rezultate shumë të mira – dhe jemi të lumtur kur për këtë ata kanë sukses.”

Faza 4.

Cilësia e shkëlqyer është për nxënësit, edhe pse realisht shikuar nga kjo përfitojnë edhe shkolla dhe bashkësia.	Të gjitha palët e interesuara dhe vetë bashkësia konsiderohet se i kontribuojnë dhe përfitojnë nga shkolla.	Shkolla të gjitha palët e interesuara dhe partnerët i konsideron si kontribuues të çmueshëm, por edhe si përfitues potencial: më tepër se një partneritet, ky është një angazhim i vërtetë demokratik.
------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Në këtë fushë themelore, tre principet e EQD-së në masë të madhe bashkohen: kur vlerat demokratike të bashkëpunimit, komunikimit dhe të përfshirjes janë të shtrira/zbatuara në jetën e shkollës, neutralizojnë efektin negativ të konkurrencës. Në këtë fazë gjërat bashkohen/mblidhen. Siç shihet në tabelë, vizitorët e shkollës janë partnerë në aktivitetet e përbashkëta, në dobi të të gjithëve. Përfshirja në komunitet dhe nga komuniteti konsiderohet si një proces plotësisht i dyanshëm, me përfitim për të gjithë.

Shkolla ka besim dhe u ndihmon nxënësve të saj që të dallohen: besimi shpërblehet me përfitimet në statusin e institucionit, por ky nuk është motivacioni parësor, sepse shkolla është e vetëdijshme se ajo ekziston dhe punon për nxënësit dhe për komunitetin/bashkësinë e gjerë.

Komente karakteristike:

“Ne të gjithë jemi pjesë e kësaj.”

“Punojmë së bashku: i japim shkollës dhe ajo na jep neve.”

“Vetëm shikoni se sa të suksesshëm janë nxënësit tonë në provime.”

5.4 Disiplina e nxënësve



Këshilli i nxënësve në Gjinnazin klasik në Woverhampton

Disiplina mbetet shqetësimi më i madh i shkollës dhe i mësimdhënësve të cilët nuk shohin se ku i çon lëvizja drejt demokracisë. Ata frikësohen se nxënësve që u jepet e drejta e fjalës është e pamundur të disiplinohen; ata do të kundërshtojnë çdo urdhër; ata do të rrënojnë autoritetin e shkollës; kjo do të përfundojë në kaos.

Eksperiencia demokratike është krejt e kundërta, por kjo nuk është çështje për diskutim këtu. Tabela e kësaj fushe kryesore veçohet me ndjekjen e tre principeve në masë më të vogël se sa tri fushat tjera kryesore, sepse ato të gjitha mblidhen ose takohen së bashku në bashkëveprim. Në të vërtetë, katër fazat këtu janë pak a shumë të parashikueshme, duke ardhur pas deduktimit ose argumentimit të tri fushave tjera kryesore.

Faza 1.

Udhëheqja e shkollës i vendos dhe i zbaton rregullat – madje edhe në rastin kur nxënësit nuk i pëlqejnë ose u rezistojnë rregullave të tilla.	Rregullat janë rregulla dhe nuk ka lehtësira për kultura, mjedise shoqërore dhe nevoja të ndryshme.
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------

Në këtë fazë, shkolla i cakton të gjitha rregullat. Mësimdhënësit (apo më saktë udhëheqësit e shkollës) dinë më së miri. Kjo gjë nuk diskutohet. Nuk ka falje (si p.sh. “dallimi”) për moszbatim të rregullave.

Komente karakteristike:

“Bëni siç ju thuhet – ose përndryshe.”

“Nuk më intereson se kush jeni: ju i dini rregullat.”

Faza 2.

Udhëheqja e shkollës i vendos dhe i zbaton rregullat, por kërkon ndonjë reagim edhe nga nxënësit – dhe shpesh është e zhgënjyer.	Shkolla ka disa informacione për diversitetin e nxënësve dhe mund të vendosi disa rregulla duke pas parasysh dallimet (p.sh. veshja ose disa rite fetare).
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Ju dëshironi që nxënësit të marrin përgjegjësi, dhe herë pas here t’u flisni atyre për atë. Por, ata gjithmonë ju zhgënjëjnë.

Ju jeni tolerant në dallime: për shembull, nuk bëni pengesa për ritet e festave fetare. Edhe në shkollat ku mbahet uniforma ju jeni fleksibil ndaj nxënësve që vishen sipas ndonjë rregulle fetare.

Komente karakteristike:

“Pse nuk do të vepronit me përgjegjësi?”

“Pse gjithmonë më zhgënjëni?”

“Kjo është një shkollë tolerante.”

Faza 3.

Edhe pse ekziston një kufi deri ku janë të mundshme lëshimet, shumë rregulla diskutohen dhe negociohen me përfaqësuesit e nxënësve.	... dhe shumë nxënës bashkëpunojnë, madje edhe ndihmojnë, që të zbatohet kodi i mirësjelljes.	Minoritetet janë përfshirë në konsultimin në të cilin kanë qasje.
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------

Ekziston një parandjenjë e fuqishme që, edhe pse shkolla i cakton rregullat, ka hapësirë të mjaftueshme për diskutim dhe negociim. Nxënësit pa vështirësi përfshihen

në këtë, dhe bëhen kompromise. Diskutime të tilla gjithmonë bëhen duke kërkuar pikëpamjet e minoriteteve. Nxënësit më të vjetër janë të gatshëm për të marrë role me autoritet për të zbatuar rregullat e tilla. Ata u japin shembull të mirë fëmijëve më të rinj.

Komente karakteristike:

“Ne mund të bisedojmë për këtë – por ju e dini se ka një kufi të poshtëm.”

“Dikush duhet të mbajë rendin: ju i dini rregullat.”

“Kemi të drejtën e fjalës për gjërat.”

“Verifikuam që edhe grupet minoritare pajtohen me këtë.”

Faza 4.

Kodi i tërësishëm i mirësjelljes dhe rregullat e shkollës përpilohen në bazë të konsultimeve dhe negociatave me përfaqësuesit e nxënësve, duke pas parasysh se të gjitha minoritetet në tërësi janë të përfaqësuar: dhe nxënësit marrin rolin e “qytetarit të mirë” dhe/ose personit me pushtet (kujdestarit për disiplinë, vëzhgues) që zbaton dhe kujdeset që rregullat të zbatohen.

Rregullat vendosen në mënyrë demokratike – ose nga grupet ekzistuese ose duke krijuar forume të reja – dhe ato zbatohen në mënyrë demokratike. Rendi i mirë është në interes të të gjithëve – përderisa gjithkush kishte të drejtën e fjalës për organizimin e tij.

Kur ka klimë të respektimit reciprok nuk ka sjellje të ndarjes në “ata dhe ne” në mes mesimdhënësve dhe nxënësve, dhe frikësimi i më të vegjëlve është në minimum.

Komente karakteristike:

“Është shkolla jonë: ne kontribuojmë për suksesin e saj.”

“Kjo shkollë është për secilin. Kjo duhet të jetë e mirë për secilin.”

6. Hap pas hapi: Rruga drejt qeverisjes demokratike

Pra, ku duhet filluar? Kur e kupton se qeverisja demokratike është mënyra e vetme për të vazhduar, duhet të identifikoni ku duhet të filloni. Administrimi i shkollës bëhet në shumë fusha, zyrtare dhe jozyrtare. Niveli i qeverisjes demokratike mund të shihet mjaft mirë në mënyrën se si ju i trajtoni proceset zyrtare në relacion me autoritetet më të larta, me personelin dhe me nxënësit, por, ndoshta edhe më mirë në mënyrën se si i trajtoni të gjitha vendimet ad hok (aty për aty) që i merrni në kontekste jozyrtare gjatë ditës. Vizionet tuaja personale; administrimi i çështjeve rutinore të ditës; zgjidhja e konflikteve; takimet joformale me nxënësit, personelin dhe vizitorët; të gjitha këto reflektojnë më shumë se çdo deklaratë e shkruar për atë që ju çmoni më së shumti. Natyrisht që kjo nuk do të thotë që ligjet dhe rregullat janë të parëndësishme ose mund të neglizhohen.

Në këtë kapitull, do të gjeni këshilla praktike se si të veproni, hap pas hapi, nga qeverisja shkollë autoritare në atë demokratike në disa prej proceseve zyrtare dhe jozyrtare që duhet trajtuar nga një udhëheqës i shkollës. Fushat kryesore janë:

1. Administrimi, udhëheqja dhe përgjegjësia publike
2. Edukimi i përqendruar në vlera
3. Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja: konkurrimi dhe vetëvendosja e shkollës
4. Disiplina e nxënësve

Do të ilustroni se si këto katër fusha kryesore/kyçe do të reflektojnë qeverisjen demokratike në katër kontekste tipike zyrtare dhe jozyrtare.

Kontekstet zyrtare

Shkolla është një institucion, i cili, në shumë pikëvështrime, është institucion burokratik. Si drejtor ju duhet të dini rregullat dhe procedurat, dhe ndikimin e tyre tek njerëzit. Pra, ju duhet të drejtoni mbledhjet dhe organet tjera dhe të luani rolin tuaj zyrtar. Kjo nuk do të jetë në kundërshtim me përpjekjet tuaja për demokratizim: përkundrazi, kornizat zyrtare u japin po aq mundësi sa edhe ato jozyrtare për ta përhapur demokracinë. Do të shqyrtojmë katër kontekste formale ku mund të tregohen sjelljet dhe vlerat tuaja:


Pozicioni personal
Këshilli drejtues i shkollës
Takimet e personelit
Nxënësit

Konteksti jozyrtar

Në shkollë, drejtori asnjëherë nuk del nga roli i tij i udhëheqësit; mënyra se si ju reagoni në situatat e përditshme gjithmonë vlerësohet me pritjet dhe kërkesat që janë të lidhura me atë rol. Ajo çka ju bëni është më e rëndësishme se ajo që predikoni. Njësoj si më lart, do të shqyrtojmë katër kontekste ku mund të tregohen sjelljet dhe vlerat tuaja:

Pikëpamja personale
Bisedat në korridor/shoqërimi
Administrimi ditor
Zgjidhja e konflikteve

Diagrami që pason tregon se ju në shumë fusha, zyrtarisht dhe jozyrtarisht, punoni, dhe cilat prej tyre mund t'i shfrytëzoni si mundësi. Mendoni në lidhje me këtë dhe pastaj vazhdoni duke i marrë parasysh si (dhe kur) mund t'i ndërmerrni hapat që pasojnë.



Fusha themelore 1.: Qeverisja, udhëheqja, administrimi dhe përgjegjësia publike

Konteksti zyrtar

Pozicioni zyrtar

Drejtori i shkollës është përfaqësues zyrtar i shkollës. Nga kjo pozitë ju jeni

përgjegjës ndaj atyre lart dhe ndaj atyre nën pozitën tënde në sistemin e edukimit. Ju gjithashtu duhet të trajtoni trysninë e fuqishme të grupeve siç janë: organizata e prindërve, institucionet kulturore dhe mediet.

Objektivat shpesh janë kundërtë. Mënyra se si i trajtoni palët e interesuara dhe cilat interesa i keni prioritare, janë tregues të qartë për atë se në ç' masë keni qasje të vërtetë demokratike në qeverisjen e shkollës.

Hapi 1:

Autoriteti dhe lojaliteti juaj ndaj anëtarëve të këshillit nuk është kontestues as nga ju e as nga të tjerët në shkollë. Legjislacioni dhe pozita janë faktorët më të fuqishëm në administrimin e shkollës. Shikuar në afat më të gjatë, kjo nuk është aspak e pranueshme: nuk ka zhvillim, ndërsa roli juaj i udhëheqësit do të jetë kryesisht ceremonial. Si drejtor i ri ju do të mund të konsideroni se është e mençur të fillohet aty, por me rritjen e vetëbesimit, ju me gjasë do të filloni të shkoni përpara drejt pavarësisë më të madhe. Në fund të fundit, ju jeni drejtor.

Provoni këtë:

Përqendrohuni në një fushë; shqyrtoni rregullat nga pikëvështrimi i demokracisë. Pyeteni vetveten: pse duhet kjo rregull? Lejoni pak fleksibilitet aty ku mund të shihni përfitime për të gjithë.

Hapi 2.

Keni arritur që më thellësisht ta kuptoni idenë e rregullave ekzistuese. Nuk pajtoheni me gjithçka, por akoma e keni vështirë të shmangeni nga rregullat, ose jeni të papërcaktuar se si t'i interpretoni ato.

Provoni këtë:

Diskutoni legjislacionin me kolegë: shkoni në një kurs të shkollës së legjislacionit. Kjo mund t'u jap njohuri për të cilat keni nevojë për të qenë më i sigurt për atë se në çka mund të keni ndikim. (Njohuritë themelore të së drejtës janë të vlefshme, por shpesh vlera të papërfillshme për drejtorët e shkollave.) Studioni më në thellësi dokumentet e politikave zyrtare dhe tregoni më hapur interpretimet dhe pikëvështrimet tuaja personale.

Hapi 3.

Analizoni rolin tuaj të lidhjes ndërmjet organeve të shkollës dhe palëve të interesuara dhe kuptoni se ju jeni njësoj përgjegjës për të dy palët. Kjo ka për pasojë trysninë dhe pasigurinë, por gjithashtu hap mundësi për ndryshime.

Provoni këtë:

Përqendrohuni në atë çka është më e mirë për palët e interesuara. Gjeneroni/zhbuloni se çka presin nga ju të dy palët. Lexoni dokumentet e politikave dhe testoni kufizimet!

Rrezja e veprimit është shumë më gjerë se sa që mendoni! Gunnar Berg, profesor i edukimit në Universitetin Uppsala në Suedi, e ka ilustruar këtë si vijon:⁵

⁵ Berg, Gunnar, Skolan som organisation. Uppsala: Uppsala Studies in Education No 15. Almqvist et Wiksell, 1981.

Kufizimet ligjore, siç janë
përcaktuar në dokumentet ligjore



Këshilli i shkollës

Sistemi i qeverisjes së shkollës ndryshon shumë nga shteti në shtet. Në të shumtën e rasteve të edukimit publik, këshilli drejtues lokal është autoritet përgjegjës, që përfaqëson shumicën politike. Situata është e ngjashme në shkollat private. Shkalla e autonomisë lokale ose regjionale ndryshon gjithashtu prej shteti në shtet por,

pavarësisht nga shkalla e pavarësisë, udhëheqësi i shkollës është përgjegjës ndaj ndonjë forme të pushtetit më të lartë.

Hapi 1.

Në kontaktet e juaja me këshillin e shkollës⁶, ju përpiqeni të kufizoheni në raportimet zyrtare në pajtim me rregullat. Si pjesë e sistemit hierarkik, në kontaktet tuaja me autoritetet duhet të bëni zgjedhje taktike. Informacionet që u jepni atyre kanë tendencë minimizimi dhe nganjëherë të anshme. Organeve udhëheqëse u thuhet ajo që drejtori i shkollës mendon se ata duhet të dëgjojnë.

Hapi 2.

Jepni gjendjen më të saktë të jetës në shkollë dhe të pasojave të vendimeve politike. Këshillin e shkollës mund ta konsideroni si partner, e jo vetëm si nivel më të lartë administrativ.

Hapi 3.

Kur keni të bëni me vendimmarrësit, referohuni mbledhjeve dhe negociatave tuaja me palët e interesuara dhe tregoni vullnetin tuaj për lojalitet me dëshirat dhe nevojat e tyre. Keni parasysh se ju keni njohuri më të mira për situatën aktuale në shkollë se sa anëtarët e këshillit, dhe se ata do të bëjnë punë më të mirë nëse u jepni informacione të vazhdueshme dhe të paanshme.

Provo këtë:

Në informacionet tuaja merrni parasysh nuancat. Nëse edhe më tutje ndjeheni të pasigurt, provoni kritikën ta drejtoni në faktorët që janë jashtë kontrollit të anëtarëve të këshillit. Kujdesuni t'i bazoni informacionet tuaja në fakte dhe jepni sugjerime për përmirësim.

Provoni këtë:

Kur ndonjë rregull e vjetruar ose joadekuate shpie në joefikasitet ose absurditet, paraqitni shumë qartë qëndrimin tuaj autoriteteve përkatëse dhe përpiquni të mos pranoni përgjegjësinë për pasojat.

Provoni këtë:

Thirrni anëtarët e këshillit në shkollë; le të takohen me nxënësit dhe personelin pa qenë ju prezent. Thirrni nxënësit në mbledhje me këshillin e shkollës dhe u tregoni qartë që, edhe pse i çmoni mendimet e dy palëve, detyra juaj kryesore është të mbronit interesat e nxënësve. Tregoni qartë se ju i konsideroni nxënësit si partnerë të barabartë.

Qeverisja, udhëheqja dhe përgjegjësia publike
Këshilli drejtues lokal i shkollës

Këshilli pedagogjik

Një instrument i rëndësishëm në qeverisjen e shkollës është këshilli pedagogjik. Ky këshill mund të konsiderohet si një mundësi për informim dhe zgjidhje të problemeve praktike, por këshilli mund të jetë edhe një mjet për fuqizimin e vlerave të përbashkëta, të objektivave të përgjithshme si dhe të përfshirjes.

⁶ Termi "Këshill i shkollës" këtu përdoret si emërtim i përgjithshëm i organit udhëheqës të cilit fillimisht i përgjigjet udhëheqësi i shkollës.

Hapi 1.

Pasi që konsideroni se jeni përgjegjës në radhë të parë ndaj organeve më të larta të pushtetit, pikëpamja juaj për personelin është kryesisht se është i vlefshëm. Informacionet i zgjidhni dhe i jepni kuturu, me pak pritje për pjesëmarrje aktive. Vendimet e rëndësishme janë përgjegjësi e juaja dhe vetëm e juaja. Kjo mund të jetë barrë e rëndë për ta bartur, por ajo gjithashtu juve u jep ndjenjën e kontrollit.

Hapi 2.

E keni bërë si rregull që të ndani disa informacione para se të merrni vendime. Gjithashtu, për disa çështje kërkoni edhe mendimin e personelit. Por, informacionet edhe më tutje janë të njëkahshme dhe çdo vendim i rëndësishëm akoma mbetet të merret nga ju.

Hapi 3.

Në saje të informacioneve sistematike dhe të sinqerta, personeli do të merr pjesë aktive në përgatitjen e agjendës dhe në vendimmarrje. Kujdesuni që mbledhjet e personelit të mos jenë të ngarkuara me shumë çështje praktike, si makinat e fotokopjimit ose telefonat mobil. Në vend të këtyre, jepni hapësirë këmbimit të ideve pedagogjike dhe ideologjike. Gjithashtu ofroni hapësirë për ndihmesë të oratorëve frymëzues dhe të ekspertëve. Herë pas here thirren edhe nxënësit në mbledhje të personelit për të dhënë pikëpamjet e tyre për çështjet në shqyrtim.

Provoni këtë:

Jepni më shpesh dhe në mënyrë më të rregullt informacione së paku atëherë kur nuk ekziston rreziku që vendimet tuaja t'i ekspozohen kritikës ose gjykimit. Me dhënien e më tepër informacioneve, personeli do ta kryej punën edhe më mirë.

Provoni këtë:

Kujdesuni që personeli të merr informacione relevante në kohë të përshtatshme para mbledhjes, për t'u dhënë atyre shansin që të formojnë opinionin e tyre. Dëgjoni se çka thonë ata në mënyrë më aktive, negocioni, bindini. Bëhu i gatshëm për kompromise. Argumentet tuaja mbështetni në bindjet personale e jo në pozitën tuaj.

Keni parasysh se personeli juaj është mirë i shkolluar, dhe aftësitë e tyre shtesë me shumë gjasa i tejkalojnë aftësitë tuaja në shumë fusha.

Provoni këtë:

Së bashku me personelin dhe nxënësit, ju formoni një vizion për shkollën tuaj. Në bazë të këtij vizioni dhe në pajtim me vullnetin politik dhe frymën e kurrikulës, i merrni të gjitha vendimet e rëndësishme së bashku. Shumë prej vendimeve që në të kaluarën e keni praktikuar t'i merrni vetë, tash ia keni deleguar tërësisht personelit tuaj.

Nxënësit

Në shumë kurrikula nacionale do të gjeni paragrafë për të drejtën e nxënësit që të

<p>merr pjesë në proceset demokratike në shkollën e tyre; p.sh., në formë të këshillit të nxënësve.⁷ Por pa marrë parasysh se çka thuhet në rregulla, nuk do të ketë demokraci domethënëse të nxënësve po të mos përkrahet ajo nga udhëheqësi i shkollës. Fakti se disa nxënës janë shumë të rinj nuk mund të jetë arsye për moszbatim të demokracisë.</p>			
<p>Hapi 1. Ekzistojnë shkolla ku nuk ka këshill të nxënësve, ose për ekzistencën e tyre, ku anëtarët janë zgjedhur në rrethana të paqarta, nuk di shumica e nxënësve.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Thirrni të gjithë nxënësit e interesuar në një mbledhje. Sqaroni atyre për mundësinë e themelimit të këshillit të nxënësve. Mandej pritni dhe shihni zhvillimin e mëtutjeshëm.</p>	<p>Nxënësit</p>	<p>Qeverisja, udhëheqja dhe përgjegjësia publike</p>
<p>Hapi 2. Këshilli i nxënësve ekziston por nuk është gjithaq aktiv. Disa nxënës nuk i ndahen atij, por nxënësit në përgjithësi nuk i kushtojnë aq kujdes. Anëtarët e këshillit nuk marrin mjaftë informacione për çështje të rëndësishme për të formuar opinion të rëndësishëm. Nëse u mundësohet të vendosin, atëherë kjo bëhet në rastin e çështjeve me pak rëndësi, siç është menyuja për mbledhje të klasës ose për ngjyrën e mureve të klasës.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Nëse vërtet dëshironi që nxënësit të bëhen aktiv në proceset formale demokratike, ju duhet t'i mbështetni ata. Atyre u duhen udhëzime, informacione sistematike dhe të kuptueshme, trajnime praktike dhe resurse: një vendtakim, disa pajisje të zyrës dhe kohë për kryerjen e punëve.⁸ Përveç kësaj, kujdesuni që nxënësit që marrin pjesë aktive në demokracinë e shkollës të përfitojnë (emër të mirë) për angazhimin e tyre.</p>		
<p>Hapi 3. Në saje të informacioneve sistematike dhe të kuptueshme, çdo njëri ka mundësi të shpreh mendimin e tij dhe të merr pjesë aktive në procesin demokratik. Së bashku me personelin dhe nxënësit ju formoni vizionin tuaj për shkollën. Bazuar në vizionin e këtillë dhe në pajtim me vullnetin politik dhe me frymën e kurrikulës, ju i merrni të gjitha vendimet e rëndësishme së bashku. Fakti se përgjegjësia përfundimtare është e juaja nuk duhet të jetë pengesë. Qeverisja e mirëfilltë demokratike bazohet në besim.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Të gjitha vendimet e rëndësishme në shkollë merren nga këshilli i shkollës, ku nxënësit dhe personeli janë të përfaqësuar me numër të barabartë të anëtarëve. Në shkollat fillore, përfshihen gjithashtu edhe përfaqësuesit e prindërve. Drejtori ka të drejtën e votës përcaktuese. Modeli i tillë i qeverisjes së shkollës është akoma i rrallë, por megjithatë ekziston në disa shkolla në shtetet skandinave.</p>		

Një shembull i qeverisjes demokratike

⁷ Me termin “këshill i nxënësve“ nënkuptojmë një grup nxënësish të cilët i përfaqësojnë shokët e tyre. Shpesh quhet edhe “këshill i shkollës. Këshilli i nxënësve gëzon mbështetjen e udhëheqjes së shkollës.

⁸ Këshilla praktike shtesë mund të gjeni në: Trafford B, 2006, *Raising the Student Voice* (Ngrija e pjesëmarrja së nxënësve) Leicester UK, Asociacioni i drejtorëve të shkollave dhe të kolegjeve (*Association of School and College Leaders* (www.ascl.org.uk)).

Në qytetin Södertälje të Suedisë, të gjitha shkollat e mesme të larta kanë këshillin lokal të shkollës ku nxënësit kanë shumicën e votave. Këshilli i tillë vendos për gjërat si:

- buxhetin, së paku pjesë të tij;
- punësimin e anëtarëve të rinj ose rekrutimin;
- vitin shkollor dhe festat;
- dokumentet e politikave të shkollës;
- deklaratën e misionit.

Në shkollat e tilla, drejtorët kanë një rol pak më të ndryshëm dhe kryejnë punën e drejtorit menaxhues dhe të negociatorit, i cili vërtetë duhet të përdorë metodat demokratike të qeverisjes!

Konteksti jozyrtar/joformal

Pikëpamja personale		Pikëpamja personale	Qeverisja, udhëheqja dhe përgjegjësia publike
Në një proces të ndryshimeve duhet të filloni nga vetvetja, kush janë nxitësit tuaj?			
<p>Hapi 1. Mendimi juaj nuk është shumë i rëndësishëm. Misioni juaj është kryerja e asaj që kanë vendos autoritetet më të larta. Me rëndësi është të njihen rregullat. Nëse paraqiten problemet atëherë kërkoni zgjidhjen e tyre. Nxënësit i konsideroni si objekte të mësimdhënies.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Kohë pas kohe pyeteni veten: a ka kjo rregull vërtetë kuptim? Nëse jo, a mund të bëjë diçka? Do të mund të shqyrtoni gjithashtu edhe arsyet tuaja për tu bërë drejtor i shkollës. Kjo duhet të jetë më shumë se sa zbatimi i dispozitave ligjore të shkollës.</p>		
<p>Hapi 2. I keni analizuar dhe kuptuar qëllimet e ligjvënësit. Kryesisht ju pajtoheni me ato. I shihni vlerat e qeverisjes demokratike dhe nevojën për të plotësuar dëshirat e nxënësve dhe të prindërve të tyre, por gjithashtu edhe rrezikun dhe pengesat. Nuk dëshironi të hiqni dorë nga mekanizmat që nuk mund të kontrollohen.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Gjeni kohë për reflektim: cili është vizioni im? Pse është e nevojshme qeverisja demokratike? Cilat janë përfitimet? Si mund ta realizojmë atë në shkollën tonë? Kërkoni shembuj të mirë dhe mësoni prej tyre, madje edhe nëse nuk i zbatoni në shkollën tuaj në tërësi.</p>		
<p>Hapi 3. Jeni të bindur se proceset demokratike mundet dhe duhet të shfrytëzohen në të gjitha nivelet e shkollës tuaj. Pyetja që shtrohet është se si ta bëjmë secilin të ndajë të njëjtin vizion.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Mendoni nga ana strategjike: analizoni se ku mund të arrini rezultatet të mira lehtë, dhe përcaktoni fushat ku synoni të filloni. Bëni një plan për dy vitet e ardhshme dhe vendosni qëllimet personale. Keni durim!</p>		

Biseda në korridor/socializimi		Biseda në korridor/socializimi	Qeverisja, udhëheqja dhe përgjegjësia publike
<p>Është i vogël numri i vendeve të punës siç është shkolla me plotë takime joformale me një numër të madh njerëzish në një hapësirë relativisht të vogël. Si drejtor, duke qëndruar në zyrën tuaj, ju mund t'u shmangeni shumë prej kontakteve që kërkojnë kohë, ose mund t'i shfrytëzoni kontaktet e tilla për të forcuar etosin ose tiparin dominues demokratik që e ndërtoni në shkollën tuaj.</p>			
<p>Hapi 1. Në një shkollë me disa qindra nxënës, drejtori nuk flet shumë jashtë zyrës me nxënësit dhe me gjasë as me pjesëtarët e personelit. Kontaktet janë të kufizuara në përshëndetje xhentile apo në qortime të rastit të sjelljes së keqe.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Vizitoni dhomën e personelit, mensën dhe oborrin e shkollës së paku një herë në ditë. Bisedoni me njerëz dhe vizitoni klasat pa pasur porosi apo arsye të veçantë. Kjo nuk duhet të merr më shumë se njëzetë minuta në ditë, por është investim i mirë.</p>		
<p>Hapi 2. Zbatoni administrimin duke ecur rrethepërqark. Të gjithë e dinë se kush jeni dhe shumica a fytyrave në shkollë janë paksa të njohura për ju. Nxënësit ju shohin si person, jo vetëm si thjeshtë drejtor.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Mos hezitoni të përfshiheni në situata. Jepni shkas për takime, si p.sh. një formë e mbledhjes së kujdestarëve me prindërit ose të konferencës për planifikim të mësimdhënësve të matematikës. Nëse keni ndonjë interesim apo talent të veçantë, e shfrytëzoni atë për të mirën tuaj.</p>		
<p>Hapi 3. Ju jeni të vendosur për të zbatuar qeverisjen demokratike çdo kund ku është e mundur. Keni hequr çdo dyshim që anëtarë të rëndësishëm të personelit përkrahin vendimet tuaja. Kjo do t'u lehtësojë atyre më të pasigurtëve të provojnë metoda të reja.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Shfrytëzoni çdo mundësi për ta përhapur dhe shpjeguar vizionin tuaj. Flisni, flisni, flisni: përsëritni porosinë dhe inkurajoni prirjet e vërteta kurdo që i gjeni. Përdorni reagimet dhe shpërblimet pozitive për të mbajtur proceset e mira në lëvizje. Mos shpenzoni shumë energji në minoritetin e vogël dhe të pandryshueshëm.</p>		

Administrimi ditor

Administrimi rutinor merr një pjesë të madhe të kohës së udhëheqësit të shkollës dhe nuk mund të mos përfillet. Por, është lehtë të kurthoheni pas tavolinës suaj duke e ditur që duhet të bëni punët e administrimit, dhe ato duhet t'i bëni si duhet. Letrat janë aty para jush, duke ju tërhequr lehtësisht vëmendjen, dhe, pa vështirësi, shpesh merreni me ato.

Hapi 1.

Punët rutinore administrative dhe kontrollimi e plotësojnë pjesën më të madhe të ditës. Pasi që përgjegjësia është e juaja, duhet të kontrolloni që çdo gjë është kryer në mënyrë korrekte.

Provoni këtë:

Delegoni më shumë detyra rutinore personelin administrativ. Ata me gjasë do ta parapëlqejnë përgjegjësinë e shtuar. Rishikoni punët rutinore; mund t'ia dilni pa u marrë me disa prej tyre.

Hapi 2.

Diskutoni rutinat ditore me të përfshirët në ato, dhe shihni se çka mund t'u leni të tjerëve të vendosin. Nëse atyre ju duhet trajnim shtesë, ju e siguronit atë.

Provoni këtë:

Kujdesuni që personeli administrativ asnjëherë të mos harrojnë se për kë jeni ju aty, dhe përfshini ata në aktivitete me nxënësit. Bini dakord për principet udhëzuese në vend të instruksioneve të detajuara. Disa anëtarëve të personelit jepu autorizime më të mëdha ashtu që ju të mund të përqendroheshi në udhëheqje pedagogjike.

Hapi 3.

Duke u deleguar të tjerëve, sa më shumë që është e mundur, detyra, ju keni arritur që të mos shpenzoni më shumë se një minimum nga koha në letrat që janë mbledhur në tavolinën tuaj. Jepni prioritet gjërave të duhura: sundimit të ligjit, objektivave të përgjithshme dhe asaj që është më e mirë për nxënësit.

Provoni këtë:

Pranoni si të natyrshme se gjithkush ka vullnet dhe mundësi që të merr vendime të drejta. Vlerësimet e rregullta në masë të madhe mund të zëvendësojnë kontrollin. Si gjithmonë, administrimi juaj bazohet në besim.

Administrimi ditor

Qeverisja, udhëheqja dhe përgjegjësia publike

Zgjidhja e konflikteve

Në të gjitha administrimet, zgjidhja e konflikteve është një detyrë e përsëritshme, dhe kjo nuk është ndryshe as për udhëheqësit e shkollës. Një komplikim shtesë për udhëheqësit e shkollës është fakti se shkolla nuk është vend pune vetëm për nxënësit dhe për personelin por, është gjithashtu autoritet publik që ushtron pushtetin mbi disa qytetarë të saj. Kjo, dhe fakti që shumë njerëz kalojnë shumë kohë në hapësirën e njëjtë të kufizuar shpie deri në konflikte të herë pas hershme. Zgjidhja e konflikteve nga ndonjë herë është çështje zyrtare: konflikti mundet që, nëse nuk zgjidhet në fazë të hershme, të rezultojë në procedura zyrtare dhe ligjore, duke shkaktuar kështu dëm për të gjithë të përfshirët.

Ka rrezik që udhëheqësi i shkollës të ngecë në rolin e zgjidhësit të konflikteve ose të shfrytëzohet nga mësimdhënësit për të frikësuar nxënësit. Kjo është diçka që duhet t'i shmangeni. Personeli, e jo drejtori, do të duhej të përkujdesej për prishje të thjeshta të rregullave. Inkurajoni njerëzit që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me dialog.

Hapi 1.	<i>Provoni këtë:</i>	Zgjidhja e konflikteve	Qeverisja, udhëheqja dhe përgjegjësia publike		
Si drejtor i shkollës vendosni ju, dhe kundërshtimet për këto vendime nuk do të ndihmojnë edhe nëse më vonë e kuptoni që zgjidhja juaj nuk ka qenë mjaft e drejtë. Por, konfliktet e zgjidhura në këtë mënyrë kanë tendencë për t'u rishfaqur.	Dëgjoni të dy palët dhe, para se të vendosni, pyetni për sugjerimet e tyre. Mos u frikësoni të shfaqni papërcaktueshmëri, dhe tregoni gatishmëri për të ndryshuar vendimin tuaj nëse paraqiten rrethana të reja.				
Hapi 2. Në zgjidhjen e problemit përfshini të tjerët, para së gjithash palët në konflikt. Shfrytëzoni mundësinë që të tregoni shembull të mirë të respektit të dyanshëm dhe të përgjegjësisë.	<i>Provoni këtë:</i> Vendosni praktika të zakonshme, p.sh. një komision nxënësish për zgjidhje të konflikteve. Merrni masa që t'i parandaloni konfliktet, si p.sh. përfshini nxënësit në vendosjen e rregullave të shkollës.				
Hapi 3. Provoni gjithmonë t'i identifikoni dhe t'i sqaroni arsyet themelore të konfliktit. Shqyrtoni strukturat: disa sjellje të këqija mund të shkaktohen nga faktorë organizativ apo fizik që mund të ndryshohen. Nëse konfliktet e natyrës së njëjtë përsëriten, shikoni për shpjegime strukturore: si është i organizuar orari, si përdoren objektet shkollore ose nëse resurset mund të rishpërndahen. Analizoni konfliktin pa nguti para se të veproni, dhe nëse duhen ndryshime strukturore përfshini këshillin e shkollës. Kujdesuni që të gjitha palët e përfshira të respektojnë njëra tjetrën, dhe, nëse është e mundur, të arrijnë mirëkuptim reciprok. Konfliktet zgjidhen më së miri nga të involvuarit/përfshirët. Veproni si ndërmjetësues dhe kërkoni konkonzus. Përdorni autoritetin tuaj vetëm si mjet të fundit.					

Fusha kyçe 2: Edukimi me përqendrim në vlera

Një shoqëri homogjene me vlera të përbashkëta, nëse ka ekzistuar ndonjëherë, është gjë e së kaluarës. Shkollimi publik, shikuar historikisht, ka qenë gjithmonë vegël e atyre që kanë qenë në pushtet, e cila ka shërbyer për të përhapur vlera të caktuara në shtetasit e tyre. Kjo ende vazhdon të jetë kështu por, në një shoqëri demokratike, vlerat që duam t'i transferojmë te gjeneratat e reja ndërtohen dhe mbrohen në mënyrë të hapur dhe në procese demokratike. Ky kapitull ka të bëjë në rend të parë me vlerat si demokracia, të drejtat e njeriut dhe respektimi i diversitetit, si dhe se si paraqiten këto vlera në kontekste zyrtare dhe jozyrtare në një shkollë. Sot mjaft vëmendje i kushtohet arritjeve të nxënësve, por nuk duhet të harrojmë një rol tjetër të rëndësishëm të edukimit: promovimin e vlerave dhe shkathtësive shoqërore që janë parakusht për bashkekzistencë në shoqërinë e globalizuar moderne. Pasi që nga analizat e kapitujve të mëparshëm të keni përcaktuar se sa larg keni shkuar në shkollën tuaj në bartjen e vlerave të EQD-së dhe të drejtave të njeriut gjatë edukimit, këtu do të mund të gjeni disa këshilla si të vazhdoni.



THE TOILETS STINK, THE LESSONS ARE BORING, THE FOOD IS DISGUSTING, TEACHERS ARE ROBOT... OH AND THAT'S A NICE TIE

*Tualeteve u vjen era, njësitë mësimore janë të mërzitshme,
Ushqimi është i pakëndshëm, mësimitdhënësit janë
të vrazhdë.....oh dhe kjo është kravatë e bukur*

© Këshillat e shkollës MB (UK) 2003

Pozicioni personal		Pozicioni personal	Edukimi me përqendrim në vlera
<p>Hapi 1. Nuk keni menduar shumë për demokracinë apo për vlerat tjera, sepse në kurrikula nuk mund të gjenden udhëzime të qarta ose eksplicite. Përgjegjësia juaj është që çdo gjë të mësohet sipas rregullave ekzistuese.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Zgjeroni kontekstin tuaj më tutje: çka thuhet për vlerat në ligjet kushtetuese, në konventat e KB-së dhe në dokumente të tjera të ngjashme? Gjithashtu, shtoni njohuritë tuaja për ndryshimin e vlerave në shoqëri. Ka shumë libra për studime teorike në lidhje me këtë temë.⁹</p>		
<p>Hapi 2. Ju e pranoni përgjegjësinë tuaj për të bartur te nxënësit jo vetëm njohuri dhe shkathtësi por gjithashtu edhe një grup vlerash. Ju gjithashtu i arsyetoni të drejtat e nxënësve për të thënë se çka është e drejtë dhe çka e gabuar. Është e nevojshme që edhe personeli juaj sikurse ju të jetë i ndërgjegjshëm për këtë.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Zgjeroni kontekstin e personelit tuaj. Shfrytëzoni burime të jashtme për trajnim brenda shkollës, forume të diskutimit, takime pune, etj. Analizoni dhe përcaktoni së bashku vlerat e përbashkëta qenësore në një shoqëri të mirë dhe në shkollën tuaj. Harxhoni ditë studimi për personelin për këtë qëllim! Siguroni që vlerat të bëhen të qarta në të gjitha dokumentet tuaja të politikave.</p>		
<p>Hapi 3. Keni siguruar që të gjitha proceset në shkollën tuaj bëhen në pajtim me etosin ose tiparin dominues për demokraci të shkollës dhe me respektimin e diversitetin. Librat shkollorë dhe materialet e mësimdhënies kontrollohen në bazë të principeve të njëjta.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Përgjegjësia juaj është të mbani këtë nivel të lartë të edukimit të bazuar në vlera. Vështroni me vëmendje gjatë gjithë kohës dukuritë e diskriminimit apo llojet tjera të sjelljeve jo etike. Shfrytëzoni pozitën tuaj për të shërbyer si shembull dhe merrni për obligim që të keni pikëpamje optimiste për të ardhmen dhe besim të fortë në shokët tuaj si qenie njerëzore, pavarësisht moshës së tyre.</p>		

Një shembull i edukimit me përqendrim në vlera

Nga ndonjë herë nevojitet kurajë për përqendrim në vlera dhe për t'i parashtruar haptazi problemet e rënda. Në vitin 2005., në shkollën për pylltari dhe zdrukthëtarë në Karllovc të Kroacisë, është kryer një projekt studimi për trafikim.

Qëllimet e projektit ishin:

- Të mësohen të rinjtë të njihen me problemin, shkaqet dhe pasojat e tij;
- Të zhvillojnë shkathtësi për shmangie nga situatat e rrezikshme.

Metodat: metoda të participimit për praktikumin e qytetarisë aktive, p.sh., bisedat, diskutimet parlamentare, luajtja e rolit, përgatitja e posterëve dhe gazetave, filmat dhe Interneti.

Partnerët e përfshirë në projekt: mësimdhënësit, nxënësit, kryetari i komunës dhe Këshilli komunal i Karllovcit, policia lokale, OJQ-të dhe mediet lokale.

Projekti është shpërblyer dhe është njohur në nivel kombëtar si një praktikë e mirë e EQD/EDNJ-së.

⁹ Shih p.sh. Putman, *Bowling Alone*, Simon & Schuster, New York 2001, ose Sennett, *The Corrosion of Character*, WW Norton & Ltd., London 2000.

<p>Këshilli i shkollës</p> <p>Shtirirja e udhëzimeve lokale për edukimin me përqendrim në vlera ndryshon prej shteti në shtet, dhe nëse ekzistojnë udhëzime lokale, ato rrallë u shmangen ndryshimeve të rëndësishme nga etosi ose tipari dominues i shkollës kombëtare. Përgjatim natyrisht janë shkollat konfesionale, aty ku ato ekzistojnë. Por, si udhëheqës i shkollës ju do të shfrytëzoni pozicionin tuaj për të theksuar rëndësinë e vlerave demokratike në përdorimin praktik në të gjitha nivelet e shoqërisë, ndër të tjerat edhe në organet udhëheqëse të cilat i kanë më së afërmi nxënësit dhe prindërit e tyre.</p>			
<p>Hapi 1.</p> <p>Për këshillin lokal të shkollës bëni atë për të cilën ju jeni përgjegjës zyrtarisht. Vlerat tjera të cilat nuk janë të parashtruara në dokumentet zyrtare nuk janë brengë e juaj.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i></p> <p>Paraqitni para anëtarëve të këshillit lokal nevojat për udhëzime etike. Jepni sugjerime, por keni kujdes që të filloni me hapa të vegjël.</p>	<p>Këshilli lokal i shkollës</p>	<p>Edukimi me përqendrim në vlera</p>
<p>Hapi 2.</p> <p>Keni pas sukses të rritni interesimin në misionin e shkollës tuaj në një shoqëri me ndryshime të shpejta. Si drejtor i shkollës në kontakt të ngushtë me familje të reja dhe fëmijë, ju dini më shumë se të tjerët për vlerat e ndryshueshme ose në lidhje me ndryshimet në strukturat familjare si dhe për nevojën e implementimit të vlerave të përbashkëta.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i></p> <p>Informoni këshillin lokal të shkollës për progresin që keni pas në shkollën tuaj në fusha si ato të pjesëmarrjes aktive të personelit dhe të nxënësve. Veproni si zëdhënës jo vetëm i anëtarëve të këshillit drejt shkollës, por edhe i shkollës drejt anëtarëve të këshillit.</p>		
<p>Hapi 3.</p> <p>Raporti juaj me këshillin e shkollës bazohet në besim. Ju jeni burim i rëndësishëm për vendimmarrësit. Mos harroni se jeni njohës i çështjeve, dhe se me sigurimin e informacioneve të vlefshme për anëtarët e këshillit u ndihmoni atyre të sjellin vendime më të mira. Disa prej sugjerimeve tuaja veç kanë rezultuar me përmirësime evidente.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i></p> <p>Shfrytëzoni pozitën tuaj që të tërhiqni vëmendjen e anëtarëve të këshillit për nevojën e grupeve të cenueshme ose për fusha tjera ku mendoni se mund të rrezikohen vlerat demokratike dhe të drejtat e njeriut. Rezultatet e mira të arritura në atë fushë mund t'ua lehtësojë autoriteteve që tu sigurojnë fond shtesë që do tu nevojitej për përmirësimin e situatës së fëmijëve dhe të rinjve të rrezikuar.</p>		

Këshilli pedagogjik		Këshilli pedagogjik	Edukimi me përqendrim në vlera
Mësimdhënësit shpesh punojnë vetëm, pas dyerve të mbyllura të klasës dhe rezultatet e mundit të tyre shpesh gjykohet nga të arriturat mësimore të nxënësve të tyre dhe jo aq nga të arriturat tjera. Kanë pak mundësi të takohen për diskutime pedagogjike dhe etike. Këshilli pedagogjik do të duhej të jetë një rast i tillë.			
Hapi 1.	<i>Provoni këtë:</i>		
Detyrat e personelit mësimor janë të kufizuara në mësimdhënie dhe në mbajtje të rendit në klasë. Njohuritë dhe shkathtësitë e rregullta janë gjithmonë para sjelljeve dhe vlerave. Këshillat pedagogjike shfrytëzohen për të zgjidhur çështje teknike dhe formale.	Bëni ndryshime në agjendë: zgjeroni kontekstet në çështje tjera, siç janë dilemat etike të njohura për të gjithë mësimdhënësit. Personelit mësimor mund t'i jepni disa detyra shtëpie para mbledhjes: të lexojnë një artikull për një temë të caktuar, të parashtrojnë një dilemë etike me të cilën janë ndeshur ose të shkruajnë një mendim personal për p.sh., atë se si të zvogëlohet mungesat e pajustificuara.		
Hapi 2.	<i>Provoni këtë:</i>		
Këshillat pedagogjike shfrytëzohen gjithashtu për rritjen e aftësive, p.sh., përmes informacioneve të ekspertëve: çka ndodh në botën jashtë shkollës e që ka efekte në vlera? Kujdeseni që personeli të informohet rregullisht me informacione të përditësuara për atë se çka ndodh në botën që i rrethon, veçanërisht në lidhje me ndryshimin e vlerave dhe të modeleve shoqërore.	Duke u bazuar në familjarizimin e përgjithshëm me ndryshimet aktuale në vlera dhe jetën shoqërore në përgjithësi, personeli mund të përqendrohet në mirëkuptim dhe parandalim në vend të kontrollit dhe ndëshkimit. Nuk duhet të shfrytëzoni mbledhjet e këshillave pedagogjik për të zgjidhur çështje të thjeshta administrative ose praktike: njerëzit e marrin pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe i zgjedhin problemet pa ndihmën tuaj.		
Hapi 3.			
Pasi që çështjet rutinore dhe interpretimi i rregullave nuk u marrin më tutje gjithë kohën, vlerat dhe objektivat janë çështjet dominuese të agjendës. Është me rëndësi që ju si drejtor të gjeni kohë për reflektim dhe studim, ashtu që të jeni burim i besimit dhe i inspirimit për personelin tuaj.			
Personeli, nxënësit dhe drejtorët e shkollave punojnë së bashku në formulimin e karakter ose tiparit dominues të shkollës. Ky fakt është i njohur për të gjithë dhe marrin pjesë të gjithë në këtë. Siguroni që forma dhe përmbajtja e edukimit të jenë në pajtim me vlerat e edukimit të qytetarisë demokratike dhe të të drejtave të njeriut.			

Nxënësit			
<p>Çka e bën një shkollë të suksesshme? Shumë vështrime tregojnë se një shkollë e suksesshme është shkolla e cila në vend të parë i vendos nevojat dhe interesat e nxënësve. Në një shkollë të mirë, asnjëri nuk harron kurrë se shkolla është aty për nxënësit.</p>			
<p>Hapi 1. Në një shkollë autoritare, nxënësit janë niveli më i ulët në hierarkinë e shkollës, pa mundësi ndikimi në çështjet e edukimit. Vlerat e tyre nuk merren në konsiderim.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Nxitni personelin, që gjatë orës së mësimi, të theksojë vlerat universale, jo vetëm faktet dhe shkathtësitë. Ftoni nxënësit të marrin pjesë në vendosjen e rregullave të shkollës dhe në vendimet tjera ku vlerat janë mjaft të përfshira.</p>	Nxënësit	Edukimi me përqendrim në vlera
<p>Hapi 2. Sot në një klasë takohen nxënës me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore, dhe shkolla bëhet emërues i tyre më i vogël i përbashkët në jetën e tyre shoqërore. Së këndejmi, shkollën duhet konsideruar si një vend ideal për implementimin e vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut, vend ku, me konsideratë dhe me qëndrim të hapur, ndeshen mendimet e ndryshme.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Duhet tu bëjmë me dije nxënësve se librat shkollorë nuk përmbajnë domosdoshmëri të vërtetën e padiskutueshme; teksti gjithmonë është filtruar nëpër një sistem të vlerave të autorit.</p>		
<p>Hapi 3. Çka duhet mësuar? Është e qartë se njohuritë dhe shkathtësitë janë të pamjaftueshme. Duhet përshirë mendimin kritik dhe të pavarur si një objektivë të planit mësimor të të gjitha lëndëve. Jeni të ndërgjegjshëm për nevojën e përfshirjes, formale dhe joformale, të nxënësve në vendosjen e strukturës etike për shkollën tuaj.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Sfidoje normën ose modelin duke nxjerr në pah diversitetin. Gjithmonë theksoni përparësitë e sistemit të gjerë të referencave, dhe mos harroni njohuritë që ju keni në klasë nga përvojat e nxënësve tuaj. Shih gjithashtu Hapin 3 në pjesën paraprake “<i>Këshilli pedagogjik</i>”.</p>		

Konteksti jozyrtar/joformal

Kemi thënë përpara: qëllimet e mira në dokumentet e shkruara kanë vlerë të vogël nëse drejtorët e shkollave dhe personeli nuk tregojnë, shpesh në situata të përditshme, se deklaratat zyrtare shprehin në fakt të vërtetën.

Pikëpamja personale		Pikëpamja personale	Edukimi me përqendrim në vlera
<p>Hapi 1. Vlerat tuaja personale nuk janë të rëndësishme. Ju u besoni autoriteteve mbi ju. Vlerat nuk i konsideroni prioritet, përveç ndoshta stabilitetit, rendit dhe dëgjueshmërisë.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Pyeteni veten: cilat janë nxitësit e mi? Çfarë shkolle dëshiroj? Çfarë shoqërie? Cilat vlera dëshiroj t'ua transferojë nxënësve të mi? (ose thjeshtë do ta pyetnit veten: pse dëshiroj të bëhem drejtor i shkollës?)</p>		
<p>Hapi 2. E keni të qartë se çka dëshironi në kuptim të vlerave të cilat duhet të jenë evidente në mësimdhënie dhe në jetën e përditshme të shkollës. Keni filluar gjithashtu të përhapni mendimet e tuaja te njerëzit rreth jush.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Rritni ambiciet tuaja: dëshironi që e tërë shkolla të përqafojë të njëjtat vlera, prandaj harxhoni kohë dhe energji të përhapni këtë mesazh. Në bisedat formale dhe joformale për demokraci, të drejta të njeriut dhe respektim të të gjithëve gjithashtu i përfshini edhe nxënësit. Si gjithmonë, inkurajoni iniciativat e mira.</p>		
<p>Hapi 3. Ju i gëzoni realisht aspektet e reja të jetës, të cilat reflektohen në sjellje dhe në vlerat e të gjitha pjesëve të ndryshme të shoqërisë të përfaqësuar në shkollën tuaj. Angazhimi juaj personal është burim i inspirimit për nxënësit dhe për personelin.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Të gjithë duhet ta kenë të qartë forcën e shembujve të mirë. Mësimdhënësit dhe të rriturit tjerë në shkollë duhet të jenë të bindur thellë në funksionin e tyre të luajtjes së rolit model, ndërsa nxënësit më të moshuar atë se shërbejnë për të njëjtin qëllim për ata të moshës më të re.</p>		

Bisedat në korridor/Socializmi			
Të jesh drejtor i shkollës është punë, në njëfarë mase, e vetmuar, mu sikurse shumë pozita tjera të menaxhimit, dhe gjithmonë ekziston rreziku i izolimit nga të punësuarit dhe nga nxënësit.			
Hapi 1. Biseda në korridor është në shumicën e rasteve humbje kohe.	<i>Provoni këtë:</i> Pyeteni veten: cilin model shoqëror dëshiroj të përvetësojnë nxënësit e mi? Cili është model i mirë për marrëdhëniet shoqërore në vendin e punës? Cilat vlera reflektohen/pasqyrohen nga sjelljet e mia?	Bisedat në korridor/socializmi	Edukimi me përqendrim në vlera
Hapi 2. Takimet joformale të rastit japin informacione të çmueshme për atmosferën shoqërore dhe kodin e mirësjelljes në shkollën tuaj. Nuk jeni i frikësuar nga të qenit vetjak dhe inkurajoni nxënësit dhe personelin të ndajnë mendimet dhe shqetësimet e tyre me ju.	<i>Provoni këtë:</i> Rritja e mundësisë për nxënësit dhe personelin që të takohen jashtë klasës: kafenetë e përbashkëta, hapësirat për drekë dhe vendet tjera për rekreacion, për personelin dhe për nxënësit, do të mund të ishte një hap përpara për rritjen e mirëkuptimit.		
Hapi 3. Gjithandëj nëpër shkollë mund të parandieni mirëseardhjen dhe dashamirësin e sinqertë që buron nga interesimi i sinqertë për njerëzit në përgjithësi. Organizoni ngjarje shoqërore për personelin dhe për nxënësit: festimi i përvjetorëve, organizimi i ngjarjeve sportive dhe gara tjera, gjithçka që i afrojnë njerëzit dhe nxënësve u jep shembuj pozitiv të bashkëkzistencës kundruall të gjitha llojeve të kufijve social. Një efekt pozitiv anësor do të mund të ishte fakti që nxënësit synojnë të bëhen më të devotshëm dhe më bashkëpunues kur kanë pas rastin të shohin mësimdhënësin në dritë më të mirë të tij diku jashtë klasës.			

Administrimi ditor		Administrimi ditor	Edukimi me përqendrim në vlera
<p>Pjesa më e madhe e administrimit ditor është e karakterit zyrtar. Aspekti jozyrtar është shkalla e prioritetit dhe energjia që e jepni për atë pjesë. Por administrimi ditor përfshin gjithashtu mënyrën që ju përgjigjini në pyetje, sa jeni në dispozicion dhe si i përballonit situatat e thjeshta të përditshme.</p>			
<p>Hapi 1. Krenoheni me kontabilitetin e përkryer. Këshilli i shkollës, personeli dhe palët e interesuara mund të jenë të sigurt se gjithçka është në rregull.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Pyeteni veten: a është gjithçka në këtë? Është shumë lehtë të ndodheni i zënë në kurth administrativ; detyrat janë konkrete, të domosdoshme dhe të lehta për t'u përmbytur. Implementimi/zbatimi i vlerave është punë shumë më e papërcaktuar, dhe nuk ekziston një mënyrë e qartë për të filluar si dhe nuk ka metoda të besueshme për matjen e rezultateve.</p>		
<p>Hapi 2. Administrimi korrekt natyrisht se është i nevojshëm, por rutinat administrative janë vetë sistemi. Minimizoni kohën e kaluar në administrim që lidhet me pozitën tuaj. Jepni prioritet edukimit dhe rolit tuaj të bartësit të vlerave demokratike.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Keni durim dhe një shikim më afatgjatë përpara. Vlerat janë një fushë ku rezultatet nuk vërehen menjëherë dhe pasojat nuk mund të parashihen lehtë. Shfrytëzoni situatat e zakonshme si shembuj për të ilustruar vlerat: nëse një njoftim në tabelën e shpalljeve është shkruar në trajtë urdhërore ose negative, kërkoni nga autori ta riformulojë atë. Përveç kësaj, natyrisht, kujdesuni që edhe urdhëresat tuaja për personelin dhe për nxënësit të jenë të shkruara në frymën e duhur.</p>		
<p>Hapi 3. Rezervoni kohë në agjendën tuaj personale për udhëheqje ideologjike/tematike: kujdesuni që të keni kohë për qeverisje, jo vetëm për administrim. Keni parasysh se demokracia duhet të risajohet për çdo gjeneratë të re të nxënësve!</p>			

Zgjidhja e konflikteve		Zgjidhja e konflikteve	Edukimi me përqendrim në vlera
<p>Në një shkollë autoritare, drejtorit shpesh i jepet – ose ai e marr vullnetarisht – rolin e arbitrit në të gjitha llojet e konflikteve. Një pasojë e padëshirueshme e kësaj është krijimi i distancës ndërmjet udhëheqësit dhe të tjerëve në shkollë. Në shkollën e llojit të këtillë konfliktet synohet të trajtohen si kërcënim ndaj sistemit dhe jo si pika fillestare për zhvillim ose, së paku, për reflektim. Mënyra në të cilën ju i vështroni konfliktet është një tregues se si i shihni nxënësit dhe personelin.</p>			
<p>Hapi 1. Me rastin e zgjidhjes së ndonjë konflikti, nëse jeni të pasigurt në diçka, shikoni rregulloret. Është me rëndësi të dallohet kë duhet fajësuar.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Dëgjoni në mënyrë aktive dhe bëni pyetje shtesë për të kuptuar më thellë se çka kanë për të thënë të dy palët. Kur ato reagojnë fortë kundër vendimit, tentoni të gjeni cilat vlera ose motive themelore mund të jenë shkaktar i reagimit të tyre.</p>		
<p>Hapi 2. Është me rëndësi për ju që të respektohet gjithashtu edhe integriteti i keqbërësit, e jo vetëm i palës së dëmtuar. Ju bazoni gjykimin tuaj gjithashtu në përvojën, e cila dëshmon se në shumicën e konflikteve duhet fajësuar të dy palët.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Disa konflikte janë më të rëndësishëm për tu zgjidhur sa se të tjerët, madje edhe nëse ato mund të konsiderohen si të parëndësishëm. Kujdesuni për konfliktet që mund të kenë burimin në diskriminim gjinor, etnik, të pamjes ose të mete.</p>		
<p>Hapi 3. Pranoni faktin se jo të gjitha konfliktet mund të zgjidhen lehtë. Trajtoni konfliktet si shprehje e vlerave të ndryshme dhe çmoni faktin se mirëkuptimi dhe zgjidhja shpesh bazohen në tolerancë, pranim dhe kompromis, e jo në gjetjen e viktimës.</p> <p>Konflikti mund të shikohet gjithashtu edhe si një nxitje për zhvillim dhe si një rast për të përfshirë nxënësit, prindërit dhe pjesëmarrësit tjerë që mund të ndihmojnë. Qëllimi juaj është të parashikoni dhe të parandaloni konfliktet. Përfundimisht, shumë energji e shpenzuar në zgjidhjen e konflikteve mund të shfrytëzohet për qëllime më të mira: të rritet mirëkuptimi ndër nxënës për një devotshmëri/lojalitet ndaj njëri tjetrit, ndaj shkollës dhe, në fund, ndaj shoqërisë.</p>			

Fusha kryesore 3: Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja: Konkurrenca dhe vetëvendosja e shkollës

Shoqëria shkollore shpesh cilësohet si formë e ndarë e pjesës tjetër të shoqërisë, nga pjesa reale e botës, dhe nga mësimdhënësit shpesh dëgjojmë se ata nuk dinë aq shumë nga jeta reale, pasi që kanë kaluar një pjesë të madhe të jetës së tyre në shkollë. E njëjta gjë thuhet për drejtorët e shkollave, të cilët, në të vërtetë, shpesh drejtojnë biznese me numër të ngjashëm të punëtorëve sa ka një kompani me madhësi mesatare. Edhe mund të ketë diçka të vërtetë në këtë kritikë. Deri përpara disa gjeneratash, shkolla është konsideruar si përfaqësuese e autoriteteve të larta ose si një privilegj për të pasurit, dhe akoma mund të gjenden shkolla dhe ideologji shkollore që mbajnë vulën e ekskluzivitetit dhe të shkëputjes nga shoqëria. Prandaj, ajo që duhet bërë është hapja e shkollave tona, dalja në skenë dhe luajtja e rolit tonë në shoqëri. E përmbushim apo jo këtë rol, a jemi aktorë të rëndësishëm e jo përsiatës/spekulatorë në procesin e ndërtimit të shoqërisë demokratike. Pra, cilat veprime mund t'i ndërmarim? Dhe si t'i bëjmë ballë konkurrencës, pa braktisur vlerat tona kryesore?

Konteksti zyrtar/formal

Pozicioni personal		Pozicioni personal	Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja
<p>Hapi 1. Brenga juaj kryesore është reputacioni i mirë i shkollës tuaj. Duhet të kujdeseni që të gjitha informacionet që dalin nga shkolla të jenë të kontrolluara, pozitive dhe që nuk zgjojnë kundërshtime. Ambasadori më i mirë për shkollën jeni ju.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Pyeteni veten: në çka do të duhej mbështetur reputacionin e mirë? Si mund të arrijmë stabilitet kur shumë gjëra ndryshojnë shumë shpejtë?</p>		
<p>Hapi 2. Keni bërë analizë të thellë të objektivave të një shkolle të mirë, siç është përshkruar në dokumentet zyrtare. E keni të qartë se mësimdhënia e mirë nuk është e mjaftueshme për të bërë shkollën më të mirë. Vizioni juaj është më i gjerë se sa aq: shkolla është bashkimi i kulturores dhe shoqërores në një shoqëri të larmishme moderne.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Shkoni nga perspektiva nacionale/teorike kah ajo lokale dhe praktike: cila është shkolla më e mirë për komunitetin. Përfshini personelin dhe palët e interesuara në këtë analizë. Gjithmonë thirrni mediet lokale kur ndodh diçka e interesit të përbashkët. Gjithashtu, kujdesuni që shkolla të ketë një ueb faqe atraktive dhe të përditësuar në Internet.</p>		
<p>Hapi 3. Brenga juaj kryesore është që shkolla juaj të sigurojë një ambient për mësim më të mirë të mundshëm për nxënësit e saj. Shkolla juaj gjithashtu luan një rol aktiv në komunitet. Si drejtor i shkollës jeni një person i rëndësishëm në shoqëri dhe në komunitetet ku prindërit kanë mundësi të zgjedhin shkollën për fëmijët e tyre, pozita e shkollës tuaj është më e përshtatshme</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Shfrytëzoni pozitën tuaj të mbronit interesat e grupeve të cënueshme, dhe angazhoni njerëzit dhe organizatat jashtë shkollës në dialog për vlerat qenësore dhe qytetarinë aktive.</p>		

kundrejt shkollave konkurruese dhe jo aq e ekspozuar prirjeve jetëshkurtra.			
-----------------------------------------------------------------------------	--	--	--

Këshilli i shkollës			
Këshilli i shkollës është punëdhënësi juaj dhe është detyrë e juaj që vizionet e tij t'i zbatoni në praktikë. Këtu do të supozojmë se synimet e tij dhe pikëvështrimi juaj përputhen.			
Hapi 1. Në kontaktet tuaja me këshillin e shkollës, ju theksoni imazhin e jashtëm të shkollës tuaj, si p.sh., statistikat favorizuese të suksesit të nxënësve ose administrimin e mirë ekonomik.	<i>Provoni këtë:</i> Nxirrni në pah edhe aspekte tjera. Mund të paraqitni një ose dy orvatje premtuese për bashkëpunim me organizatat lokale ose me prindërit dhe paralajmëroni për disa probleme që duhet zgjidhur.	Këshilli lokal i shkollës	Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja
Hapi 2. Në një shkollë të financuar nga fondet publike, këshilli i shkollës ka një perspektivë më të gjerë se sa sukcesi në mësimet e nxënësve. Kjo është një pikë e mirë fillestare për vendosjen e qëllimeve të shkollës tuaj dhe për vendin e sajë në komunitet. Ambiciet e tuaja ia komunikoni këshillit të shkollës.	<i>Provoni këtë:</i> Bëhuni proaktiv: merrni informacione për procedurat formale dhe orarin e këshillit të shkollës. Perspektiva e tyre kohore është shpesh e gjatë dhe synon të ndjekë kohëzgjatjen e mandateve politike. Dorëzoni anëtarëve të këshillit planet mirë të përgatitura për bashkëpunim dhe projektet për zhvillimin e shkollës, dhe bëhuni të gatshëm për kompromis.		
Hapi 3. Këshilli i shkollës u konsideron si burim më të besueshëm i njohurive për qeverisjen e shkollës lokale. Vendimet e miratuara në nivelet politike janë në pajtim me planet afatgjata për shkollën tuaj dhe u japin hapësirë që u nevojitet për tu marrë me konkurrencën dhe ndryshimet e shpejta.	<i>Provoni këtë:</i> I tërë komuniteti ka dobi nga një shkollë prosperuese. Shfrytëzoni pozitën tuaj që të fitoni resurset që u nevojiten në mënyrë që shkollën ta bëni madje edhe më të mirë. Përmendni efektet bashkëvepruese që mund t'i fitoni nga bashkëpunimi juaj me shërbimet tjera në komunitet, siç janë shëndetësia dhe mirëqenia sociale. Mundësohu OJQ-ve lokale të shfrytëzojnë hapësirat e shkollës tuaj për mbledhjet e tyre kur shkolla edhe ashtu është e zbrazët.		

<p>Këshilli pedagogjik</p> <p>Me ndryshimet në shoqëri, ndryshon edhe shkolla, e me këtë edhe roli i mësimdhënësve. Shumë familje e kanë origjinën e tyre nga disa vende tjera, brenda ose jashtë vendit, ndërsa shkolla funksionon si rrjet më i rëndësishëm i tyre shoqëror. Kjo e bën më të vështirë vënien e vijës së qartë ndërmjet përgjegjësive të shkollës dhe atyre të institucioneve tjera në shoqëri. Detyra juaj si drejtor i shkollës është të ndërgjegjësoni personelin tuaj për ndryshimet e tilla dhe t’u prini drejtë një koncepti të ri shkollës, e cila u përgjigjet më së miri qëllimeve të grupit tuaj të veçantë të synuar.</p>	
<p>Hapi 1. Detyra e mësimdhënësit është e kufizuar në mësimdhënie. Ju shpesh dëgjoni mësimdhënësit duke thënë: “ Unë jam mësimdhënës, asgjë tjetër”, ose “Kjo është shkollë, asgjë tjetër”. Dhe ju pajtoheni.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Bëhuni të hapur për sugjerimet e personelit që kanë për qëllim përfshirjen e shoqërisë jashtë shkollës në mësimdhënien e tyre. Tregohu qartë, atyre dhe kolegëve të tyre skeptik, se janë në rrugë të drejtë.</p>
<p>Hapi 2. Personeli duhet bërë me dije rolin e zgjeruar të shkollës në një bashkësi moderne dhe të larmishme: ata do të duhej ta konsideronin shkollën si një faktor të rëndësishëm të unifikimit, ndërsa veten si një model me ndikim tek të rinjtë. Shfrytëzoni këshillat pedagogjike për të forcuar rolin e tillë të ri të shkollës dhe të mësimdhënësit.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Angazhoni ekspertë për leksione dhe dialogim gjatë mbledhjeve të këshillit pedagogjik dhe gjatë ditëve studimore. Përfshini personelin dhe nxënësit në vendosjen e kontakteve me shoqërinë. Shfrytëzoni ekspertët e jashtëm për vlerësim si pikë nismëtare për zhvillim. Inkurajoni personelin të shfrytëzojnë rrjetet e tyre personale për vendosjen e bashkëpunimit afatshkurtër dhe afatgjatë me shkollën.</p>
<p>Hapi 3. Shkolla juaj është shembull në të gjithë vendin. Qëndrimi juaj i hapur tërheq vëmendjen e shumë të tjerëve. Personeli dhe nxënësit janë krenar me shkollën e tyre dhe vizitorëve u përcjellin të njëjtin lloj të mesazheve pozitive. Gjatë mbledhjeve të Këshillit pedagogjik, koha harxhohet shpesh në analizimin dhe mbështetjen/fuqizimin e imazhit të shkollës tuaj.</p> <p>Nxënësve dhe personelit ju mundësoni të përfaqësojnë shkollën në situata zyrtare, pasi që ata shpesh janë ambasadorët më të mirë. Thirrni ish nxënësit tuaj më të moshuar për t’u ofruar shembuj të mirë nxënësve më të rinj.</p>	
	<p>Këshilli pedagogjik</p>
	<p>Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja</p>

Nxënësit		Nxënësit	Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja
<p>Nxënësit sot janë grupi më i gjallë/shpërthyes, sidomos në mjediset urbane. Në disa komunitete, nëse prindërit nuk janë të kënaqur me shkollën mund ta zhvendosin fëmijën e tyre në një shkollë tjetër. Në një situatë të këtillë provojmë të gjejmë mënyrën më të lehtë duke tentuar të zbulojmë çka është më popullore/e përhapur, dhe përipiqemi t'i adaptohem asaj situatë me qëllim të pranimit dhe mbajtjes së nxënësve. Një qasje tjetër është përvetësimi i koncepteve të vjetra dhe mirë të dëshmuara. Prandaj, si do t'i kombinoni traditën e vjetër akademike me bartjen e vlerave kulturore dhe etike në rrethana të konkurrencës së ashpër?</p>			
<p>Hapi 1. Për shkollën është me rëndësi që nxënësit të tregojnë rezultate të mira në mësim, pra që të kalojnë tërë ditën shkollë në mësim. Aktivitete tjera janë të rralla, pasi që marrin kohë të çmueshme jashtë mësimi. Prindërit informohen për detyrimet e tyre.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Rezultatet në mësim kanë prioritet të lartë, por ka edhe gjëra tjera që mund të mësohen në shkollë. Qëllimi i përfshirjes së nxënësve akoma mbetet i njëjtë: të kenë rezultate të mira në mësim në krahasim me shkollat konkurrencte. Këshillit të nxënësve, nëse ka të tillë, i lejohet të mbajë mbledhje vetëm pas ose ndërmjet orëve të mësimi.</p>		
<p>Hapi 2. Për të përmirësuar mësimin efektiv, nxënësit duhet të ndiejnë mbështetjen dhe besimin nga të rriturit. Pyetni ata se çka presin prej shkollës, dhe mundësoni të vlerësojnë rregullsinë e mësimdhënies. Në rastin e nxënësve në moshë më të re, pyetni prindërit e tyre.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Jepni këshillit të nxënësve hapësirë dhe kohë në orarin e shkollës. Thirrni prindërit në mbledhje në mënyrë që të merrni informacion se çka presin ata prej shkollës. Përfshini nxënësit dhe palët tjera të interesuara në aktivitete shoqërore, dhe krijoni tradita të vendosje së frymës së komunitetit në shkollë. Për të bërë një lidhje të qartë ndërmjet subjekteve të shkollës dhe jetës në punë, kontakti ndërmarrjet lokale. Prindërit mund t'u ndihmojnë shumë në këtë rast. Nxënësit le t'i vizitojnë vendet e punës dhe thirrni përfaqësues të ndërmarrjeve si ligjërues të ftuar në shkollë.</p>		
<p>Hapi 3. Shih tabelën paraprake “<i>Këshilli pedagogjik</i>”.</p>			

Këshilli i nxënësve: shembull

Këshilli i nxënësve mund të ketë një strukturë mjaftë të thjeshtë, me një numër të përfaqësuesve për mbledhjet e rregullta të këtij organi, ndoshta me kryesues dhe sekretar në pozita udhëheqëse. Por, i njëjti mund të organizohet në formë më të ndërlikuar, siç është rasti i gjimnazit klasik Illyés Gyula në Budaörs, në Hungari:

Senati ka dy përfaqësues nga çdo klasë dhe kryesohet nga Nënkrjetari.

Kabineti, i udhëhequr nga Kryetari, është autoritet ekzekutiv. Kryetari dhe Nënkrjetari zgjidhen nga këshilli i nxënësve. Mandati i tyre buron nga Senati.

Trupi gjykues ka nga një anëtar prej çdo klase. Ky trup ndërmjetëson në konfliktet ndërmjet nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve dhe mësimitdhënësve. Synimi i trupit gjykues është të arrihet koncensus ndërmjet palëve në konflikt.

Anëtarëve të këshillit të nxënësve u mbahen trajnime të veçanta dhe ata mbështeten në punën e tyre nga udhëheqja e shkollës. Një nga rezultatet e deritashme të gjimnazit klasik Illyés Guyla është respekti dhe besimi më i madh i ndërsjellë ndërmjet nxënësve dhe mësimitdhënësve. Mësimitdhënësit gjithashtu përpiqen t'i trajtojnë nxënësit më shumë si partner të barabartë.

Konteksti jozyrtar

Pikëpamja personale		Pikëpamja personale	Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja
<p>Hapi 1. Satisfacionin tuaj më të lartë ju e fitoni nga rangimi i mirë në raportet statistikore. Fryma garuese është një sfidë frymëzuese për ju. Fëmijët e braktisur konsiderohen si kërcënim.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Pyeteni veten: ne i bëjmë punët mirë, por a jemi duke bërë ato gjëra që duhet? A jemi shumë të mbyllur në këtë botë të shkollës? Mos kemi harruar diçka që është e rëndësishme? Çka do të ndodh nëse rangimi ynë bie?</p>		
<p>Hapi 2. Dëshironi të zgjeroni kontaktet e shkollës me botën jashtë saj dhe të kriterëve për pranim të nxënësve. Konstatoni se të rinjve u nevojiten kualifikime tjera e jo vetëm nota të mira që të jenë të suksesshëm në jetë dhe e konsideroni atë përgjegjësi tuajën që t'u siguron disa prej shkathtësive në shkollë.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Pikë së pari shfrytëzoni rrjetin tuaj personal dhe thirrni OJQ-t të vizitojnë shkollën tuaj: <i>Save the Children</i>, ambientalistët, klubin lokal të shahistëve ose cilindo që e njihni ju e që mund të gjallërojnë ditën në shkollë ose të inspirojnë disa nxënës për aktivitete të reja dhe të zgjeruara. Shpesh në mesin e të rinjve ka një dozë të madhe të idealizmit të cilën nuk arrijmë ta vlerësojmë/pranojmë. Nëse jeni kritikuar, hapuni për dialog. Mos kaloni në defanzivë.</p>		
<p>Hapi 3. Ju e konsideroni veten si instruktor, që gjithmonë ofron ndihmë kur sheh përmirësim; i vëreni dhe i lëvdoni madje edhe hapat e vogël, në dukje të parëndësishëm, të bërë në drejtim të duhur. Ju edhe më tutje jeni të lumtur për rezultate të mira, por një pjesë të meritave për të arriturat e tilla i takon frymës bashkëpunuese dhe të hapur ndër personel dhe nxënës. Pozicioni juaj i vendosur ua mundëson të jeni zemërgjerë dhe praktikant e mira të ndani me shkollat tjera. Krenoheni me shkollën tuaj dhe më atë që keni arritur së bashku. Të gjithëve u është e qartë se fjalët tuaja të vazhdueshme për “demokraci” dhe “përgjegjësi” për të gjithë janë të sinqerta. Një pjesë të konsiderueshme të kohës tuaj gjatë ditës kaloje jashtë zyrës tuaj. Shfrytëzoni çdo rast të forconi moralin e personelit dhe të nxënësve tuaj.</p>			

Bisedat në korridor/socializimi		Bisedat në korridor/socializimi	Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja
<p>Hapi 1. Pyetje të rëndësishme duhet zgjidhur në mbledhje zyrtare. Ajo që është thënë në takimet e rastësishme nuk merret parasysh. Kjo aq më tepër sepse nuk është mirë për reputacionin e shkollës, nëse komentet kritike ose bisedat për problemet dëgjohen në korridore.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Mos e nënvlerësoni atë që keni dëgjuar në rrugë jozyrtare. Ajo që njerëzit ia thonë udhëheqësit të vet rrallë është plotësisht spontane: ata me gjasë gjatë e kanë menduar atë mendim paraprakisht. Prandaj, mos shpejtoni të përgjigjeni kalimthi në pyetjet vendimtare. Dëgjoni, tregoni interesim dhe mirënjohje, por mos u ngutni!</p>		
<p>Hapi 2. Shikoni rreth jush: si komunikojnë njerëzit? Për shembull, nëse nuk dëshironi që nxënësit të marrin çantat e tyre në bibliotekë, do t'i udhëzoni në dy mënyra: Është e ndaluar të sillni çantat në bibliotekë” ose, pran një rafti jashtë: “Ju lutem leni çantat tuaja këtu”.</p> <p>Si i pranojnë vizitorët personeli dhe nxënësit? Cilat janë përshtypjet e para të tyre?</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Gjithmonë ofroni shembull të mirë të çiltërsisë dhe mirësjelljes. Kujdesuni që njoftimet në tabelën e shpalljeve dhe në klasa të formulohen me tonë pozitiv. Parandalimi është gjithmonë më i mirë se sa mjekimi, dhe nëse nxënësit dhe vizitorët hasin plotë shenja që u tregojnë personelit dhe nxënësve se çka nuk guxojnë të bëjnë, mund të mendojnë se gjithçka që nuk është e ndaluar është e lejuar. Kjo nuk është mënyrë për tu kujdesur për qytetarë të pavarur dhe të përgjegjshëm.</p>		
<p>Hapi 3. Shih tabelën paraprake “<i>Pikëpamja personale</i>”.</p>			

Administrimi ditor		Administrimi ditor	Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja
<p>Hapi 1. Bënë sa të jetë mundur më shumë vetë. Kjo është garancia më e mirë se administrimi ditor është kryer në mënyrë të duhur. Kjo gjithashtu do të thotë se nuk ka nevojë të përfshihen mësimdhënësit në administrimin praktik. Ata mund të përqendrohen në mësimdhënie. Qëndrimi i përgjithshëm i personelit është që t'i përmbahen fushë veprimtarisë së tyre dhe të mos ndërhyjnë në atë se çka bëjnë të tjerët. Keni përpiluar përshkrim të detajuar të vendeve të punës për të gjithë të punësuarit.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Shmanguni disa prej shumë detyrave joprofesionale. Shqyrtoni të gjitha punët rutinore në bashkëpunim me personelin e involvuar. Së bashku ju sigurisht do të gjeni disa zgjidhje më të mira, ashtu që çdo njëri të ketë kohë të mjaftueshme për gjëra më frymëzuese. Jepni mësimdhënësve me tepër njohuri për administrimin e shkollës. Ata do të mund të kenë ide të mira për efikasitet me të madh ose, së paku, nuk do të shtrojnë kërkesa jorealiste.</p> <p>Kërkoni zgjidhje digjitale për administrim rutinor. Për shembull, në shumë vende shumica e prindërve kanë qasje në Internet; kështu që shumë prej raporteve rutinore për prindërit mund të bëhen në mënyrë shumë më efikase.</p>		
<p>Hapi 2. Në orar keni siguruar kohë për aktivitete jashtëmësimore si dhe për mësimdhënësit që duan të provojnë metoda të reja të bashkëpunimit. Personeli jopedagogjik inkurajohet të merr pjesë në aktivitetet pedagogjike.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Sa ma tepër që njerëzit të përfshihen në çështjet e përgjithshme, aq më shumë përgjegjësi marrin. Kështu zvogëlohet nevoja për kontroll.</p>		
<p>Hapi 3. Shkolla ka gatishmëri që praktikat e mira t'i ndajë me shkollat dhe profesionistët tjerë. Thirrni në shkollë mediet, madje edhe nëse keni probleme. Kjo dëshmon guximin dhe vetëbesimin tuaj.</p> <p>Krahasoni vetveten me organizatat tjera; shkolla nuk është aq e veçantë sa mund të mendoni ju, siç nuk është edhe administrimi i shkollës. Bëhuni mendjehapur në gjurmimin tuaj për praktikën më të mirë!</p>			


Zgjidhja e konflikteve

Zgjidhja e konflikteve, si një aspekt i qeverisjes demokratike, është trajtuar mjaftë gjerësisht në Fushat tjera të rëndësishme me të cilat çështje të tilla lidhen në mënyrë më të natyrshme. Këtu le të japim disa komente plotësuese për zgjedhjen e konflikteve duke i konsideruar këto si një aspekt jozyrtar të Fushës themelore 3.

Nuk është gjithmonë zgjidhje e mençur të fshihet konflikti; por ju duhet gjetur një balancim këtu: nëse konflikti ka gjasa të shqetësojë shumë persona ose të përhapet jashtë shkollës, do të ishte e mençur të jeni ai që do të jepni informacionin e drejtpërdrejtë, jo të pritni dhe të reagoni pasi që të jetë shkaktuar dëmi. Prandaj, sinqeriteti mund të ishte metodë e mirë e vetëmbrojtjes. Gjithmonë është më mirë për ju dhe për shkollën nëse versionin e parë që do ta merr publiku të jetë versioni juaj. Në atmosferë të hapur, konfliktet e vogla kanë më pak gjasa të rriten. Respektimi dhe mirëkuptimi reciprok janë qenësor në zgjidhjen e konflikteve, e kurrsesi prestigji dhe hakmarrja.

Zgjidhja e konflikteve

Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja



Nëse nuk mund të mundni kapadainjtë.....

Kërkoni ndihmë!

Bëni ndryshim – bisedoni me këshillin e shkollës tuaj
Këshilli i shkollës në BM (UK) – www.schoolcouncils.org

Fusha themelore 4: Disiplina e nxënësve

Kur punojnë shumë njerëz në një vend së bashku, siç ndodh në shkollë, është e nevojshme disiplina. Pyetja që shtrohet këtu është: Cilat veprime do të duhej përdorur për të mbajtur rendin dhe disiplinën? Çka i shtynë nxënësit që të respektojnë rregullat e vendosura dhe çka i detyron ata që t'i kundërshtojnë këto rregulla? Problemet disiplinore dihen mirë nga secili që ka qenë në shkollë dhe, si të tilla, nuk zgjidhen edhe aq lehtë. Shkaqet për problemet disiplinore ndryshojnë. Ja disa prej tyre:

- grupe të mëdha me pak të rritur pranë tyre;
- lëndët që mësohen nuk i motivojnë nxënësit. Ata gjithashtu nuk janë të vetëdijshëm për përfitimet nga mësimi i disa lëndëve;
- qëndrim indiferent i shkollës në interesat dhe vlerat e nxënësve;
- metodat e mësimdhënies nuk i përshtaten stilit të mësimnxënies së nxënësit.

Shpesh burimi i problemit ndodhet jashtë shkollës:

- psikozë për shkak të situatës sociale, etnike ose ndonjë lloji të paaftësisë;

si dhe, natyrisht, dobësitë njerëzore të cilat janë të zakonshme ndër nxënës, sikurse edhe ndër të rritur: përtacia, mospërfillja, mungesa e ndjeshmërisë dhe shumë të tjera.

Kur kësaj i shtohet edhe fakti se nxënësit kalojnë nëpër një fazë shumë të rëndësishme, dhe ngandonjëherë të vështirë, të zhvillimit të tyre personal gjatë viteve shkollore, do të kuptoni se shkollat bëjnë një punë të çmueshme, dhe atë çdo ditë dhe gjithkund. Prandaj, mënyra se si e vështroni disiplinën varet shumë se si i vështroni të rinjtë. A janë ata rrezik potencial që duhet mbajtur nën kontroll të rreptë, ose qenie njerëzore mu sikurse edhe ne, vetëm më të rinj dhe me më pak përvojë?

Si të rritur, duhet respektuar ligjet dhe rregullat në shoqëri. Natyrisht, njësoj vlen edhe për shkollën. Duhet të ketë rregulla. Por, sikurse në shoqëri në përgjithësi, rregulltat në shkollë do të duhej përcaktuar përmes një procesi demokratik nga ato që janë të ndikuar prej tyre.

Konteksti zyrtar

Pozicioni personal		Pozicioni personal	Disiplina e nxënësit
<p>Hapi 1.</p> <p>Ju besoni shumë në rregulla dhe në autoritet si mjete për mbajtjen e rendit. Rregullat sjellin stabilitet sepse nxënësit gjithmonë do të dinë se si të sillen. Ato gjithashtu thjeshtojnë komunikimin shoqëror në shkollë dhe i kursejnë mësimdhënësit prej diskutimeve bjerrakohëse. Drejtori i shkollës, sipas pozitës së autoritetit më të lartë në shkollë, gjithmonë ka të drejtë.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i></p> <p>Pyeteni veten: a ekzistojnë shkaktarë strukturor që mund të eliminohen? Për shembull, a mund të ndërrojmë orarin ashtu që të rriturit në shkollë të jenë kohë më të gjatë me nxënës? Ose, kujdesuni që në shumë vende të ketë orë të mëdha që u lehtëson nxënësve të jenë të përpiktë në orët mësimore. Ndoshta ekzistojnë mënyra më të lehta për të rritur efikasitetin në shkollën tuaj dhe për të zvogëluar kohë dhe energji të harxhuar në masa disiplinore.</p>		
<p>Hapi 2.</p> <p>Si drejtor, ju i interpretoni rregullat dhe masat ndëshkimore, por jeni i gatshëm të dëgjoni nxënësit para se të vendosni dhe gjithashtu më i hapur për nevojat dhe interesat e nxënësve. Mund të ketë rrethana lehtësuese; p.sh., disa probleme disiplinore mund ta kenë burimin në ndryshimet kulturore.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i></p> <p>Inkurajoni mësimdhënësit të përqendrohen më shumë në motivimin e nxënësve se sa në autoritetin e mësimdhënësit. Angazhoni nxënësit në vendosjen e rregullave. Kërkoni këshilla se si të merreni me ndryshimet kulturore. Nxënësit, sikurse çdo kush tjetër, dëshirojnë të kryejnë punën e tyre në paqe dhe qetësi, e jo në rrëmujë. Në vend se të flisni me gjuhën e rregullave dhe dënimeve, shfrytëzoni përgjegjësitë dhe të drejtat.</p>		
<p>Hapi 3.</p> <p>Të gjithë janë të angazhuar në përpjekjet e vazhdueshme për mbajtjen e rendit dhe të disiplinës. Dallimi është se tash dihet kodi i mirësjelljes nga të gjithë dhe përvetësohet nga shumica. Respektimi reciprok dhe interesat e përbashkëta janë udhërrëfyes për vendosjen e rregullave në shkollë. Më i rëndësishëm është bashkëpunimi se sa autoriteti, dhe rregullat rishikohen rregullisht nga nxënësit, personeli dhe udhëheqja.</p> <p>Autoriteti është diçka që fitohet, e jo diçka që vjen vetvetiu me pozitën. Por ju jeni gjithashtu i vetëdijshëm se, sikurse në botën që ju rrethon,</p>	<p><i>Provoni këtë:</i></p> <p>Nëse duhet të ndërmerri ndëshkime, bëhuni të qartë, por të matur. Kritikoni me kujdes veprën, e jo personin që e ka kryer atë. Inkurajoni sjelljet e mira duke zgjeruar liritë për ata që japin prova të përgjegjësisë dhe sjelljeve të qëlluara. Gjithmonë keni parasysh që, si i rritur, të jepni shembull të mirë për individët e rinj dhe në formim, dhe keni përgjegjësi t'i përfshini ata në shoqëri, e jo t'i përjashtoni nga ajo.</p>		

gjithmonë do të ketë të tillë që nuk ju bindet lehtë rregullave të vendosura, ose nuk arrijnë të disiplinojnë veten pa mbështetjen e rregullave dhe kërcënimit me ndëshkime.			
------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--

Këshilli i shkollës			
Këshilli i shkollës nuk do të duhej të ndërhynte në punët e përditshme të shkollës në gjendje normale, kështu që disiplina nuk është diçka që duhet diskutuar në këshillin e shkollës. Ajo konsiderohet si një çështje e brendshme e shkollës.			
Hapi 1. Si drejtor i shkollës, jeni përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe të disiplinës. Kjo mund të jetë detyrë mjaftë e rëndë për drejtorin e shkollës.	<i>Provoni këtë:</i> Veni theksin në faktorët shoqëror që kanë ndikim në shkollë dhe që mund të zvogëlohen përmes disa ndryshimeve në politikat e vetë shkollës. Shtroni pyetjen: si mund të neutralizojnë segregacionin dhe format tjera të padrejtësive sociale këshilli i shkollës dhe politikanët lokal?	Këshilli lokal i shkollës	Disiplina e nxënësit
Hapi 2. Ju e keni të qartë se disiplina është një çështje më e gjerë se sa një problem i brendshëm i shkollës. Si gjithmonë, ndryshimet në shoqëri kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën shkollë.	<i>Provoni këtë:</i> Shfrytëzoni pozitën dhe dijen tuaj që t'ju bindni organet qeveritare për përshtatje të nevojshme në shpërndarje të resurseve. Jepni një pasqyrë të balancuar, për të neutralizuar kërkesat populiste për “rend dhe ligj” pa nënvlerësuar shqetësimet e vërteta.		
Hapi 3. Këshilli i shkollës ka pasqyrë të qartë se si nxitet dhe mbrohet sjellja e mirë e nxënësve. Shkolla juaj konsiderohet si një shembull i mirë për implementimin e disiplinës.	<i>Provoni këtë:</i> Merrni masa që këshilli i shkollës të ndërgjegjësohet se qytetaria e mirë fillon në shkollë, dhe mjetet e harxhuara këtu janë një investim i mirë për shoqërinë.		

Këshilli pedagogjik		Këshilli pedagogjik	Disiplina e nxënësit
<p>Drejtor i shkollës gjithmonë do të duhej ta kenë parasysh se disiplina e nxënësve është e një rëndësie shumë të madhe për mësimdhënësit. Mësimdhënësit janë ata që të parët ballafaqohen me sjellje jodisiplinore, dhe shpesh janë të vetmuar në mesin e një grupi të madh të nxënësve. Prandaj, çka duhet ndërmarrë për të bërë kushte dhe rregulla më të mira, në mënyrë që mësimdhënësit të krijojnë një ambient të mirë të punës në klasë për nxënësit dhe për vetveten?</p>			
<p>Hapi 1. Mësimdhënësi ka pushtet në klasë. Kundruall nxënësve ju si drejtor gjithmonë mbështetni mësimdhënësin në çështjet disiplinore. Megjithatë, ju prireni që problemet disiplinore t'i konsideroni si dobësi personale të mësimdhënësve ose mungesë karakteri të nxënësve.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Shqyrtoni disiplinën në kuptim të përgjithshëm. Keni kujdes që të mos lëndoni individët. Gjeni se çka është pengesë më të madhe e personelin për mbajtjen e rendit. Inkurajoni çiltërsinë; ajo që mund të konsiderohet si fort personale mund të del lehtë se është një përvojë e përbashkët për të gjithë, ose gjati për të gjithë. Vendosni rregullat e përbashkëta; tentoni të arrini konsensus në nivel minimal dhe insistoni që secili të jetë i devotshëm në atë që të gjithë së bashku keni vendos.</p>		
<p>Hapi 2. Keni bërë disa përmirësime organizative. Por, mendim i përgjithshëm është se akoma nxënësit, e jo shkolla, janë ata që duhet të ndryshojnë. Shumë mësimdhënës i konsiderojnë problemet disiplinore si të meta personale dhe profesionale.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Sillni ekspertët që mësimdhënësve tu japin njohuri më të mira në lidhje me zhvendosjen e vlerave që ndodhin në shoqëri, si dhe për dallimet etnike dhe kulturore. Gjithashtu, përpiquni ta trajtoni situatën nga pikëvështrimi i nxënësit: cilat procese në shkollën tonë tregojnë sjellje të padobishme? Çka mund të ndryshojmë?</p>		
<p>Hapi 3. Problemet e disiplinës janë shqyrtuar nga një perspektivë më e gjerë dhe nuk konsiderohen si të meta personale ndër personel dhe udhëheqës. Është e nevojshme një njohje më e thellë e shoqërisë moderne dhe e ndikimeve të saj në nxënës. Rendi i mirë është njësojë i rëndësishëm për të gjithë. Rregullat për sjellje janë vendosur dhe rishikuar duke pas koncensus të personelit, udhëheqjes dhe nxënësve. Nxënësit janë të njoftuar me të drejtat e tyre, por gjithashtu edhe për përgjegjësitë.</p>			



Pikë vijuese e rendit të ditës është në lidhje me mbledhjet e tejzgjatura. A ka dikush për të thënë diçka në lidhje me këtë?

Nxënësit			
Në një shkollë autoritare, disiplina është qëllim i vetvetes. Dëgjueshmëria është virtyt.			
Hapi 1. Nxënësit duhet të respektojnë rregullat dhe nuk pritet ato t'i vënë në pikëpyetje.	<i>Provoni këtë:</i> Lejoni nxënësit të shprehin mendimin e tyre. Nëse vërejtjet janë bindëse dhe anonime, mund të lejoni shmangie të vogla nga rregulla e cila qartë është joadekuate. Pastaj, rregullën e përshtatni me praktikën e re.	Nxënësit	Disiplina e nxënësit
Hapi 2. Kur reagimet e nxënësve janë bindshëm kundër ndonjë rregulle, këtë e konsideroni si një tregues se janë të nevojshme disa ndryshime të rregullave.	<i>Provoni këtë:</i> Përfshini nxënësit në politikbërje. Jepni këshillit të nxënësve një rol të rëndësishëm me rastin e vendosjes së rregullave të mirësjelljes në shkollë. Përvoja jonë tregon se nxënësit janë njohës të vërtetë se si duhet formuluar rregullat që t'i përshtaten realitetit dhe, si të tilla, lehtë të zbatueshme. Ata dëshirojnë paqe dhe qetësi, mu sikurse edhe ne.		
Hapi 3. Nxënësit janë të përfshirë jo vetëm në shqyrtimin e politikave por edhe në zbatimin e tyre në praktikë. Nxënësve më të vjetër ju ndahen role të mentorëve për ata më të rinj. Shih gjithashtu “ <i>Këshilli pedagogjik</i> ”, Hapi 3 lartë			

Konteksti joformal

Pikëpamja personale		Pikëpamja personale	Disiplina e nxënësit
<p>Hapi 1. Mendimi juaj është se fëmijëve/nxënësve nuk mund t'u besohet që dinë se çka është me vend ose çka është gabim. Ata duhet mësuar të dëgjojnë/veprojnë.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Pyeteni veten: pse interpretimi i udhëheqësit duhet gjithmonë të ketë përparësi? Thirrni nxënësit për diskutime për sjelljet dhe rregullat. Ndani/këmbeni gjithashtu mendimet tuaja me personelin.</p>		
<p>Hapi 2. Keni kuptuar se ekzistojnë edhe shkaktarë tjerë për mungesën e disiplinës, përveç karakterit të keq. Jeni edhe vetëkritik: do të mund t'i evitoni disa prej problemeve disiplinore sikur të kishit qenë më fleksibil.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Jepni nxënësve më të vjetër më shumë të drejta në disa sfera specifike, dhe vështroni se si reagojnë ata. Shprehni qartë se çfarë shkalle të marrjes së përgjegjësisë pritni prej tyre.</p> <p>Për shembull, ju do tu mundësonit nxënësve qasje të lirë në dhomën e kompjuterëve për një periudhë provuese, me kusht që ata të përdorin pajisjet me kujdes të duhur. Bëni të qartë kushtëzimin e ndërlidhur për nxënësit: sa më tepër përgjegjësi që tregoni aq më shumë të drejta do të fitoni.</p>		
<p>Hapi 3. Keni besim në nxënësit tuaj, mu ashtu sikurse që keni besim në personelin tuaj. Rregullat janë të nevojshme si sistem, por natyrisht nuk duhet përdoruar ata si argument kryesor kundruall sjelljeve të këqija. Përgjegjësia individuale është më e rëndësishme se sa dëgjueshmëria.</p> <p>Që të mund të ndjeheni individualisht përgjegjës, u nevojitet vetërespektim. Forcimi i vetë respektimit të nxënësve është një sfidë e shkëlqyer për një shkollë: pa vetërespektim ju nuk do të respektoni të tjerët. Në këtë rast administrimi përmes instruktimit është një metodë e mirë për mësime nxënësve dhe për udhëheqësit e shkollës.</p>			

Bisedat në korridor/socializimi		Bisedat në korridor/socializimi	Disiplina e nxënësit
<p>Hapi 1. Kur endeni nëpër hapësirat shkollore qëllimi juaj kryesor është të shihni se a dominon rend i mirë në shkollë. Është gjithashtu me rëndësi për ju që ndër nxënës dhe personel të rrënjosni respektin për udhëheqësin e shkollës.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Pyeteni veten: a sillen nxënësit ndryshe kur nuk ka të rritur në afërsi? Nëse po, pse ndodh kjo?</p>		
<p>Hapi 2. Të rriturit në shkollë gjithmonë ofrojnë shembuj të mirë: ata janë të përpiktë, të sjellshëm dhe mirë të përgatitur për çdo aktivitet. Natyrisht, ju pritni edhe prej tyre që të jenë të tillë.</p>	<p><i>Provoni këtë:</i> Kur vëreni sjellje të pahijshme, shfrytëzoni rastin të ndërhyni në mënyrë pozitive: tregoni interesim personal; përpiquni që të mos filloni me sjellje gjykimi. Mos u kufizoni gjithashtu në veprime vetëm me qëllim të korrigjimit të sjelljeve të papërshtatshme. Nëse keni vendosur marrëdhënie miqësore me nxënësit keni një pikë shumë të mirë fillestare për disiplinimin e nxënësve në drejtim konstruktiv dhe pozitiv.</p>		
<p>Hapi 3. Nxënësit dhe personeli bashkëveprojnë në një mënyrë relaksuese por plotë respekt, dhe nxënësit e ndiejnë se mësimdhënësit e tyre janë mbështetës dhe sinqerisht të interesuar për mbarëvajtjen dhe për zhvillimin personal të tyre. Nxënësit sillen mirë edhe kur pran tyre nuk ka të rritur që i kontrollojnë dhe vëreni shumë pak kapadaillëk dhe vandalizëm. Nxënësit dhe personeli janë të devotshëm ndaj shkollës së tyre.</p>			

Administrimi ditor		Zgjidhja e konflikteve	Zgjidhja e konflikteve	Disiplina e nxënësit
Zgjidhja e konflikteve				
Hapi 1. Përgjigjet në shumë pyetje mund t'i gjeni në dokumentet e politikave. Drejtori i shkollës është njohës i mirë i legjislacionit.	<i>Provoni këtë:</i> Pyeteni veten: pse është kjo shumë e rëndësishme për mua? Sjellja e padisiplinuar merr kohë dhe para. A ka mënyra tjera të nxitjes së sjelljes së mirë përveç rregullave?			
Hapi 2. Keni filluar duke i dhënë personelit më tepër liri për kryerjen e punëve të tyre me pavarësi me të madhe. Keni minimizuar kontrollin ditor kështu që mund të kaloni më shumë kohë në mesin e nxënësve dhe të personelit.	<i>Provoni këtë:</i> Kultivoni anët e mira të sjelljeve njerëzore në vend se të harxhoni krejt energjinë në frenimin e atyre të pahijshme. Theksoni përgjegjësinë e secilit për atmosferën në shkollë, për shembull, duke shtruar pyetje si: a kishit dashtë që një person si ju ta keni si kolegë ose si shok klase? Lehtësoni dhe inkurajoni punën ekipore ndër mësimdhënës, për shembull duke caktuar një grup të mësimdhënësve një grupi më të madh të nxënësve, në vend të mënyrës tradicionale të caktimit të një mësimdhënësi numrit të caktuar të nxënësve në një klasë. Bëhu i hapur për dëmin e shkaktuar me dhunë. Promovoni aktivisht principet dhe metodat paqësore të zgjidhjes së konflikteve.			
Hapi 3. Shkolla juaj është një vend dinamik dhe ju nuk keni gjithmonë kontroll të plotë në atë që ndodh, gjë që ngandonjëherë u shqetëson. Shumica e rasteve të mosbindjes zgjidhen para se ju të dëgjoni për atë. Shpesh mahnitëni me idetë e mira që burojnë nga personeli dhe nga nxënësit dhe ju ndiheni se jeni pjesë e ekipit. Demonstroni besim! Kur i jepni personelit pavarësi më të madhe, ju duhet gjithashtu të bëheni zemërgjerë kur ndodhin gabimet. Konfliktet ndërmjet kolegëve konsideroni si mendime divergjente, e jo domosdoshmërisht nga pikëvështrimi i të drejtës dhe të gabimit. Gjithmonë demonstroni qëndrim pozitiv ndaj sugjerimeve dhe kritikave, dhe lejoni nxënësit dhe personelin të vlerësojnë rregullisht mënyrën tuaj të drejtimit të shkollës.				

7. Pyetjet më të shpeshta për qeverisjen demokratike të shkollës

Mediet çdo ditë japin informacione për problemet në shkolla: mosbindja, vandalizmi, largimi nga mësimi dhe frikësimi i më të vegjëlve janë disa nga ato. Shumë autoritete të shkollave shtetërore janë të brengosur thellë nga statistikat në raportet e fundit të PISA-s¹⁰, ndërsa universitetet ankohen se një numër i madh i nxënësve kanë mungesa në njohuritë elementare për studime universitare. Më shumë rend dhe rregulla rigoroze, përjashtim të padisiplinuarve nga shkolla; këto dhe masa tjera represive janë përgjigje të zakonshme nga letrat e lexuesve për redaktorët, dhe nga vendimet ministrore.

Në situatë si kjo, duhet të pyetemi nëse është e qëlluar tu jepet nxënësve më shumë pushtet, kur është shumë e qartë se ata nuk ndihen përgjegjës as në raste të gjërave të thjeshta, si bërja e asaj që mësimdhënësi u thotë të bëjnë në klasë. Por, përsëri jemi të sigurt se duhet më tepër demokraci, e jo më pak. Nëse ndaj nxënësve silleni me respekt, ka gjasa më të mëdha të jeni të respektuar. Autoritetin e vërtetë duhet ta fitoni mu nga ata të cilët ju jeni caktuar t'i drejtoni; ai nuk vjen automatikisht nga pozita juaj. Por, mbi të gjithë, besojmë shumë se parakushtet kryesore janë respektimi për individin, paanësia për të gjithë dhe e drejta e fjalës. Shkolla nuk është kurrfarë përjashtimi. Jemi të bindur gjithashtu se nëse dëshirojmë që demokracia të jetë e shëndoshë në shoqërinë tonë, të rinjtë duhet të kenë rastin ta praktikojnë atë dhe t'i shohin përfitimet nga ajo gjatë viteve të kaluar në shkollë.

Duke pas parasysh problemet aktuale me shqetësimet sociale, ristrukturimin ekonomik dhe ndryshimet demografike, është e natyrshme të ndihemi të brengosur. Nëse i lirojmë frerët, çka do të ndodh në atë rast? Në këtë kapitull do të përpiqemi të përgjigjemi, ose së paku të japim komente për disa pyetje që shtrohen më shpesh në lidhje me qeverisjen demokratike.

Çka ndodh me.....

Rendin?

Demokracia e nxënësve nuk nënkupton që nuk do të ketë rregulla. Shkolla nuk është ndryshe nga pjesa tjetër e shoqërisë në këtë pikëpamje. Përvoja jonë personale tregon se, pavarësisht moshës së tyre, nxënësit kanë të njëjtin qëndrim ndaj ligjit dhe rendin sikurse të rriturit: *Rregullat janë të nevojshme!* Por është lehtë të kuptohen dhe të zbatohen ato në rast se keni qenë personalisht aktiv në krijimin e tyre. Në të vërtetë, përfshirja e nxënësve në vendosjen e rregullave të shkollës është njëra prej pikave fillestare më të lehta dhe më të sigurta në rrugën për qeverisje demokratike.

Rezultatet?

Shumë mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave janë të brengosur nëse autorizimi i nxënësve do t'i bëjë ata më pak të përqendruar në rezultate. Mësimdhënësit kanë pikëpamjen e nevojshme të përgjithshme për atë se çka duhet dhe si duhet mësuar. Po sigurisht, mësimdhënësit mund të jenë njohës në mësimdhënie, por mësimnxënia

¹⁰ *Të mësuarit për botën e nesërme (Learning for Tomorrow's World) 2003: Programi për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve (Program for International Student Assessment-PISA) i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD Programme for International Student Assessment).*

është personale dhe askush tjetër nuk di më mirë se sa vet nxënësit se cila është për ata metoda më e mirë për të mësuar. Një mënyrë e trajtimit me respekt të nxënësve është që mësimit të përqendrohet në mësimit, e jo në mësimit. Hululumet bashkëkohore pedagogjike tregojnë gjithashtu se një qasje e tillë i përmirëson të arriturat e nxënësve.

Respektimin për mësimit?

Çka do të ndodh nëse nxënësit fitojnë të drejtën të kritikojnë mësimitin? Në qoftë se nxënësve u lejohej të vlerësojnë mësimitin, çka do të thonin ata?

E vërteta është se nxënësit çmojnë të njëjtin tip të mësimitin sikurse edhe vetë mësimitin: kompetent, mirë të organizuar, miqësor dhe mësimitin të angazhuar me besim të madh të nxënësve të tyre dhe me shkathtësi të mira udhëheqjeje.

Natyrisht, ekziston rreziku që nxënësit të cilët ndihen të fyer ose të trajtuar padrejtësisht nga mësimitin të mund të shprehin mendimin e tyre në mënyrë ofenduese. Por, me shtimin e eksperiencës dhe marrëdhënieve të barabarta e respektim reciprok të mësimitin, shprehitë e tilla shkojnë drejtë zhdukjes. Sjellja e keqe është më tepër pasojë e një ndjenje të izolimit dhe të inferioritetit.

Të drejtat pa përgjegjësi?

Nëse nxënësit trajtohen si injorant dhe marrës të papërgjegjshëm të edukimit, të cilët do të duhej të jenë falënderues për atë që njerëzit e rritur ua japin atyre, nuk është lehtë që ata të kuptojnë se cilat janë kërkesat e arsyeshme ndaj mësimitin dhe ndaj shkollës. Por, nëse u japin informacione të vazhdueshme dhe kërkojmë sinqerisht mendimin e tyre të bazuar në gjykimin personal, nxënësit do të jenë më shumë të prirë të veprojnë me pjekuri. Ata do të jenë në gjendje ta kuptojnë lidhjen ndërmjet përgjegjësisë dhe të drejtave, dhe do të vlerësojnë faktin se nuk mund të kërkojnë të drejtat e tyre individuale duke paguar dikush tjetër.

Përparimin e dobët dhe mungesën e motivimit?

Përparimi i dobët mund të ketë arsye të ndryshme: formimi është një proces aventurier gjatë të cilit mund të ndodhë gjithçka. Nëse nxënësve u mundësohet më tepër ndikim në situatën e tyre në shkollë, ju s'paku do të zvogëloni disa nga problemet konsumues energjie me të cilat ballafaqohen të rinjtë. Një kurrikulë e caktuar ose një zgjedhje diktatoriale e temave nga ana e mësimitin mund ta shkatërrojë entuziazmin rinor. Nëse nxënësit i jepet më tepër mundësi për zgjedhje, të lëndëve dhe të metodave të mësimit, kjo mund të ngrit motivimin.

Nxënësit me probleme në të mësuar?

Në një shkollë demokratike, ju përpiqeni për përfshirje. Çka të bëhet me nxënësit të ngadalshëm në të mësuar? Nuk ekziston rrezik që ata të ngadalësojnë grupin e tërë? Natyrisht se edhe në një ambient të një shkolle demokratike ka një kufi të përfshirjes, por statistikat tregojnë se ky rrezik shpesh ekzagjerohet. Mund të shihni në raportin e PISA-s, të përmendur më lartë, se vendet që i ndajnë nxënësit e ngadalshëm në të

mësuar nga të tjerët në një moshë të hershme nuk tregojnë rezultate përfundimtare më të mira se sa ata ku grupmoshat mbahen së bashku përgjatë gjithë shkollimit të detyruar.

Nxënësit që bëjnë zgjedhje të gabuar?

Nëse nxënësve u japim liri më të madhe në zgjedhje, si do ti shtyjmë ata që të bëjnë zgjedhjen e drejtë? Pyetja, si e tillë, nuk është e drejtë. Ajo do të duhej të ishte: *Kush do të duhej të vendosë se çka është zgjedhje e qëlluar?* Nëse një nxënësi i lejohet së paku sado pak liri e zgjedhjes, rezultati i përgjithshëm do të ishte me gjasë më i mirë. Shkathtësitë si mendimi analitik dhe kritik mund të mësohen në shumë mënyra, jo vetëm nga librat shkollor dhe nga lënët shkollore tradicionale.

Kohën e nevojshme që merr demokracia?

Nëse nxënësit mbështeten në përfshirjen e tyre në procese demokratike, prej cilave lëndë do të merret koha e nevojshme për këtë qëllim? A do të ketë më pak kohë për mësim? Përgjigjja është, sigurish se po, sepse praktikimi i demokracisë është mu aq i rëndësishëm sa edhe çdo lëndë që mësohet në shkollë, dhe se të gjitha proceset shoqërore dhe mësimore do të përfitojnë nga kjo.

Qeverisja demokratike e shkollës në vepër

Një shembull i shkëlqyeshëm i qeverisjes demokratike është shkolla fillore *Roihuvuori Elementary School*, në Helsinki, Finlandë. Ata kanë shkuar larg në të katër fushat kryesore të EQD-së, të trajtuara në këtë doracak.

Qeverisja, udhëheqja dhe përgjegjësia publike

Puna e tërësishme në shkollë është e organizuar në ekipe vetëdrejtuese, të cilat gjithashtu kujdesen për pjesën më të rëndësishme të administrimit të shkollës. Deklarata e misionit të shkollës është e përcaktuar nga personeli, nxënësit dhe prindërit së bashku. Këshilli i nxënësve është shumë aktiv dhe ka mbështetje të fuqishme nga personeli. Në negociata me këshillin e qytetit, shkolla voton për atë se kush do ta përfaqësojë. Ka ndodhur që shkolla të përfaqësohet nga një shtatëvjeçar, i cili kishte nevojë për asistentë që ia lexonin dokumentet zyrtare!

Metoda për dhënie të përgjegjësisë në shkollat e Helsinkit është vetëvlerësimi, i cili, me raporte të shkruara, i paraqitet këshillit. Në bazë të rezultateve mësimore, shkollës i ndahen mjete financiare për vitin e ardhshëm. Shkolla fillore Roihuvuori ka qenë aq e suksesshme sa që i ka mundur të merr shumë të konsiderueshme të mjeteve që janë shfrytëzuar për trajnime gjatë punës dhe për studime ndërkombëtare për personelin.

Edukimi me përqendrim në vlera

EQD-ja promovohet në punën e tërësishme të shkollës. Vlerat, siç janë barazia dhe dinjiteti njerëzor, janë në qendër të të gjithë mësimdhënies dhe çdo klasë mbështetet që të jetë mjedis i mësimnxënies demokratike. Shkathtësitë shoqërore dhe shkathtësitë për jetesë janë të rëndësishme. Nxënësit janë të organizuar në grupe të moshave të përziera, ku janë të përfshirë nxënësit me probleme në mësimnxënie dhe nevoja speciale. Metodatat e mësimnxënies janë ndryshuar dhe përshtatur stileve të mësimnxënies së individëve.

Bashkëpunimi dhe komunikimi, konkurrenca dhe vetëvendosja e shkollës

Nxënësit më të vjetër janë sikurse vëllezërit dhe motrat më të vjetër për ata më të rinjtë. Shumë konflikte janë zgjidhur përmes ndërmjetësuesve nga radhët e nxënësve nga grupmoshat më të moshuar (11-12 vjet). Ndërmjetësuesit janë trajnuar nga Kryqi i Kuq lokal.

Të gjithë nxënësve u jepet edukim medial, qasje pa pagesë më Internet dhe në e-mail. Prindërit e vlerësojnë shkollën çdo vit.

Disiplina e nxënësve

Mendimi reflektues dhe dialogu me të tjerët është një mënyrë e nxënies për të marrë përgjegjësi dhe për të kuptuar se si reflektohen veprimet e njërit tek të tjerët.

Çdo njëri është përgjegjës për një atmosferë miqësore, siguri dhe për mbarëvajtje. Nuk tolerohen forma të dhunës, diskriminimit dhe të racizmit. Anëtarët e personelit vendosin se cilat konflikte mund të ndërmjetësohen dhe cilat do të shpijnë në ndëshkime formale.

Rezultatet e vlerësimit më të ri të shkollës

Në lëndët thelbësore, performansat e nxënësve kanë arrit nivele të njëjta si në shkollat tjera, por ata kishin shkathhtësi të shprehura shoqërore dhe mjaftë qëndrime pozitive ndaj shkollës në krahasim me mesataren e përgjithshme. Dukej se ishin më tolerant në situata konfliktuoze dhe tregonin më tepër iniciativë në punën e tyre në shkollë.



*Duke aktruar së bashku në shkollën Fillore
në Roihuvuori, Helsinki, Finlandë.*

8. Shembuj të praktikës së mirë nga gjithë Evropa

Viti 2005 është shpallur Viti Evropian i Qytetarisë përmes Edukimit nga ana e Këshillit të Evropës, dhe shtetet anëtare ishin inkurajuar t'i raportojnë Këshillit shembuj të mirë. Shumë nga shembujt në këtë kapitull janë marrë nga raportet e tilla. Roli i drejtorit në një proces të ndryshimit të vlerave dhe procedurave në një shkollë nuk duhet mbivlerësuar.

8.1 Të drejtat dhe përgjegjësitë

Mësimdhënësit shpesh frikohen se nxënësve u janë dhënë të drejta pa përgjegjësi, ndërsa nxënësit edhe ata shpesh ankohen për atë se kanë përgjegjësi të mëdha, por jo edhe të drejta. Duhet të ekzistojë një baraspeshë, përkatësisht lidhje: sa më shumë përgjegjësi që keni, aq më shumë të drejta do të fitoni. Një nxënës të pjekur dhe të pavarur mund t'i jepet liri më e madhe që të zgjedhë çka të mësojë dhe si të mësojë. Kjo ndryshon edhe rolin e mësimdhënësit.

Shumë shkolla në Norvegji tash eksperimentojnë me shkallë të ndryshme të mësimëve të vetudhëhequra. Në vazhdim është një raport nga një nxënës në vitin e fundit në një shkollë të arsimit të detyrueshëm në Norvegji:

“Javën e ardhshme fillojmë me orët studimore. Gjatë asaj kohe do të përcjellim orarin dyjavor. Është përgjegjësi e jona të planifikojmë punën. Nëse jeni efikas, detyrat tuaja të shtëpisë do të zvogëlohen në mënyrë të konsiderueshme. Gjatë kësaj periudhe kohore janë prezent shumë mësimdhënës, ashtu që mund të na ndihmojnë në të gjitha lëndët. Kemi mundësi gjithashtu që të punojmë së bashku me nxënësit tjerë, të punojmë në bibliotekë ose me kompjuterë. Në shkollën tonë viti shkollor është i ndarë në katër perioda, me orar të ri për çdo periudhë. Në mesditë kemi një kohë të gjatë të lirë, kur mund të zgjedhim nga shumë aktivitete, disa prej të cilave të organizuara nga nxënësit, p.sh., sportet ose kafeteria e menaxhuar nga nxënësit. Kjo i afron nxënësit dhe krijon një atmosferë të mirë në shkollë”.

Nga një nxënës i klasës së 9-të në shkollën Taerudden, Norvegji

Në çfarë moshe nxënësit janë të gatshëm të mësojnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre qytetare? Përgjigjja është, natyrisht, se ata nuk janë kurrë shumë të ri, jo madje as për t'iu qasur vlerave të tilla nga pikëvështrimi teorik. Në shkollën fillore ASBL Philomène në Bruksel, shfrytëzohen filozofinë si mjet për të përmirësuar njohuritë e fëmijëve për çështjet e këtilla:

Qëllimi është të nxitet mendimi i pavarur, kritik dhe reflektimi analitik përmes diskutimeve filozofike ndër grupe të nxënësve të moshës 6 deri 11 vjeç, me përqendrim të veçantë në fëmijët e braktisur. Grupet takohen një ose dy herë në muaj.

Puna e parë që bëjnë udhëheqësit e grupit është që të ngritin çështje ndër fëmijë për qëndrimet dhe prejudikimet, por edhe për rregullat dhe normat që i rrethojnë dhe që i respektojnë ata, shpesh pa kontestuar legjitimitetin e tyre. Fëmijët gjithashtu praktikojnë qytetarin aktive në mënyrë konkrete, në situatat e përditshme.

Vlerat që u jepet përparësi në diskutimet filozofike janë respektimi reciprok, përgjegjësia, përfshirja, vetëdija dhe mendimi kritik. Originaliteti i këtij

projekti qëndron në qasjen filozofike, e cila nuk është as dogmatik as pretendues. Të menduarit për vetveten nuk do të thotë që ju të përsëritni se çka ka thënë dikush tjetër, sado mirë që mund të jetë, por që vërtetë të përvetësohet një ide dhe t'i jepet asaj përmbajtje që është kuptimplotë për ju. Një risi tjetër kualitative e kësaj qasjeje ka të bëjë me bazat e mendimit filozofik: Nuk vihet në pyetje nëse idenë ose konceptin që analizoni është e mirë ose e keqe, dhe madje as për vetë analizën kritike, për kapacitetin e saj për të përmirësuar shkathhtësinë e të menduarit të fëmijëve dhe aftësive të tyre të arsyetoj argumentimin ku bazohen qëndrimet dhe vlerat e tyre.

Drejtori i shkollës, natyrisht se e ka më lehtë të tërheq vëmendjen për vlerat demokratike nëse ka mbështetje nga autoritetet kombëtare. Ambicia për të forcuar vlerat demokratike duket se është e fuqishme dhe konsiderohet thelbësore në kurrikula për shumë nga shtetet anëtare, dhe jo më pak në shtetet më të reja. Në Azerbajxhan, për shembull, pas një serie konferencash dhe seminaresh për EQD-në, silabusi/planin dhe programin për lëndën e shkollës së mesme të lartë “Njeriu dhe shoqëria” (civics) është ndryshuar krejtësisht. Temat e reja që nuk ishin prezente përpara (duke përfshirë tolerancën, pjesëmarrja në shkollën demokratike, qytetaria demokratike), tash janë përfshirë. Një projekt i ngjashëm, i dedikuar për të rritur, dhe në të cilin janë involvuar një numër i madh i organizatave qeveritare dhe joqeveritare, është duke vazhduar në Gjeorgji.

8.2 Pjesëmarrja aktive



Nxënësit më të vjetër duke mësuar nxënësit e rinj në gjimnazin Tullinge, Suedi.

Shkolla fillore Filip Filipoviç në Beograd, Serbi, ka zhvilluar një strategji për përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në zhvillimin e shkollës. Në vitin 2004, ata filluan një projekt me emrin “Planifikimi i përparimit të shkollës”, të udhëhequr nga një ekip i zhvillimit të shkollës të përbërë nga drejtori, një mësues dhe dy konsulent të jashtëm.

“Në mënyrë që të theksojmë dëshirën tonë për të përfshirë tërë komunitetin në procesin e përmirësimit të punës në shkollën tonë, zgjodhëm moton *na jemi nga fqinjësia juaj*. Seminari i parë për të gjithë të involvuarit është mbajtur në prill të vitit 2004. Detyra ishte përpilimi i parimeve të planit për përparimin e shkollës.

Pas kësaj në qershor kemi organizuar takime pune për grupe të ndara të interesit me qëllim të krijimit të një vizion për zhvillimin e shkollës tonë në një perspektivë pesë vjeçare në lidhje me ndryshimet në mësimdhënie, komunikimin dhe ambient, administrimin, organizimin dhe infrastrukturë, aktivitete jashtëmësimore dhe ngritje profesionale të mësimdhënësve.

Përgjigjja më e dobët ishte nga bashkësia lokale, por takimet e punës në përgjithësi ishin konstruktive. Prindërit dhe nxënësit ishin të përfshirë nëpërmjet të mësimdhënësve dhe organizatave të prindërve, respektivisht. Në korridorin e shkollës janë ekspozuar 300 rezultate nga takimet e tilla të punës. Duke u bazuar në rezultatet e tilla planit tonë i është dhënë forma përfundimtare nga ekipi i zhvillimit të shkollës”.

Statistikat tregojnë se rezultatet e shkollës janë përmirësuar në çdo aspekt. Për shembull, përfshirja e shoqërisë civile ka ndihmuar për të plotësuar nevojat financiare përmes sponsorimit dhe me anë të trusnisë së fortë të palëve të interesuara në politikanët lokal.

Mënyrë e mirë për të nisur në rrugëtimin drejtë qytetarisë aktive shpesh është një problem konkret, për shembull një situatë e rrezikshme trafiku diku pranë shkollës:

Nga mesi i problemeve të shumta që lidhen me sigurinë, nxënësit e shkollës Jovan Jovanović Zmaj nga Vranja, Serbi, kanë zgjedhur problemin e rrezikimit të fëmijëve në trafik. Ata u pajtuan se masë më e mirë e mundshme për zgjidhjen e këtij problemi ishte vendosja e semaforëve afër shkollës. Me qëllim të gjetjes së mbështetjes dhe ndihmës adekuate, ata organizuan mbledhje me përfaqësuesit e policisë së trafikut, Drejtorinë ndërtimore dhe organizatën UNDP, si financues i mundshëm. Me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik në lidhje me problemin nxënësit iu drejtuan medieve dhe bënë paraqitje në një stacion televiziv lokal, së bashku me përfaqësuesit e policisë së trafikut dhe të drejtorisë ndërtimore. Aksioni i nxënësve rezultoi me semaforë në afërsi të të gjitha shkollave dhe të kopshteve të fëmijëve në Vrajë.

Leksion i rëndësishëm që kanë mësuar nxënësit e shkollës Jovan Jovanović Zmaj është se mendimi i tyre është i rëndësishëm dhe është marrë parasysh.

Ngandonjëherë, edhe pse jo shpesh, iniciativa për pjesëmarrje vjen nga pjesë tjera të shoqërisë. Një rast i tillë ka qenë në qarkun e Zarës, Kroaci, ku forcat policore dëshironin të ndryshonin qëndrimet e të rinjve ndaj policëve dhe ftuan shkollat t'i bashkohen projektit, me qëllim që të ndryshojë perceptimi ndaj policisë si përfaqësues të forcës represive në një shërbim të mbështetur në komunitet, që vepron në shoqëri civile, ndihmon në ndërtimin e një mjedisi më të sigurt, ku respektohen vlerat demokratike dhe të drejtat e qytetarëve.

Projekti ishte i mbështetur fuqishëm nga Ministria e Edukimit e Kroacisë, Akademia Policore e Zagrebit dhe OJQ-të e ndryshme, por në fillim nuk kishte ose kishte shumë pak reagim nga drejtorët e shkollave. Por, në fund, 8, nga 14 shkolla, e pranuan thirrjen. Rezultati i projektit ishte jo vetëm raporti më i mirë ndërmjet forcave të policisë lokale dhe nxënësve, por kishte edhe disa efekte pozitive anësore. Mësimdhënësit dhe policët për vetveten kuptuan se “përfytyrimet në lidhje me të rinjtë ishin shumë të ndryshme ashtu si edhe gatishmëria të dëgjojmë si mendonin dhe vendosnin të rinjtë. Të gjithë ne duhet të bëhemi më të mirë në ndërtimin e besimit reciprok, zhvillimin e shkathtësive të mësimdhënies dhe mësimnxënies sipas metodologjisë së re, duke i bërë të dy profesionet të trajnuar dhe kompetent në metodat e punës interaktive dhe përfshirëse me të rinjtë.”

(Maja Uzelac, një prej udhëheqësve të projektit)

Vlerësimi i projektit njëvjeçar tregon gjithashtu një ndërgjegjësim më të mirë për problemet në shoqëri, marrëdhënie më të mira ndër kolegë, nxënës dhe të tjerë, më shumë besim, qasje më të relaksuar dhe kuptim më të mirë të problemeve të rinisë, një mjedis miqësor për mësimnxënie me nxënës më të interesuar në mësimnxënie, dhe mësimdhënie më efektive.

Dy shembujt e përmendur më lartë tregojnë qartë rolin vendimtar në të gjitha llojet e zhvillimit të shkollës. Pa marrë parasysh se prej nga vjen iniciativa, pa përkushtimin me gjithë zemër të drejtorit të shkollës, përmirësimi afatgjatë do të ishte shumë i vogël.

8.3 Çmuarja e diversitetit



Nxënësit në gjimnazin Tullinge, Suedi

Dy shembuj nga Portugalia për çmuarjen e diversitetit:

Projekti MUS-E në Évora është pjesë e rrjetit ndërkombëtar MUS-E – artistët në programin shkollor, të themeluar para një dekade nga Maestro Yehudi Menuhin. MUS-E Évora i ka përqendruar aktivitetet e tij në shkollën fillore Cruz da Picada, duke punuar në integrimin e minoriteteve etnike në shoqëri përmes praktikimit të artit në shkollë, duke luftuar kundër përjashtimit social dhe kulturor.

Metoda e cila është shfrytëzuar në një proces të *trajnitimit në veprim* të artistëve MUS-E ka konsistuar në punën me fëmijë dhe mësimdhënës nga një perspektivë interdisiplinare, në radhë të parë përmes dramave, vallëzimit dhe arteve vizuale.

Në vitin e fundit akademik (2004-05), puna e tillë intensive ka rezultuar me “Feira do Imaginario (Panairi i shëmbëlltyrave të përkryera) i cili u mbajt në hapësira të ndryshme publike nëpër qytet. Panairi i këtillë *i gjërave të kësaj bote* ishte sajuar dhe vënë në jetë nga fëmijët dhe artistët, me ndihmën e grupit teatral PIM-Teatro dhe EPRE-a (Qendra për Arres Évora), si dhe nxënësit dhe familjet. Në panairin e tillë të pazakontë keni mundur të gjeni gati gjithçka që shitej: ilaçe/pije të pashpjegueshme, kapela fluturuese dhe libra me zë. Aty mund të takonit muzikant, zhongler, akrobat dhe kolos. Në hapësirën me shumë minoritete etnike dhe fëmijë të braktisur, sajusat përrallore, dhe imagjinata janë fusha ku gjithkush mund të merr pjesë në baza të barabarta.

Karakteri interdisiplinar dhe artistik i projektit krijoi rrjete të reja në komunitetin lokal, dhe partneritet me agjentët dhe institucionet kulturore dhe sociale lokale.

“*Pegadas de Todas as Cores – Gjurmët e të gjitha ngjyrave*“ është një projekt i dizajnuar nga Shërbimi Jezuit për Refugjatë (*Jesuit Refugee Service – JRS*), një

organizatë joqeveritare ndërkombëtare misioni i të cilës është që të shoqërojë, shërbej dhe mbrojë refugjatët dhe personat e zhvendosur gjithandej nëpër botë. Në Portugali, *JRS-ja* ka siguruar një numër të shërbimeve për refugjatët dhe migrantët ekonomik.

“Në vazhden e punës tonë me emigrant, kemi konstatuar se do të ishte shumë e dobishme që të ndajmë përvojën tonë me të rinjtë në shkollë. Kështu filloi puna në projektin Gjurmet e të gjitha ngjyrave, të financuar nga Komisariati i Lartë Portugez për Imigrim dhe Minoritete Etnike (*ACIME*). Organizojmë një deri në një orë e gjysmë seanca për grupe të vogla (30 deri 40 nxënës, mësimdhënësit e tyre dhe pjesën tjetër të personelin për të diskutuar në lidhje me temën për “Migrimet”. Kryesisht vizitojmë shkollat që i ndjekin nxënës të moshës 5 deri në 9 vjet, por, herë pas here, gjithashtu edhe shkollat e mesme (nxënës në moshë 10-12 vjet), në distriktin e Lisbonit dhe Setúbal-it.

Projekti u adresohet problemeve të migrimit, shoqërive multikulturore dhe problemit të përfshirjes, që të gjithë të lidhur me fushën e EQD-në. Qëllimi i projektit është të rris vëditjen për çështjet e tilla dhe të nxis qëndrimin e hapur, respektin dhe solidaritetin ndaj punëtorëve migrant. Çështjet trajtohen nga perspektiva politike dhe ajo personale – për shembull, ndikimi i imigracionit në Portugali diskutohet jo vetëm në nivel të politikave qeveritare dhe zhvillimeve makrosociale, por gjithashtu në nivel personal dhe familjar. E drejta e zgjedhjes për qasje metodologjike, e cila përfshin stori të jetësore dhe dëshmitë personale, është vendimtare në motivimin e nxënësve dhe në joshjen e tyre më afër realitetit të migracioneve. Nxënësit janë më shumë të interesuar për përmbajtjen e informacioneve nga sesionet, nëse parandiejnë se këto përmbajtje mund të ndërlidhen me përvojën aktuale të të qenit migrant.”

Raport i Rita Raimundo, *JRS* Lisbonë

Një problem në rritje i shoqërisë tonë multikulturore është një lloj i racizmit të çdoditshëm ose i diskriminimit, që e vërejmë të gjithë shpesh në autobus, supermarket, vende publike dhe në klasë.

Organizata austriake *ZARA* ka zhvilluar një program për trajnim praktik për “kurajën qytetare” (*Zivilcourage në gjermanisht*) që bazohet në besimin e palëkundur se ne të gjithë mundemi dhe duhet të marrim veprime kundër kësaj forme të diskriminimit, duke intervenuar kurdo që e hasim atë. Kjo është mënyra e vetme për ndryshimin e qëndrimit në shoqëri.

ZARA (Zivilcourageworkshops an Schulen) ka zhvilluar një koncept të takimeve të punës për të ndihmuar kalimin nga ajo që dëshirojmë të bëjmë diçka, në atë që vërtetë ta bëjmë atë. *ZARA* ka punuar pesë vjet me nxënës. Metoda e saj ka tri hapa:

1. Diskutime grupore për identifikimin e diskriminimit, të bazuara në përvojat e vet nxënësve.
2. Luajtje roli për intuitë, ndjeshmëri dhe kurajë më të mirë.
3. Zhvillim të strategjive: Çka do të bëja kur të shoh se dikush trajtohet keq në autobus? Çka mund të ndodh nëse unë tentojmë të veprojmë si hero? Çka nëse edhe udhëtarët tjerë janë gjithashtu racistë?

Përmes këtij programi shumë nxënës kanë fituar kurajë të ndërmarrin hapa të vogël por të rëndësishëm në drejtim të duhur. Nuk ka të bëjë aq në bërjen e asaj që është plotësisht më e mira në një situatë të pakëndshme publike por thjeshtë të bëhet diçka, si një akt solidariteti.¹¹

¹¹ Për më shumë informacione për këtë dhe për shembuj tjerë të praktikës së mirë, shih publikimin Nr. DGIV/EDU/CAHCIT (2006) 18, Komisioni Ad hoc i Ekspertëve për Vitin Evropian të Qytetarisë përmes Edukimit (Ad hoc Committee of Experts for the European Year of Citizenship Through Education - CAHCIT).

8.4 Mësimdhënia e demokracisë dhe qytetaria aktive

Në rastin e numrit më të madh të shembujve të praktikës së mirë, kemi gjetur veçori të përbashkëta në zgjedhjen e metodave të mësimdhënies, të gjitha të përqendruara më tepër në mësimnxënie se sa në mësimdhënie:

- **Luajtje roli:** nxënësit zgjedhin ose u ndahen role në skenarët si ai për krijimin e një shoqërie të përkryer, simulimin e parlamentit ose të ndonjë dileme etnike.
- **Pyetje të hapura:** Çka është së miri për ardhmërinë e qytetit tonë? Eksploatimi i resurseve natyrore apo mbrojtja e mjedisit? Ndërtimi i autostradës ose ruajtje e rezervateve të zogjve?
- **Nxënie e bazuar në probleme aktuale:** Si mund të bëhet rruga deri në shkollë më e sigurt? Pse është vrarë Benjamini dhe çka duhet bërë që të pengojmë që diçka e tillë të mos përsëritet? (Nga një shembull i dhunës raciste në Norvegji).
- **Bashkëpunimi me botën/sferën e jashtme:** OJQ-të, sponsorë, ndërmarrje lokale, ekspertë dhe media. Bashkëpunimi mund të jetë i dyanshëm. Nxënësit mund tu ndihmojnë autoriteteve lokale ose ndërmarrjeve të vogla me shqyrtime/analiza, matje të aciditetit në liqe ose dizajnimin e ueb faqeve ose broshurave për organizatat e vogla lokale.
- **Të qenët i hapur:** organizimi i ekspozitave, shfaqjeve dhe panaiereve, marrja pjesë në gara, thirrja e medie në shkolla.

Mësimdhënia e kësaj mënyre kërkon kurajë, pasi që përfundimi nuk dihet. Mund të ndodh ngandonjëherë që luajtja e rolit të përfundojë në një kaos të lehtë ose në diçka plotësisht jorealiste; ose që nxënësit të përfundojnë madje edhe duke pasur më tepër pyetje të pa përgjigje se sa ata kishin në fillim; ose që autoritet lokal nuk do ta marrin sugjerimin e nxënësve seriozisht.

Një mënyrë e forcimit të kurajës së mësimdhënësit është që atyre tu sigurohet disa arsyetime solide teorike për testimin e metodave të reja të mësimdhënies. Në një projekt evropian Comenius, që ka involvuar disa shtete, filozofi danez Finn Thorbjörn Hansen nga Universiteti Pedagogjik Danez i Kopenhagës ka zhvilluar një model të planifikimit për mësimdhënie të qytetarisë aktive. Projekti ACTIVE është një shembull i shkëlqyeshëm për atë se çka mund të arrihet në këtë fushë:

ACTIVE – Active Citizenship through Interpersonal Value-related Education (Qytetaria Aktive përmes Edukimit Ndërpersonal që ka të bëjë me Vlera)¹²

Prejardhja

Konteksti i ri evropian ka shkaktuar gjithashtu sfida të reja si: demokracinë si një sistem i përbashkët i qeverisjes për të gjithë evropianët; qytetarinë evropiane; probleme që lidhen me kohezionin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve; tregun e përbashkët; teknologjinë e informacioni; mobilitetin e të rinjve; dhe shoqërinë mësimnxënëse (*learning society*). Mu për këtë, do të ketë nevojë për qytetarë që janë përgjegjës për zhvillim ekonomik, social dhe kulturor të gjithë Evropës. Akoma ka

¹² Për më shumë informacione shih katalogun Comenius: “*Teach ACTIVE – Learn ACTIVE*” numri i referimit DK-2007-001.

nevojë të përgatiten të rinjtë për pjesëmarrje të përgjegjshme në shoqëri në nivel lokal, regional, shtetëror, evropian dhe global. Përveç kësaj, konteksti i ri evropian krijon edhe probleme të reja të identitetit.

Nocioni i qytetarisë nënkupton identitetin kulturor. Prandaj, që njerëzit të fillojnë të mendojnë për veten si qytetarë, është e nevojshme që të vetëdijesohen për atë se kush janë dhe cilit komuniteti i takojnë. Brenda Evropës ka një llojllojshmëri të madhe të mënyrave të punës së mësimdhënësve. Ekziston mundësia të ndahet/këmbehen përvojat e mësimdhënësve dhe të përcaktohen nevojat edukative me qëllim të krijimit të një qasje të përbashkët të edukimit të qytetarisë.

Metodologjia, veglat dhe teknologjia në shfrytëzim ose që duhet shfrytëzuar

Një prej mënyrave të gjetjes së përgjigjes në pyetje të këtilla për partnerët e projektit ACTIVE ka qenë të zhvillojnë një sistem për kursin e trajnimit të mësimdhënësve në të gjitha shtetet. Sistemi i tillë është ilustruar me një trekëndësh, i cili përbëhet prej tri këndeve ose tri qasjeve të qytetarisë aktive:

- 1) *Pedagogjiko-profesional* (përmbajtja)
- 2) *politiko-demokratik* (proces/forma)
- 3) *etiko-ekzistencial* (qëndrimi/vlerat)



Silabusi/plan dhe programi

Qasja e fundit është e rëndësishme për projektin ACTIVE, ka të bëjë në mënyrë eksplicite me rëndësinë e “vlerave të jetës” për motivimin e të rinjve për qytetari aktive, dhe nuk duhet ngatërruar me “vlerat demokratike dhe virtytet politike ose me aftësitë e mira profesionale në “kurrikulat e lëndëve të ndryshme”. Qasja e tretë është vështruar së një risi në të menduarit e Edukimit për Qytetari Aktive, e cila, me sa dimë ne, nuk është përdorur përpara.

Modeli i planifikimit

Si mund të jep mësim për qytetari aktive mësimdhënësi i vetëm duke qenë prezentë në klasë? Kjo ishte një prej pyetjeve të shtrura gjatë projektit. Si përgjigje për këtë, ACTIVA ka krijuar modelin e planifikimit për mësimdhënësin, të dhënë në vazhdim. Me shfrytëzimin e këtij modeli mësimdhënësi do të jetë në gjendje të sfidojë nxënësit që të shfrytëzojnë resurset për mësinxënie jashtë klasës dhe të jetë nxënës aktiv.

	<i>Në klasë</i>	<i>Jashtë klasës</i>
1. dimensiononi pedagogjik		
2. dimensiononi social		
3. dimensiononi politik		
4. dimensiononi i vlerave/etik		

(Përpiluar nga Finn Thorbjörn Hansen, DPU, në kuadër të projektit ACTIVE)

8.5 Nxënësit e involvuar në vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies

School Councils UK (Këshilli i shkollës) drejton projektin e financuar nga Deutsche Bank me titull *London Secondary Schools Citizenship and Research Project (LSSCARP)* (Projekti për qytetari dhe hulumtime të shkollave të mesme të Londrës) i cili synon që nxënësit të përfshihen aktivisht si studiues në klasë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Mësimdhënësit negociojnë me nxënësin e tyre vrojtues (i cili normalisht nuk është anëtar i asaj klase) cilat aspekte të mësimin do të monitorohen. Kjo mund të përfshijë planifikimin e lëvizjes së mësimdhënësit nëpër klasë; sa kohë ai u kushton djemve në klasë më tepër se sa vajzave; sa komente negative bën ai në krahasim me ato pozitive. Nxënësi mund të monitorojë, madje edhe një anëtar të klasës, sjelljet e të cilit janë problematike, dhe të vlerësojë sa kohë gjatë mësimin nxënësi i tillë është i përqendruar. Vlerësimet e fillimit të projektit LSSCARP tregojnë se vëzhgimi i nxënësit ka bërë një kontribut të madh në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat e këtilla.

8.6 Përfundimisht

... si drejtor i shkollës, ju duhet të jeni shumë të qartë: qeverisja demokratike nuk nënkupton që ju të hiqni dorë nga udhëheqja. Përkundrazi, në këtë proces të ndryshimeve ju duhet:

- të ushtroni udhëheqje të vendosur. Jo në kuptim të autoritetit, por në kuptim të mbështetjes së qëllimit për tu përmbajtur vlerave tuaja demokratike edhe kur mendoni se është vështirë. Vendosmëria dhe përlësia te një udhëheqës kërkojnë forcë më të madhe të karakterit se sa ushtrim të autoritetit ose pushtetit;
- t'u jepni mbështetje mësimdhënësve tuaj, jo vetëm me fjalë, por edhe me veprime. Tregoni interesim, jini prezent, merrni pjesë aktive në punë kurdo që mundeni;
- t'u siguroni mësimdhënësve trajnim të mirë teorik dhe praktik gjatë punës. Mësimdhënësve u nevojitet orientim në zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik të shoqërisë tonë, në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Atyre gjithashtu u nevojitet praktikë pa frikë nga dështimi;
- të shfrytëzoni çdo rast që t'u sqaroni prindërve dhe palëve të interesuara lokale pse i përdorni metodat e reja. Gjithashtu kujdesuni që rezultatet e mira, kur filloni t'i mbërrini ato, tu bëhen të njohura të gjitha palëve të interesuara (që normalisht do të thotë shoqërisë në tërësi – praktikisht secili ka një mendim në lidhje me shkollat, mësimdhënien dhe për qeverisjen e shkollës);
- të kujdeseni për trajnimin tuaj gjatë punës. Pse të mos siguroni një minimum prej tri orësh në javë për ngritje profesionale personale? Jo aq në shkathtësitë e administrimit, sa në studimin sistematik të botës përreth, siç e vështrojnë në media, në analizat e fundit dhe në jetën politike dhe kulturore rreth jush. Të

menduarit merr kohë, dhe ju si drejtor duhet të siguroni kohë për të menduar paraprakisht;

- të dëshmoni se keni të drejtë! Besimi juaj i vendosur e as elokuenca juaj nuk janë të mjaftueshëm që t'i bindni palët e interesuara. Vlerësoje sistematikisht progresin e shkollës tuaj, mblihd të dhëna statistikore dhe dëshmi tjera dhe ji i sinqertë. Mos u frikësoni të raportoni për pengesat. Siç kemi thënë përpara, rruga drejtë një qeverisjeje të vërtetë demokratike mund të jetë me pengesa, por kjo është mënyra e vetme për të udhëtuar!

“Sa i takon udhëheqësve më të mirë, njerëzit kurrë nuk do ta vërenin ekzistencën e tyre.

- Të ardhshmit (pas më të mirëve) njerëzit i vlerësojnë.
- Të ardhshmëve (pas atyre paraprak) njerëzit u frikësohen.
- Të fundit njerëzit i urrejnë.
- Kur puna e udhëheqësit më të mirë është kryer, njerëzit thonë, “Na vet e bëmë atë.”

Lao Tse

9. Qeverisja demokratike: modelet dhe karakteristikat e përbashkëta

Në kapitujt paraprak kemi kaluar nëpër një mori problemesh dhe shqetësimesh, ndërsa në këtë të fundit, me shpresë dhe optimizëm, do të vështrojë perspektivën e ndritur të demokracisë! Karakteristikat e përshkruara në këtë kapitull janë tregues të praktikës demokratike në kuadër të qeverisjes në shkollë. Por ato janë më tepër se aq. Aty ku janë prezentë ato nuk janë vetëm simptome. Në të njëjtën kohë prezenca e tyre ndihmon që të përhapim më tutje proceset demokratike që janë në funksion: demokracia në të vërtetë e ushqen vetveten, por ajo ushqehet edhe nga rezultatet që vetë i gjeneron. Prandaj, sa më tepër që ju besojmë mësimdhënësve të marrin vendime përkatëse dhe të drejta, aq më tepër ata do të veprojnë ashtu: kështu që aq më tepër do të mund t'u besohet. Natyrisht, njësoj ndodh me nxënësit, por edhe me të gjithë pjesëmarrësit të cilët punojnë së bashku në ndërveprime të ndryshme dhe në të gjitha llojet e ambienteve, qofshin ato formale apo joformale.

Pasi që të lexoni këtë kapitull ju ndoshta do të dëshironi të ktheheni në kapitullin 6, i cili përshkruan se si mund t'i bëni hapat për të ecur përpara përgjatë rrugës demokratike. Modelet dhe veçoritë e përbashkëta që shqyrtohen këtu mund të konsiderohen si momente të rëndësishme ose si udhërrëfyes në rrugën e tillë – vetëm se me demokraci, nëse ndonjë udhërrëfyes mungon, ju mund të sajoni dhe vendosni tuajin, kështu që edhe ky do të ju ndihmojë të vazhdoni rrugën më tutje! Për shembull, nëse demokracia promovohet në shkollë, aty shumë shpejtë do të shtrohet kërkesa që nxënësit tu jepet e drejta për të marrë pjesë në vendosje përmes ndonjë forme të këshillit të nxënësve ose parlamentit të shkollës (shih më poshtë). Por nuk duhet të pritni që kjo të ndodhë: ju mund të themeloni vetë (ose, edhe më mirë, t'i inkurajoni nxënësit që ta bëjnë këtë). Kjo nuk do të shkojë edhe aq lehtë në fillim, por në këtë mënyrë do t'u tregohet nxënësve se ata respektohen dhe u besohet. Me praktikim dhe përvojë, me kalimin e kohës, kjo do të zhvillohet dhe përmirësohet: duke u mësuar të shfrytëzojnë efektivisht tërë kohën këshillin e këtillë, nxënësit do të zhvillojnë shkathësitë demokratike, të cilat sipas rregullit gjenerojnë zhvillime tjera demokratike dhe do tu ndihmojnë atyre që të arrijnë sukses.

Kështu demokracia rritet – eksponencialisht. Një zhvillim bëhet shkas për një tjetër, i cili sipas rregullit krijon një tjetër. Prandaj, për të ndërtuar demokracinë, nuk është e thënë që ndryshimet të bëhen sipas një rendi. Duhet vetëm të shfrytëzoni mundësitë aty ku i hasni për t'i përhapur ndryshimet e tilla.

Zgjedhje formale/strukturale

Decentralizimi i pushtetit në shkollë

Në formën më të mirë të qeverisjes, qeveria e shtetit ose e regjionit do të duhej të merr vetëm vendime të përgjithshme strategjike, duke ia lënë shkollave veç e veç të vendosin mënyrën më të mirë për ta për implementimin e strategjisë nacionale. Në Evropë, në fillim të shekullit 21 duket se politikanët flasin shumë për decentralizimin, por rrallë e përdorin atë. Shkollave iu është lënë që të merren – të shpresojmë në

mënyrë demokratike (shih më poshtë) - me një numër të madh të ligjeve dhe rregulloreve që dalin nga ligjet e tilla.

Metodat e qeverisjes janë të orientuara nga objektet (qëllimet, jo rregullat ose udhëzimet).

Në shkollë e cila vepron në mënyrë demokratike, vendimet merren për hir të nxënësve dhe palëve tjera të interesuara: qëllimi është që të sigurohet se institucioni është më i miri që mund të jetë për ata për të cilët ekziston. Mënyra se si qeveriset ai e reflekton këtë, ndërsa strukturat vendimmarrëse janë të përcaktuara për ta arritur këtë, e jo për të mbrojtur pushtetin ose pozitën personale të drejtorit (ose të dikujt tjetër), e as të ndjekin rregullat ose instruksionet e autoriteteve më të larta. Në të vërtetë, nëse autoritetet e tilla më të larta duket se janë kundër interesave më të mira të shkollës (për shembull, duke e lënë pa resurse në kohën e zvogëlimeve të fondeve), duhet ndryshuar metodat e qeverisjes, më qëllim të zbutjes së efekteve dhe kufizimit të dëmeve të shkaktuara në këtë rast.

Autorizimi i mësimdhënësit përmes këshillave formale ose grupeve të interesit

Përfshirja e mësimdhënësve në vendimmarrje nuk duhet të realizohet gjithmonë përmes mbledhjeve formale, dhe vendimet nuk duhet miratuar përmes votimit. Në një shkollë, ku pjesëmarrësit përpiqen të jenë të përkushtuar në parimet dhe qëllimet e përbashkëta, koncenzusi shpesh arrihet thjeshtë përmes diskutimit të lirë. Mësimdhënësit nuk duhet të ftohen në mbledhje të shumta me qëllim të përhapjes së demokracisë: përkundrazi, një shtim i mbledhjeve mund të jetë demoralizues dhe kundërproduktiv. Shpesh mund të formohet një grup pune për t'u takuar aq sa është e nevojshme për të vendosur për një politikë të shkollës, dhe pas kësaj grupi i tillë shpërndahet. Anëtarët e tij mund të vetëprovozohen: ata që kanë ndonjë interes në rezultatet e punës së komisionit ka gjasa të marrin pjesë vullnetarisht, ndonëse mund të jeni të detyruar që, si i drejtor, të siguronit një balancim të opinionëve brenda grupit dhe të zbatoni praktikën e mira: me fjalë tjera, të përfaqësohen minoritetet, ndërsa të qenët i hapur dhe barazia të jenë në qendër të vëmendjes gjatë diskutimit. Qeveritë e kanë zakon të formojnë grupe të punës për të rekomanduar ndonjë politikë shtetërore, por pastaj nuk pajtohen me rezultatet, dhe e injorojnë politikën e tillë. Nuk do të ishte e mençur që një drejtor i shkollës të veprojë në të njëjtën mënyrë!

Autorizimi i nxënësve përmes këshillave formale ose grupeve të interesit

Është vështirë të mendohet një shkollë demokratike pa qenë në qendër të demokracisë ndonjë formë e këshillit formal ose parlamentit të nxënësve. Trupi i tillë duhet të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe transparente nëse dëshironi që tek nxënësit të ketë kredibilitet (ka në dispozicion shumë informacione se si duhet formuar trupi i tillë: shih listën e burimeve). Ka edhe raste të tjera për të përfshirë nxënësit në politikë dhe në vendimmarrje, dhe jo vetëm thjeshtë në aktivitete të planifikuara të nxënësve (siç janë festimet dhe festivalet), por edhe në pyetjet e rëndësishme për edukimin e tyre: në këshillat që merren me çështjen e ushqimit, disiplinës, me zgjedhjet akademike. Ata gjithashtu mund të përfshihen në aktivitete të rëndësishme që në të kaluarin janë konsideruar se janë të dedikuara për mësimdhënësit, por tash pas përfshirjes së nxënësve, është konstatuar se ka përmirësim të konsiderueshëm në pranimin dhe emërimin e mësimdhënësve, madje edhe në vëzhgimin e mësimdhënies dhe përhapjen e praktikës së mirë.

Pjesëmarrja aktive inkurajohet dhe shpërblehet

Kur nxënësit e kthejnë me të njëjtën masë besimin që e kanë fituar, shkolla demokratike i siguron se ata do të inkurajohen dhe shpërblehen. Veçanërisht nëse ju bëni hapat e parë në atë drejtim, do të ndieni nevojën që ta propagandoni dhe ta lavdëroni atë që kanë arritur nxënësit. Kur ata kanë qenë të suksesshëm në gjëra të vogla, ju do të dëshironi (përsëri në mënyrë publike) tu besoni atyre çështje më me peshë.

Ekzistojnë shpërblime të dukshme për nxënësit që janë të përfshirë aktivisht. Në shkollat dhe vendet që kanë traditë në dhënien e autoritetit formal për nxënësit më të vjetër përmes sistemit të “prefektëve” ose të “vëzhguesve”, statusi i tillë akordohet në një formë të strukturuar. (Natyrisht, sistemet e tilla mund të jenë paksa në kundërshtim me demokracinë, duke fuqizuar disi formën tradicionale të autoritarizmit. Në të vërtetë, në Britani të Madhe, ku sistemet e prefektit janë të zakonshëm, është me gjasë një numër i vogël i shkollave që e funksionalizojnë sistemin e tillë në mënyrë demokratike). Por, shpërblimet për pjesëmarrje aktive nuk duhet të jenë pjesë e sistemit: nxënësit që prijnë në pjesëmarrje priren të bëhen mjaftë të dallueshëm dhe të fitojnë respekt të madh nga moshatarët e tyre – sepse konsiderohet se e kanë merituar këtë. Përveç kësaj, nëse ju shfrytëzoni rastin për t’u dhënë mirënjohje publike për kontributin e tyre në emër të shkollës, ata do të ndihen plotësisht të shpërblyer.

OJQ-të me dëshirë thirren në shkollë dhe aktivisht përfshihen aty

Shkolla demokratike angazhimin aktiv të organizatave të tjera e konsideron si një mundësi pozitive. Kështu organizatat e prindërve, institucionet kulturore dhe ndërmarrjet lokale ftohen në shkollë me qëllim që të kontribuojnë në edukimin e nxënësve dhe, si kundërshpërblim, të përfitojnë nga asociacioni i këtillë. Shkolla demokratike nuk ka nevojë për mbrojtje. Ajo nuk ndihet e kërcënuar nga organizatat tjera që vinë dhe përfshihen aty, dhe nuk kërkon të vendosë kufizime. Thirrja e OJQ-ve në shkollë është mënyrë e mirë e heqjes së barrierave.

Nxënësit inkurajohen të publikojnë pikëpamjet e tyre

Gazeta ose revista që përgatitet dhe shtypet nga nxënësit mund të shkarkojë një sasi të madhe të energjisë. Marrja parasysh ose inkurajimi pozitiv është mënyrë e mirë e demonstrimit të besimit tuaj tek ata, pasi që çdo kush do të vërejë se ajo kërkon njëfarë guximi! Çka do të ndodh nëse ata kritikojnë mësimdhënësit? Ose shkollën? Ose qeverinë? Ose madje (i papërfytyrueshëm!) drejtorin? Mund të jetë e nevojshme të merreni vesh për kufij – por një diskutim i tillë siguron mundësi të mëdha për të mësuar shkathtësi demokratike të negocimit dhe kompromisit, madje edhe për të zhvilluar dhe çmuar se çka do të thotë të shprehet mendimi i lirë në suaza të një shoqërie demokratike, tolerante dhe të larmishme.

Nxënësit e përfshirë në këshillim, ndërmjetësim dhe mbështetje

Pasi që këshillimi – dhe, me sa duket, nevoja për atë – bëhen gjithnjë e më tepër të zakonshëm nëpër shkollat e Evropës, të rinjtë duket se janë të etur tu nënshtrohen trajnimeve bazike me qëllim që të veprojnë si konsulent joformal, dëgjues, mbështetës dhe madje, në raste konflikti, ndërmjetësues. Të tillët që bëhen mbështetës të moshatarëve ose mentorë të tyre (termi që përgjithësisht përdoret në Britani të Madhe)

sigurisht se mësojnë po aq nga aktiviteti sa edhe shokët e tyre, të cilëve ata ju ndihmojnë. Për shkollën ky është edhe një rast për tu dhënë përgjegjësi nxënësve dhe për tu besuar atyre të sigurojnë një shërbim të rëndësishëm brenda vet komunitetit të të rinjve. Kjo mund të jetë një formë e fuqishme dhe mjaftë e avancuar e pjesëmarrjes demokratike.

Hapësirat për rekreacion shfrytëzohen nga personeli dhe nxënësit

Ky është një shembull i një çështjeje potencialisht kontestuese, përsëri diçka ku vlerësimi dhe negociimi mund të sigurojnë përvoja të çmueshme të mësimi të demokracisë. Anëtarët e personelit janë të punësuar dhe kanë të drejtë morale dhe ligjore për intervale pushimi. A duhet ata të kenë hapësira të veçanta ku do të kalonin pushimin? A është statusi i nxënësit plotësisht i ndryshëm?

Në vitin 1998, në një hulumtim që ka lidhur këshillat e shkollave dhe përmirësimin e sjelljeve në Britani të Madhe, është përfshirë një shkollë ku nuk ka pas hapësirë të veçantë për personelin në mënyrë që ata të largohen për pushim nga nxënësit: por nuk ishte e qartë nëse ky ishte një vendim si pasojë e karakterit demokratik. Përkundrazi, duket se kjo formë ndiqte një model shërbimi: Mësimdhënësit ishin aty për nxënësit, kështu që ata duhet të ishin në dispozicion gjithë kohën, pa u fshehur në hapësirën e tyre konfidenciale.

Davies, L. (1998), *Këshilli i Shkollave dhe përjashtimet e nxënësve*, Qendra për Edukim dhe Hulumtim Ndërkombëtar, Universiteti i Birmingham-it, (*School Councils and Pupil Exclusions, Centre for International Education and Research, University of Birmingham*), botuar nga Këshilli i Shkollave të Britanisë së Madhe (*School Councils UK: www.schoolcouncils.org*).

Nëse shkolla nuk është e gatshme të diskutojë për hapësira të përbashkëta, ose madje për një negociimin frytdhënës se kur janë në dispozicion mësimdhënësit për nxënës dhe kur nuk janë, ndoshta do të mund të merren në konsiderim aktivitetet e përbashkëta. Në disa shkolla mësimdhënësit dhe nxënësit shkojnë në vrapim ose shfrytëzojnë pajisjet gjimnastikore së bashku: pa marrë parasysh moshën e tyre, ata kanë interesin e përbashkët për të përmirësuar formën fizike dhe qëndrueshmërinë, kështu që pse mos ta bëjnë këtë së bashku, të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të inkurajojnë njëri-tjetrin? Situata e tillë është e liruar nga hierarkia dhe autoriteti, kështu që, si e tillë, është një mënyrë e këndshme për të përhapur frymën demokratike në shkollë.



“Faleminderit që jeni pajtuar që të shikojmë me ne tualetet...”

© Këshilli i shkollave UK

10. Përfundimi

“Demokracia nuk është synim, ajo është rrugë; ajo nuk është arritje, por një proces... Kur e kuptojmë këtë, dhe fillojmë të jetojmë demokracinë, vetëm atëherë do të kemi demokraci.”

(Mary Parker Follet (1918), *The New State*, f. 58)

Deri tash do të duhej të keni fituar një ide për rrugët e mundshme që demokracia mund t’i ndjek në shkollën tuaj, dhe do të keni njohur disa elemente të jetës në shkollë të paraqitur këtu: ato mund t’u sugjerojnë se në cilën fazë ndodhet aktualisht shkolla juaj, në kontekste të ndryshme që janë përshkruar paraprakisht. Ky doracak përshkruan vetëm disa simptome të demokracisë që mund të dallohen në shkollën tuaj. Disa karakteristika, me veprimin e tyre, zhvillojnë demokracinë në mënyrë aktive: në rastet tjera diskutimi dhe negociimi që zhvillohet në lidhje me ato do të rris pranimin dhe praktikumin e demokracisë në shkollë.

Asnjë ndryshim në shkollë nuk ndodh menjëherë: gjithçka kërkon kohë për tu rrënjësuar. Gjithmonë na duket se zgjatë shumë, dhe nuk mund të ndryshoni gjithçka menjëherë. Por ju mund të përparoni në fusha në të cilat mendoni se mund të bëni njëfarë progresi. Dhe kur shikoni mbrapa, vetëm pas një ose dy vitesh, ju mund të mahnitoni kur shihni se sa larg ka shkuar shkolla juaj. Ndryshimi demokratik priret të jenë i qëndrueshëm: ai rrënjësohet dhe rritet për sa kohë ju merreni në mënyrë konsistente me te.

Kjo është rruga e drejtë që duhet ndjekur, por mund të jetë punë e mundimshme. Procesi i analizës, i planifikimit dhe i implementimit/zbatimit duhet të përsëriten vazhdimisht. Kështu nëse i analizoni fushat themelore – tonat ose tuajat – me anë të tabelave në kapitullin katër, identifikoni vlerat dhe qëndrimet themelore (kapitulli 5) dhe pastaj planifikoni zhvillimin hap pas hapi (kapitulli 6), kjo fillon të duket e frikshme, por ju nuk duhet të humbni kurajën. Mund të mos ndiheni të aftë të vazhdoni të punoni gjatë gjithë kohës në atë proces. Mund të dëshironi të dilni jashtë procesit metodik, shihni një prej shembujve në këtë ose në kapitullin paraprak dhe provoni nëse mund ta zbatoni atë në shkollën tuaj. Një “fitore e shpejtë” në një fushë të pavarur dhe të kufizuar mund të rrisë besimin tuaj – dhe të dëshmojë se jeni serioz.

Këshilli i Evropës ka botuar material tjetër për EQD-në të cilin ju mund të lexoni për informim të mëtutjeshëm ose për krahasim. Për shembull, punë e ngjashme bëhet edhe në universitete. Për lexim të mëtutjeshëm, shih listën e burimeve.

Përhapja e demokracisë në një shkollë mund të jetë punë stresuese. Nga vetë natyra e saj demokracia i ndryshon hierarkitë dhe autoritetet e vjetra, dhe konfliktet që mund të paraqiten mund të jenë dëmtues dhe të lodhshëm. Duhet të jeni të fortë: jo të fortë (siç kemi thënë më herët) në kuptimin e të qenit jofleksibil dhe autoritar, por i fortë në kurajë, e cila nevojitet për të pranuar realitetin e mospajtimit, në mbajtje të zemërgjerësisë dhe në kërkim të koncenzusit përmes negociatave dhe kompromisit. Në qoftë se lejoni që të udhëhiqeni nga tre principet e EQD-së nuk do të merrni vendime të gabuara: nëse keni parasysh faktin se keni udhëtuar hap pas hapi përgjatë rrugës së demokracisë, e cila nuk përfundon kurrë (siç ka shkruar në vitin 1918, Mary Parker Follett), shpresojmë se do të gjeni edhe durim!

Nuk duhet të ndiheni të vetmuar. Demokracia përfshinë partneritet – prandaj punoni me partnerët tuaj dhe mbështetuni në ta kur kjo u nevojitet. Demokracia akoma zhvillohet nëpër tërë Evropën, kështu që ju jeni pjesë e një grupi të madh dhe në rritje, në të cilin do të gjeni miq dhe aleatë. Kërkoni ato, sepse si demokrat dhe demokratizues, jeni pjesë e rrjedhës së përgjithshme, e jo në periferi. Çdo hap përpara në shkollë do të përcillet me shpërblime, për ty dhe për institucionin, të cilat me siguri do të shërbejnë për inkurajim dhe nxitje në përpjekjet e mëtejshme. Përmirësimet në shkollë dhe në karakterin e saj do të jenë të prekshme. Prandaj mund të shpresoni në kënaqësi dhe në një shkallë të satisfacionit, të cilat vlejné më shumë se sa kohët sfiduese.

Vështirësitë janë të konsiderueshme, për edhe shpërblimet janë shumë të mëdha. Kauza e demokracisë është më e qëlluara! Shpresojmë se ky doracak do t'u ndihmojë në rrugëtimin e tillë, dhe ju dëshirojmë kurajë, e cila u nevojitet, dhe sukses, që të pasojë.

Paçi fat!

Shtojca I. Tabela e planifikimit

Fusha themelore e EQD-së ose fusha juaj e zgjedhur	Në cilën fazë mendoni se ndodhet shkolla juaj kundruall tre principeve të EQD-së?	Principet e EQD-së		
		Të drejtat dhe përgjegjësitë (Faza 1,2,3 ose 4.?)	Pjesëmarrja aktive (Faza 1,2,3 ose 4.?)	Vlerësimi i diversitetit (Faza 1,2,3 ose 4.?)
Nga pikëvështrimi i: udhëheqësit	(përshkruani shkurtimisht karakteristikat)	(karakteristikat)	(karakteristikat)	
Nxënësit	Faza	Faza	Faza	
	(karakteristikat)	(karakteristikat)	(karakteristikat)	
Mësimdhënësit	Faza	Faza	Faza	
	(karakteristikat)	(karakteristikat)	(karakteristikat)	
Prindërit	Faza	Faza	Faza	
	(karakteristikat)	(karakteristikat)	(karakteristikat)	
Komuniteti	Faza	Faza	Faza	
	(karakteristikat)	(karakteristikat)	(karakteristikat)	

	Të drejtat dhe përgjegjësitë	Pjesëmarrja aktive	Vlerësimi i diversitetit
Veprimet që ndërmerren për fazën e ardhshme			
Kush i ndërmerr ato?			
Matjet/treguesit e suksesit			
Kur duhet bërë kontrollin?			
Kush do ta bëjë kontrollin?			
Rezultatet e kontrollit			

Shtojca II.

Qëllimi i kësaj shtojce është që, në vija të përgjithshme, të paraqes kontekstin e librit - politikave edukative të viteve të fundit dhe punën e Këshillit të Evropës mbi Edukimin për Qytetari Demokratike (EQD).

Përdorimi i librit dhe implikimet e tij do të jenë të qarta nëse lexuesi **ka parasysh kontekstin edukativ evropian dhe gjithëbotëror**, ka ndërmend progresin e arritur në punën e Këshillit të Evropës mbi EQD-në dhe ka shpjegime për **mjetet dhe dokumentet tjera** që sigurojnë informacione shtesë mbi politikave dhe praktikave për EQD-në.

Reforma edukative: sfidë për demokraci

Gjatë disa viteve të kaluar janë kryer shumë reforma edukative në Evropë dhe gjithandej nëpër botë. Problemet sociale, të cilat aktualisht i prekin shumë shtete, siç është rritja e vazhdueshme e papunësisë, rritja e dhunës dhe pabarazisë sociale, ka nxit liderët shtetëror të sajojnë reforma për mësimdhënie të kualitetit më të lartë, përshtatje më të mirë ndërmjet trajnimit, punësimit dhe nevojave të shoqërisë, dhe edukim me përqendrim në vlera që i mëson personat të jetojnë si pjesëtarë të shoqërisë.

Në sesionin e 19 të *Konferencës së Përhershme të Ministrave Evropian të Edukimit* (Kristiansand, Norvegji, 1997), ministrat janë pajtuar për rëndësinë për “kërkimin e një baraspeshe më të mirë ndërmjet aspiratave dhe objektivave të edukimit të mesëm, statusin e barabartë ndërmjet fushave akademike dhe profesionale, mbledhjen e njohurive dhe të shkathtësive dhe për trajnimin e qytetarëve për një shoqëri demokratike”.

Politikat e reja edukative e vënë theksin në dëshirën që të arrihet efikasitet më i madh për një kosto më të vogël, dhe kombinojnë këtë analizë kosto-efikasitet me promovimin e vlerave demokratike. Politikave të tilla shqyrtojnë katër objektiva kryesore:

- Përmirësimin e shkathtësive të fituara për të përmbushur kërkesat ekonomike;
- edukimin për qytetari dhe për respektim të të drejtave të njeriut;
- zhvillimin e partneritetit edukativ për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet shkollave, familjeve dhe organizatave të ndryshme;
- shfrytëzimin e teknologjive të reja të informacionit dhe të komunikimit (NICT) në edukim.

Edukimi për qytetari dhe zhvillimi i partneritetit edukativ janë objektiva veçanërisht të rëndësishme në Evropë.

Në vitet e fundit, shtetet evropiane kanë bërë përpjekje të rimodelojnë politikave edukative rreth konceptit të diversitetit. Reforma edukative përqendrohet në **diversitetin social, kulturor, fetar dhe atë linguistik**, tash tipike për shtetet evropiane, me qëllim të përgjigjes në sfidat për sigurimin e **kohezionit shoqëror**.

Njohja e **aspektit multikulturor të shoqërisë evropiane** dhe vëmendja që i kushtohet atij në sferën e edukimit pasqyron interesimin për të ndërtuar shoqëri

demokratike, e cila respekton diversitetin duke edukuar qytetarët që nga mosha e hershme e në përputhje me rrethanat. Një prej qëllimeve të edukimit të këtillë është luftimi i problemeve që lidhen me braktisjen e shkollimit, përjashtimin nga shoqëria dhe stigmatizimin.

Në seancën e 19 të *Konferencës së Përherhshme të Ministrave Evropian të Edukimit* (të përmendur më lartë), ministrat kanë shprehur bindjen e tyre se edukimi mund t'u përgjigjet sfidave me të cilat aktualisht ndeshen/përballen shtetet evropiane, për shembull duke "riafirmuar vlerat e diversitetit kulturor si një burim i pranuar i pasurisë së përbashkët, dhe duke mësuar vlerat etike që bazohen në respektimin e të drejtave për të tjerët, tolerancën dhe solidaritetin, (dhe) luftën kundër racizmit dhe antisemitizmit".

Shikuar historikisht, **nxënësve u është kushtuar rëndësi gjithnjë më e madhe si pjesëmarrës aktiv në edukimin e tyre personal.** Në të kaluarën fëmijët janë kufizuar në një status pasiv, por tash gjithnjë e më tepër nga ata kërkohet të marrin pjesë aktive në mësimnxënie. Dëgjimi i të rinjve për aspiratat dhe emocionet e tyre në shkollë, dhe dhënia e një pjese të përgjegjësisë për procesin e mësimnxënies, janë zhvillime relativisht të reja, që tregojnë se politikat edukative janë në progres të vazhdueshëm drejtë edukimit të fëmijëve për pjesëmarrje dhe marrje të përgjegjësisë, dhe hap pas hapi drejtë qytetarisë.

Në *Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijës* (1989), të nënshkruar dhe të ratifikuar nga 191 shtete, në Nenin 29 parashihet që "edukimi i fëmijës duhet drejtuar në zhvillimin e personalitetit të fëmijës, talenteve dhe aftësive mentale dhe fizike në potencialin e tyre më të plotë." Hartimi dhe miratimi i kësaj konvente ka shënuar një hap të madh përpara për pozitën e fëmijëve në shoqëri.

Më tepër se dy dekada, roli i edukimit në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë/ligjshme dhe më demokratike e cila tregon respektim të madh për të drejtat e njeriut ka qenë në qendër të diskutimeve teorike dhe të hulumtimeve për edukimin. Ndryshimet politike dhe shoqërore në shoqërinë evropiane kanë pas një efekt të fuqishëm mbi domethënien e qytetarisë, dhe ideja e edukimit për qytetari demokratike gradualisht fiton një vend të dukshëm.

Në *Konferencën e parë joformale mbi Edukimin për Zhvillim dhe Stabilitet Demokratik në Evropën Juglindore* (Strasburg, 1999), ministrat e edukimit nga Evropa juglindore kanë deklaruar se janë "të bindur se edukimi dhe bashkëpunimi edukativ kanë një rol të rëndësishëm për zhvillimin e tolerancës, mirëkuptimit reciprok dhe ndërgjegjësimin e përbashkët brenda dhe ndërmjet shteteve anëtare në kontekstin evropian."

Ideja e **përfshirjes së familjes në procesin edukativ**, e cila në fillim është praktikuar në shkollat "alternative", ka fituar mbështetje në reformat e edukimit, të cilat gjithnjë e më tepër theksojnë rëndësinë e lidhjes së ngushtë ndërmjet shkollës dhe familjes. Kjo mund të ndihmojë që disa familje të tërhiqen nga izolimi dhe, në këtë mënyrë, të kenë një ndikim pozitiv në marrëdhëniet e fëmijëve me shkollë. Ideja e tillë është një tregues për rëndësinë e mjedisit shkollor në procesin e edukimit.

Në seancën e 20 të *Konferencës së Përherhshme të Ministrave Evropian të Edukimit* (Krakow, Poloni, 2000) u ra dakord që edukimi për qytetari demokratike" promovon dhe promovohet nga (...) një qasje gjithshkollë, në varësi të karakterit të shkollës,

metodave të mësimnxënies dhe mësimdhënies dhe të pjesëmarrjes së fëmijëve, studentëve, personelit edukativ dhe të prindërve në vendimmarrje dhe, sa të jetë e mundur, në përcaktimin e kurrikulave formale dhe joformale.”

Viteve të fundit në Evropë, **kompetencat e qeverisë qendrore** në sferën e edukimit janë transferuar në regjione ose në institucionet edukative. Transferimi i jep shkollave më tepër hapësirë për manovrim, duke rritur mundësitë e tyre për krijimin e lidhjeve më të ngushta me komunitetin edukativ në kuptimin e gjerë dhe u mundëson atyre të praktikojnë demokracinë e vërtetë të participimit në proceset e tyre vendimmarrëse.

E fuqizuar nga ky transferim, përfshirja e prindërve ndihmon në inicimin e dialogut dhe promovon përfaqësimin e të gjithë komunitetit edukativ në edukimin e fëmijëve. Reforma edukative në Evropë dhe gjithandej nëpër botë, në këtë mënyrë, tregon **rolin e shkollës si një shkallë për ndërtimin e demokracisë**.

Por, sipas C. Bîrzéa dhe Studimit Gjith evropian mbi Edukimin për Politikën e Qytetarisë Demokratike,¹³ **ndërmjet politikave të miratuara dhe praktikës aktuale mbetet një zbrazëtirë e konsiderueshme**. Për më tepër, studimet e fundit qartë tregojnë se **evropianët e rinj janë duke e humbur interesimin për politikë, dhe janë më pak të përfshirë në shoqërinë civile**.

Kjo është arsyeja që Këshilli i Evropës punon në **sigurimin e mjeteve për faktorët lokal** ashtu që ata drejtpërdrejt t'i kryejnë aktivitetet që kanë për synim ndërtimin e një mjedisi më demokratik të shkollës.

Veprimi në nivel lokal ndihmon për të mbushur zbrazëtirën ndërmjet politikës dhe praktikës aktuale. Përveç kësaj, faktorët edukativ duke vepruar në nivel lokal mund të vlerësojnë drejtpërdrejtë rezultatet e punës së tyre dhe të **përshtatin aktivitetin e tyre kontekstit në të cilin ata punojnë**.

Ky është edhe qëllimi i këtij doracaku. Për të nxitur qeverisjen demokratike në shollat e tyre, doracaku siguron burime për udhëheqësit e shkollës, administratorët, drejtorët dhe për mësimdhënësit.

Nga politikbërja drejtë praktikës në Edukimin për Qytetari Demokratike (EQD) në Këshillin e Evropës

Që nga themelimi në vitin 1949, Këshilli i Evropës ka punuar për të realizuar një bashkim më të ngushtë ndërmjet anëtarëve të vet, dhe për të forcuar demokracinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Evropë.

Edukimi është sferë kyçe e aktivitetit për arritjen e këtyre qëllimeve, dhe njihet si një nga shtyllat e demokracisë: Këshilli i Evropës e konsideron demokracinë si një proces të nxënies dhe i ndjek politikën dhe aktivitetet e saj të edukimit me synim të ndërtimit të një shoqërie më demokratike evropiane.

¹³ C. Bîrzéa, “Pjesa 1: Politikën e EQD-së në Evropë – Një sintezë”, *Studim Gjith evropian mbi Edukimin për Politikën e Qytetarisë Demokratike*, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2004, ISBN 92-871-5608-5.

Aktivitetet edukative dhe kulturore të Këshillit janë formuluar në Konventën Evropiane të Kulturës, të miratuar në viti 1954, dhe deri tash të nënshkruar nga 48 shtete.

E vendosur të bëjë edukimin mjet për trajnimin e qytetarëve aktiv dhe të përgjegjshëm, Këshilli i Evropës dizajnoi **projektin për Edukim të Qytetarisë Demokratike (EQD)**, i cili zyrtarisht ka filluar në vitin 1997. Qëllimi i projektit ishte të **përcaktojë se çfarë vlerash dhe shkathtësish duhet të kenë personat në mënyrë që të bëhet qytetarë aktiv, dhe si do t'i fitojnë ato dhe do t'i transferojnë te të tjerët.**

Edukimi për qytetari demokratike është një **përgjigje në sfidat kryesore me të cilat ndeshet shoqëria jonë**, duke përfshirë ngritjen e jotolerancës dhe racizmit në Evropë, rritjen e individualizmit, diskriminimit dhe përjashtimit social, përfshirjen e vogël në politikë dhe në çështjet qytetare dhe mungesën e besimit në institucionet demokratike.

Projekti është realizuar në dy faza: E para (1997 deri 2000) ka shërbyer për përkufizimin e qartë të koncepteve të EQD-së, zhvillimin e strategjive dhe përvijimin e bazave teorike për politikatat e EQD-së.

Në fazën e dytë (2001 deri 2004) rezultatet e tilla janë shfrytëzuar për ndërtimin e standardeve politike për EQD-në dhe për miratimin dhe vënien në praktikë të tyre nga shtetet anëtare. Ekspertët kanë shqyrtuar vështirësitë praktike në shtete të ndryshme anëtare.

Përfundimisht, organizimi i rrjetit panevropian i koordinatorëve shtetëror, Këshillit të Evropës i dha një pasqyrë të qartë për situatën dhe i mundësoi të ndërmerri më shumë veprime përkatëse në shtetet anëtare. Rrjeti gjithashtu lehtësoi detyrën e pilotimit dhe të koordinimit të punës së projektit më tepër në nivel lokal.

Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës e shpalli vitin 2005 Vitin Evropian të Qytetarisë përmes Edukimit, duke dëshmuar se **EQD-ja ishte në qendër të interesimit të Evropës.**

Çka është EQD-ja?

Edukimi për qytetari demokratike është një grup i praktikave dhe i aktiviteteve të dizajnuar për të përgatitur njerëzit të jetojnë në shoqëri demokratike, duke siguruar që ata aktivisht të përdorin të drejtat dhe përgjegjësitë.

Edukimi i tillë përfshin edukimin për të drejtat e njeriut, edukimin qytetar dhe edukimin ndërkulturor.

EQD-ja është shumë ngushtë e lidhur me idenë e pjesëmarrjes, sepse asnjë nuk mund të kalojë në qytetari demokratike pa praktikimin e saj.

Përvijimi i fazave të ndryshme në punën e Këshillit të Evropës në këtë fushë të edukimit do të lehtësojë të kuptuarit se si fillon dhe si zhvillohet procesi.

Edukimi për Qytetari Demokratike shfaqet në fillim të viteve 90-ta si prioritet në edukim i Këshillit të Evropës, dhe ka shënuar rezultate të konsiderueshme në aktivitetet e tij, veçanërisht përmes pesë ngjarjeve vendimtare:

- (1) *Samiti i dytë i Shefave të Shtetit dhe i Qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës* (Strasburg, 10-11 tetor 1997) **Edukimin për Qytetari**

Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut i deklaroi fusha parësore për Këshillin e Evropës. Atëherë zyrtarisht filloi projekti i EQD-së.

Samiti i parë i Shefave të Shteteve dhe i Qeverive, i mbajtur në Vienë në vitin 1993, ishte përqendruar në çështjen e minoriteteve, e cila shtrohej si çështje kyçe në vitet e 90-ta, dhe që atëherë u theksua fuqishëm nevoja për administrim politik pluralist të shoqërisë, vështirësitë e realizimit të kësaj dhe nevojën për masa që të zbatohet respektimi për diverzitetet.

- (2) *Deklarata e Budapest-it mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve* (Deklarata dhe programi mbi Edukimin për Qytetari Demokratike, e bazuar në të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve – miratuar nga Këshilli i Ministrave më 7 maj 1999, në seancën e 104). Kjo deklaratë **njeh rolin thelbësor të EQD-së në ndërtimin e një shoqërie demokratike që dallohet me kohezion shoqëror dhe respektim për diversitete.** Këshilli i Ministrave deklaroi se EQD-ja:

“ii. burrat dhe gratë i aftëson që të luajnë një rol aktiv në jetën publike dhe të përcaktojnë në mënyrë të përgjegjshme fatin e tyre dhe të shoqërisë së tyre;

iii. synon të rrënjos kulturën e të drejtave të njeriut, e cila do të sigurojë respektimin e të drejtave të këtyra dhe të kuptuarit e përgjegjësitë që rrjedhin nga këto të drejta;

iv. përgatit njerëzit të jetojnë në një shoqëri multikulturore dhe me mirinformim, arsyeshëm, me durim dhe ndershmërisht, të merret me dallimet;

v. forcon kohezionin shoqëror, mirëkuptimin reciprok dhe solidaritetin“.

- (3) *Rezoluta e Konferencës së Ministrave Evropian të Edukimit*, e miratuar në Krakov, në vitin 2000, thekson **rëndësinë e mjedisit demokratik të mësimit, të partneritetit ndërmjet palëve të interesuara në komunitetin edukativ dhe të pjesëmarrjes së nxënësve.**
- (4) *Rekomandimi (2002)12 i Këshillit të Ministrave të Edukimit të Shteteve Anëtare për Qytetari Demokratike* (e miratuar më 16 tetor 2002 në mbledhjen e 802 të Zëvendësministrave) ripohohet **rëndësia themelore për zhvillimin e edukimit për qytetari demokratike për siguri, stabilitet dhe për zhvillim të shoqërisë demokratike.**

Këshilli i Ministrave deklaroi:

“që edukimi për qytetari demokratike është një faktor për kohezion shoqëror, mirëkuptim reciprok, dialog ndërkulturor dhe ndërfetar dhe për solidaritet, se kontribuon në promovimin e principit të barabarësisë ndërmjet gruas dhe burrit, dhe se edukimi i tillë inkurajon vendosjen e marrëdhënieve harmonike dhe paqësore brenda dhe ndërmjet njerëzve, sikurse edhe mbrojtjen dhe zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe të kulturës; se edukimi për qytetari demokratike, në kuptimin më të gjerë të mundshëm të tij, duhet të jetë në qendër të reformës dhe të implementimit të politikave edukative”.

- (5) *Deklarata e Ministrave Evropian të Edukimit mbi edukimin ndërkulturor në kontekstin e ri evropian* (Konferenca e Përhershme e Ministrave Evropian të

Edukimit, seanca e 21-të, Athinë, Greqi, 10-12 nëntor 2003). Kjo deklaratë fut idenë e **rëndësisë së qeverisjes demokratike në shkolla**. Ministrat Evropian deklarojnë se Këshilli i Evropës do të:

“mbështes iniciativat dhe eksperimentet me qeverisjen demokratike në shkolla, veçanërisht përmes partneritetit, pjesëmarrjes së të rinjve dhe bashkëpunimit me komunitete, shoqërive të prindërve dhe atyre civile; identifikon modele të praktikës së mirë në fushën e qeverisjes demokratike dhe të sigurimit të kualitetit, dhe përgatit shfrytëzuesit e mundshëm për të qenë të aftë t'i shfrytëzojnë ato modele“.

Tekstet e këtilla zyrtare tregojnë **progresin e madh dhe të vazhdueshëm që është bërë në identifikimin e rëndësisë së Edukimit për Qytetari Demokratike** për shoqërinë e të ardhmes, si dhe bëjnë shqyrtime të nevojshme për mënyrat dhe mjetet, metodat dhe praktikatat e mira për implementimin/zbatimin e EQD-së.

Nxënia në lidhje me demokracinë tash është një objektivë e deklaruar në sistemet e edukimit në të gjitha shtetet e Evropës; EQD-ja ose konsiderohet si një objektivë e qartë edukative ose inkorporohet nëpër kurrikula si diçka e veçantë. Prandaj, pavarësisht dallimeve të dukshme ndërmjet sistemeve të tyre të edukimit dhe të pikëpamjeve mbi edukimin, të gjitha shtetet anëtare tash janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e edukimit për qytetari demokratike.

Projekti i EQD-së mbështetet aktivisht nga Bashkimi Evropian, i cili bashkëpunon në zhvillimin e tij. Ai gjithashtu ndodhet në qendër të partneritetit me organizatat tjera ndërkombëtare: UNESCO-n, UNICEF-in, OECD-në dhe OSCE-në.

Në bazë të këtyre vendimeve politike, Këshilli i Evropës punon në implementimin/zbatimin e EQD-së në shtetet anëtare përmes

- mbajtjes së seminareve dhe këshillimeve;
- organizimit të aktiviteteve në shtetet anëtare përmes shkollave/ose OJQ-ve;
- sajimit të mjeteve si p.sh. pakoja e EQD-së që përmban doracakë për profesionistët e edukimit;
- organizimin e Vitit Evropian të Qytetarisë përmes Edukimit (në vitin 2005).

Ky doracak, si një prej materialeve në pakon e EQD-së, është botuar nga Këshilli i Evropës për të siguruar mbështetje dhe për të sugjeruar metoda për secilin që është i përfshirë në qeverisjen e shkollës në Evropë, e që dëshiron të bëjë shkollën e tij më demokratike.

Doracaku është pjesë e punës së vazhdueshme të Këshillit të Evropës në lidhje me projektin për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Vitit Evropian të Qytetarisë përmes Edukimit 2005. Me përqendrimin e tij në qeverisje, ky është një mjet për veprim të drejtpërdrejtë në shkollë, ndonëse në të njëjtën kohë pasqyron vitet e mendimit të kujdesshëm politik dhe të një game të gjerë të përvojës praktike në shtetet evropiane gjatë nëntë viteve të kaluara.

Edukimi për Qytetari Demokratike dhe për Qeverisje Demokratike

Rëndësia e qeverisjes demokratike bëhet e qartë menjëherë në projektin mbi Edukimin për Qytetari Demokratike. Motoja “**të nxënit dhe të jetuarit e demokracisë**” thekson nevojën e përjetimit të demokracisë në shkollë me qëllim të përvetësimit të vlerave dhe praktikave demokratike.

Në Konferencën e Përhershme të Ministrave Evropian të Edukimit (Athinë, Greqi, 10-12 nëntor 2003) për të tërhequr vëmendjen e politikbërsve janë parashtuar një varg i pyetjeve të hapura. Ishin identifikuar tre sisteme të mbështetjes për arritjen e objektivave të edukimit ndërkulturor: kurrikula, qeverisja e shkollës dhe administrimi, dhe trajnimi i mësimitdhënësve. **Qeverisja e shkollës është niveli i parë i vendimmarrjes me ndikim në jetën e përditshme të nxënësve.**

Nëse shkolla dëshiron të edukojë të rinjtë për qytetarinë demokratike, hapi i parë duket se është të ndërtojë një shkollë demokratike. Është sigurisht iluzore të kërkon të kaloni në vlera në një mjedis i cili nuk funksionon në pajtim me ato vlera. Një shkollë që praktikon qeverisjen demokratike krijon një mjedis që karakterizohet me vlera demokratike, në të cilin fëmijët do të jenë si në shtëpi të tyre që nga vitet e hershme të tyre. Kjo do të ju mundësojë atyre që të përvetësojnë vlerat e qytetarisë demokratike dhe t'i praktikojnë ato në mënyrë të natyrshme dhe spontane.

Që nga viti 2004 Këshilli i Evropës ka planifikuar të përpilojë një manual për qeverisjen demokratike në shkolla.

Në janar të vitit 2006, është mbajtur mbledhja e parë e grupit punues për qeverisje demokratike, i cili ka iniciuar këtë doracak. Ekspertët që kanë qenë prezent në mbledhje e kanë përkufizuar konceptin e qeverisjes demokratike dhe kanë hartuar një përvijim për librin, që është dizajnuar si material për shkolla.

Mjetet tjera për praktikumin e EQD-së – në nivel lokal

Si pjesë të projektit Viti Evropian i Qytetarisë përmes Edukimit, Këshilli i Evropës dëshiron të përfshijë politikanët, mësimitdhënësit dhe të gjithë të tjerët që punojnë me fëmijët dhe në edukim (formal ose joformal). Prandaj janë përpiluar disa materiale mbështetëse të punës për njerëzit që janë të interesuar për EQD-në

Pakoja për EQD-në

Një prej këtyre materialeve mbështetëse, **pakoja për EQD** (në përgatitje), përbëhet prej serisë së dokumenteve dhe materialeve për sajimin dhe implementimin/zbatimin e edukimit për qytetari demokratike dhe për politikën dhe praktikën e edukimit për të drejtat e njeriut në gjithë sektorët e edukimit.

Janë në dispozicion këto materiale:

- **Materiali1: Materiali për çështjet kyçe të politikës së EQD-së**

U dedikohet vendimmarrësve në të gjitha nivelet e sistemit të edukimit. Përmban “Fjalorin shpjegues të termave të edukimit për qytetari

demokratike; „Studimin gjithë Evropian mbi politikat e edukimit për qytetari demokratike dhe “Materialin për çështjet kyçe të edukimit për qytetari demokratike”.

- **Materiali 2: Materiali për qeverisjen demokratike në edukim**

U dedikohet të gjithë polikbërsve, udhëheqësve të edukimit dhe administratorëve, udhëheqësve dhe drejtorëve të shkollës, nxënësve, organizatave të prindërve dhe të komunitetit. Përbëhet nga ky doracak, që keni para vetes, dhe nga publikimi Pjesëmarrja e Shkollës Demokratike dhe Qëndrimet Qytetare në mesin e Adolështëve Evropian: Analiza e të dhënave nga Studimi IEA për Edukim Qytetar.

- **Materiali 3: Materiali për trajnim të mësimitdhënësve për EQD-në dhe EDNJ-në**

U dedikohet trajnuesve të mësimitdhënësve, mësimitdhënësve, udhëheqësve dhe drejtorëve të shkollës, koordinatorëve të kurrikulave, OJQ-ve dhe organizatave të komunitetit. Doracaku i titulluar Materiali për Trajnimin e Mësimitdhënësve për Edukim të Qytetarisë Demokratike dhe për Edukim të Drejtave të Njeriut.

- **Materiali 4: Materiali për sigurim të kualitetit të EQD-së**

U dedikohet udhëheqësve dhe drejtorëve të shkollës, koordinatorëve të kurrikulave, mësimitdhënësve, trajnuesve të mësimitdhënësve dhe udhëheqësve të edukimit dhe administratorëve. Bazohet në rezultatet e Sigurimit të Kualitetit dhe në Projektin e Zhvillimit të Shkollës të udhëhequr nga Qendra për Studimet e Politikës së Edukimit (CEPS).

Publikime tjera: materialet edukative

- **Doracaku COMPASS mbi edukimin e të drejtave njerëzore**

COMPASS është përpiluar si pjesë e programit për edukimin e të rinjve për të drejtat e njeriut të udhëhequr nga Drejtoria për të rinj dhe sport e Këshillit të Evropës. Qëllimi i programit është që të vendos të drejtat e njeriut në epiqendër të punës së të rinjve, dhe në këtë mënyrë të ndihmojë që edukimi për të drejtat e njeriut të vendoset në qendër të vëmendjes.

- **Materiale për trajnim - “T-kits“**

Këto janë publikime tematike të shkruara nga trajner të të rinjve me përvojë dhe nga ekspertë tjerë. Këta janë doracak lehtë të përdorshëm për shfrytëzim në seancat e trajnimit dhe të mësimit. Materialet e këtilla janë përpiluar nga Drejtoria e të rinjve.

- **Karta Evropiane për Shkollë Demokratike pa Dhunë**

Me iniciativë të Këshillit të Evropës, të rinjtë nga gjithë Evropa kanë hartuar Kartën Evropiane për Shkollë Demokratike pa Dhunë në bazë të vlerave dhe të principeve më të rëndësishme që janë të përbashkëta për të gjithë evropianët, sidomos ato të parashtruara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore.

- **DOMINO**

Doracak për shfrytëzim në edukimin e grup-moshatarëve si material për të luftuar racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe jotolerancën (botimi i tretë) (2005).

- **Pakoja për edukim**

Ide, burime, metoda dhe aktivitete për edukim ndërkulturor joformal për të rinjtë dhe të rriturit (2005).

- **Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut – pikë fillestare për mësimdhënësit**

Fletë faktografike mbi edukimin për të drejtat e njeriut. Shpjerja në jetë e të drejtave të njeriut në klasë.

Për lexim të mëtejshëm

- EDC policies and regulatory frameworks (Politikat dhe kuadri rregullativ për EQD-në (2003) ISBN 92-871-4949-6
- Responsibility: from principles to practice – Proceedings (Përgjegjësia: nga principet në praktikë - Punime) – Delfi, tetor 1999 (2001) ISBN 92-871-4511-3
- EDC Words and Actions (EQD:Fjalë dhe vepra) (2001) ISBN 92-871-4507-5
- Concepts of democratic citizenship (Konceptet e qytetarisë demokratike) (2001) ISBN 92-871-4452-4
- Adopted texts on education for democratic citizenship (Tekste të adoptuara mbi edukimin për qytetari demokratike) (2003) ISBN 92-871-5167-9
- Youth Cultures, Lifestyles and Citizenship (Kultura e të rinjve, Stilet e jetës dhe qytetaria) (2000) ISBN 92-871-3984-9
- Education for Democratic Citizenship: methods, practices and strategies (Edukimi për qytetari demokratike: metodat, praktikat dhe strategjitë – Raport) (2001) ISBN 92-871-4509-1
- Learning democracy: education policies within the Council of Europe (Të mësuarit e demokracisë: politikat mbi edukimin brenda Këshillit të Evropës (2005)

Uebsajti

Për informacione mbi Edukimin për Qytetari Demokratike dhe projektin e EQD-së shih uebsajtin: <http://www.coe.int/edc/en>

Burimet:

Demokracia dhe qeverisja demokratike e shkollave

.....shih origjinalin!!!

.....
.
.

Këshilli i shkollës/parlamenti i nxënësve dhe koha në grup (circle time)

- .
- .
- .
- .
- .

Shoqëria që ndryshon

- .
- .
- .
- .

Përfundim

Dokumentim e lexuam dhe analizuam fjalë për fjalë, shkronjë për shkronjë. Bëmë disa intervenime, përmirësime e shtuam ndonjë fjalë a fjali me qëllim të sforcimit të kuptimit dhe të domethënies së tekstit. Me këto intervenime që bëmë me siguri që ky tekst ka fituar në përmbajtje dhe është bërë më i kapshëm, më i përshtatshëm dhe më i zbatueshëm në praktikën e zbatimit të EDQ-së në shkollat e Kosovës.

Sa i përket përmbajtjes së tekstit, mendojmë se është një material ndihmës mjaftë i mirë si për drejtorin e shkollës ashtu edhe për mesimdhënësit që merren me zbatimin e edukimit qytetar. Shembujt e dhënë në brendi janë një material i mirë, përvojë e mirë për zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve të njëjta ose të ngjashme edhe në shkollat e Kosovës.

Tani në duart e shkollës, drejtorit, mësuesit gjendet një doracak i dal nga përvoja më e përparuar evropiane. Kjo do të ndihmojë shumë për arritjen e shkollës dhe të shoqërisë-brezit të ardhshëm në drejtim të integriteteve evropiane, në shoqërinë e traditës demokratike.

Urojmë që brezi i ri, ardhmëria e Kosovës, të marrë shumë përvoja nga shembujt e dhënë në këtë doracak, dhe ta ketë më të lehtë rrugën drejt Evropës.,

Ismet Potera
Shqipe Gashi-Ramadani